



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Kuvendi i Komunës Rahovec
Skupština Opština Rahovac/Municipality of Rahovec



01 Nr. 03/23
Rahovec, 17.03.2023

Flohen anëtarët e Kuvendit Komunal, që të marrin pjesë në mbledhjen e tretë (3), e cila do të mbahet më
30 mars 2023 (e enjte), me fillim në orën 10:00, në sallën e KK Rahovec.

Për këtë mbledhje, propozoj këtë:

REND DITE

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Pyetjet dhe përgjigjet në pyetjet e kuvendarëve;
3. Shqyrtimi dhe miratimi i propozimvendimit për faljen e borxheve të papaguara për taksat në aktivitele (afariste), nga data 1.1.2000–31.1.2017;
4. Shqyrtimi dhe miratimi i propozimvendimit për shfuqizimin e vendimit 01 Nr.149/2006, i datës 14.7.2006;
5. Shqyrtimi dhe miratimi i propozimvendimit për shpalljen me interes të përgjithshëm publik P-71510057-05539-0 - zona kadastrale Rahovec;
6. Shqyrtimi dhe miratimi i propozimvendimit për dhënien e pëlqimit për këmbimin e pronës publike me pronën e Institucionit Qëndror – zona kadastrale Rahovec;
7. Shqyrtimi dhe miratimi i propozimvendimit për riparcelizim të parcelave në zonën kadastrale Rahovec;
8. Shqyrtimi dhe miratimi i Draft Rregullores për Menaxhimin e Mbeturinave në territorin e Komunës së Rahovecit;
9. Shqyrtimi i propozimvendimit për themelimin e Ansambllit Komunal të Këngëve dhe Valleve në Rahovec;
10. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të Punës së Këshillit të Fshatit Hoçë e Madhe për vitin 2023;
11. Informatë mbi listën e pronave komunale dhe menaxhimi i tyre;
12. Informatë për mirëmbajtjen e rrugëve gjatë sezonës dimërore;





Drejtoria për Shërbime Publike
Odeljenje za Opštinske Javne Usluge
Department of Municipal Public Services

Nr. I prot. 903
Br. prot. 08-03-2023
Më 08-03-2023
RAHOVEC - ORAHOVAC

Datë/Datum/Date:	08.03.2023
Referenc-ë	
Për/Za/To:	Kuvendin e Komunës së Rahovecit
CC:	
Përmes/Preko/Through:	
Nga/Od/From:	z.Përparim Krasniqi, Drejtor për Shërbime Publike
Subjekti/Predmet/Subject:	Informatë

Informatë mbi implementimin e projektit të mirëmbajtjes dimërore të rrugëve në Komunën e Rahovecit

Komuna e Rahovecit ka kontraktuar 3 kompani për mirëmbajtje të rrugëve gjatë sezonës dimërore dhe verore.

1. Periudha dimërore llogaritet nga data 15 nëntor deri me 15 mars të vitit që vie,
2. Periudha verore llogaritet nga 15 marsi i atij vitit deri me 15 nëntor.

Gjatë sezonës dimërore parashihen të mirëmbahen rrugët nga bora dhe akulli, si dhe hedhja e kripës industriale, ndërsa momentin që nuk ka borë kompanitë janë të detyruar të bëjnë pastrimin e rrugëve nga mbeturinat.

Ndërsa gjatë sezonës verore parashihen të mirëmbahen rrugët duke përfshirë larjen dhe pastrimin e brezave rrugore dhe trotuareve.

Sa i përket mirëmbajtjes dimërore të rrugëve komuna e Rahovecit e ka ndare në 3 zona mirëmbajtje të rrugëve lokale;

Lot-1, 173,464,13 euro, KRM Ekoregjioni, janë keto segmente rrugore me gjatësi 71 km, ku përfshihet qyteti i Rahovecit me 106 segmente rrugore.

Lot-2, 214,503.67 euro, Eko Drinia, janë keto segmente rrugore me gjatësi 192 km, ku përfshihen 24 vendbanime.

Lot-3, 73,784.72 euro, Berisha Com, janë keto segmente rrugore, me gjatësi 68 km, ku janë të përfshira gjithsej 9 vendbanime.

KOMUNA RAHOVEC

Drejtoria për Shërbime Publike
Adresa: 8 Dëshmorët e Pashtrikut – p.n. Rahovec, Kosovë
Tel: +383 29 276 943
<http://kk.rks-gov.net/rahovec>

Projekti i mirëmbajtjes së hapësirave publike

Projekti i mirëmbajtjes së hapësirave publike është i specifikuar në kontratat e komunës së Rahovecit ku në masë të madhe janë të përfshira të gjitha hapësirat tjera duke përfshirë, varreza civile, varreza të Dëshmoreve, lapidare, vegjetacione, breza rrugore apo trotuare, përveq kësaj duke pasur parasysh që komuna e Rahovecit kufizohet edhe me rrugë rajonale, shumë shpesh ka ndodhur që komuna ka mirëmbajtur edhe këto rrugë.

Ne çdo vit ka ndryshime në pozicione të caktuara, specifikisht risi është edhe larja dhe lysterja e lapidareve dhe shtatoreve që janë të vendosur në territorin e komunës së Rahovecit.

Për me shume detaje dhe sqarime tjera, do te jemi te hapur te diskutojmë gjate mbledhjes se KPF-së dhe Mbledhjes së Kuvendit të komunës.

Me respekt,

Drejtorja e Shërbimeve Publike

KOMUNA RAHOVEC

Drejtorja për Shërbime Publike
Adresa: 8 Dëshmorët e Pashtrikut – p.n. Rahovec, Kosovë
Tel: +383 29 276 943
<http://kk.rks-gov.net/rahovec>



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna Rahovec - Opština Orahovac
Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë
Odeljenje za Geodeziju, Katastar i Imovinu



Komuna e Rahovecit
Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë

REPUBLIKA E KOSOVES
REPUELIKA KOSOVA
KOMUNA E RAHOVECIT - OPŠTINA ORAHOVAC
Drejtoria për Administratë të përgjithshme
Odeljenje za Opštu Upravu

Nr. I prot. 873
Br. prot. 07.03.2023
Më Dt. 07.03.2023
KOMUNA E RAHOVECIT - ORAHOVAC

Informatë mbi listën e pronave komunale dhe menaxhimin e tyre

Komuna e Rahovecit është e përbërë nga 34 Zona Kadastrale në të cilën janë të shpërndara paluajtshmërit në të gjitha zonat kadastrale. Në këtë raport janë të përfshira edhe objektet e QKMF-së, shkollat fillore, shkollat e mesme, çerdhet, palestrat sportive, objektet kulturore, objektet e komunës, më poshtë tabelari me të dhëna më të hollësishme:

	Objektet:	Sipërfaqja:
1.	Shkollat	44850 m ²
2.	Shkollat Profesionale	6500 m ²
3.	Çerdhet	1057 m ²
4.	Objektet Kulturore	5752 m ²
5.	Palestrat Sportive	3225 m ²
6.	QKMF-të	7587 m ²
7.	Objektet Komunale	1313 m ²
		70284 m²

	Zonat Kadastrale:	Sipërfaqja:
1.	Rahovec	1727960 m ²
2.	Brestovc	291840 m ²
3.	Hoçë e Vogël	531923 m ²
4.	Nagavc	292140 m ²
5.	Retijë	623607 m ²
6.	Zoqishtë	126183 m ²
7.	Opterushë	498706 m ²
8.	Hoçë e Madhe	383781 m ²
9.	Celinë	539527 m ²
10.	Krushë e Madhe	1989796 m ²
11.	Xërxë	162249 m ²
12.	Bellacërkë	390836 m ²
13.	Sapniq	60726 m ²
14.	Nushpall	34202 m ²

KOMUNA RAHOVEC

Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë
Adresa: 8 Dëshmorët e Pashtrikut, p.n. Rahovec, Kosovë
Centrix: 45341
<http://kk.rks.gov.net/rahovec>

15.	Zatriq	166451 m ²
16.	Potoqan i Poshtëm	126986 m ²
17.	Drenoc	232267 m ²
18.	Senoc	89864 m ²
19.	Gexhë	284026 m ²
20.	Pastasellë	95374 m ²
21.	Polluzhë	57047 m ²
22.	Radostë	402062 m ²
23.	Ratkoc	355235 m ²
24.	Vrajak	166214 m ²
25.	Dejnë	214800 m ²
26.	Bratotin	111990 m ²
27.	Guri i Kuq	201556 m ²
28.	Mrasor	207945 m ²
29.	Kaznik	501406 m ²
30.	Çifllak	311379 m ²
31.	Dobidol	295113 m ²
32.	Kramovik	389830 m ²
33.	Bërnjak	23192 m ²
34.	Potoqan i Epërm	25762 m ²
		1191,19.75

Vërejtje:

Këto të dhëna mund të ndryshojnë për arsye se mund të ketë ndryshme në Sistemin Informativ i Kadastrit të Tokave të Kosovës – SIKTK.

Afrim Oruqi

 Drejtor për GJ.R.P.



KOMUNA RAHOVEC

Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë
 Adresa: 8 Dëshmorët e Pashtrikut, p.n. Rahovec, Kosovë
 Centrix: 45341
<http://kk.rks-gov.net/rahovec>



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Kuvendi Komunitës Rrahovec
Skupština Opštine Orahotac / Municipal Assembly Rahovec



Këshilli i fshatit Hoçë e Madhe

PLANI I PUNËS SË KËSHILLIT TË FSHATIT HOÇË E MADHE
JANAR – DHJETOR 2023

Shkurt - 2023

HYRJE:

Këshilli për fshatin Hoçë e Madhe është këshill i themeluar nga Kuvendi i Komunës së Rahovecit në bazë të Ligjit nr. 04/L-62 për fshatin Hoçë e Madhe, si dhe Udhëzimin Administrativ nr. 11/2014 për themelimin, zgjedhjen, përgjegjësitë dhe funksionimin e Këshillit për fshatin Hoçë e Madhe.

Plani vjetor i punës:

Në planin vjetor të punës së Këshillit për fshatin Hoçë e Madhe janë përcaktuar qëllimet dhe aktivitetet që do të kryejnë anëtarët e Këshillit për fshatin Hoçë të Madhe në përmbyshjen e qëllimeve të funksionimit të këtij mekanizmi. Ky plan ka për qëllim identifikimin e qëllimeve, aktiviteve dhe rezultateve, përkatesisht përcaktimin e përgjegjësiave për kryerjen e detyrave të përcaktuara me Ligjin dhe Udhëzimet Administrative të këshillit.

Roli i këshillit të fshatit Hoçë e Madhe:

Roli i Këshillit për fshatin Hoçë e Madhe të komunës së Rahovecit është promovimi, mbrojtja dhe ruajtja e monumenteve kulturore dhe fetare në kuadër të zonës së veçantë të mbrojtur, e cila është përcaktuar me Ligjin nr. 03/L-039/2008 për zona të veçanta të mbrojtura. Në këtë drejtim, ne si anëtarë të zgjedhur të Këshillit për fshatin Hoçë të Madhe shprehim gatishmërinë tonë dhe jemi të hapur për bashkëpunimin me të gjitha institucionet, qofshin ato lokale apo qendrore, duke ofruar të gjitha informacionet dhe rekomandimet e nevojshme për promovimin kulturor, historik dhe monumentet fetare, si dhe zhvillimi ekonomik dhe turistik në nivel komunal.

Objektivat e planit të punës:

Parashikimi dhe përcaktimi i aktiviteteve të caktuara vjetore për të arritur rezultatet më të mira të mundshme, përkatesisht:

1. Do të monitorojnë në mënyrë të vazhdueshme gjendjen e monumenteve kulturore në territorin e zonës së mbrojtur;
2. Do të zhvillojë takime me institucionet lokale dhe qendrore, qytetarë, grupe interesi, organizata joqeveritare (OJQ) që merren me çështjen e mbrojtjes së monumenteve kulturore dhe të trashëgimisë;
3. Do të merret me zgjidhjen e kërkesave të natyrës infrastrukturore dhe investimeve kapitale në zonën e mbrojtur të fshatit Hoçë e Madhe;
4. Do të mbajë shënime për punën e vazhdueshme dhe progresin e arritur në baza vjetore;

Rezultatet e pritura:

Duke vepruar siç u tha më sipër dhe duke u fokusuar në objektivat e mësipërme, mbrojtja e monumenteve kulturore dhe historike do të ndryshojë në të mirë të qytetarëve. Qytetarët dhe të gjithë vizitorët e interesuar do të prezantohen me një pasqyrë më të mirë të të gjitha monumenteve kulturore dhe historike.

Afati për zbatimin e planit të punës:

Ky plan pune është i vlefshëm për periudhën janar - dhjetor 2023.

Nr.	Muaji	Gëshjtjet të cilat shqyrtohen	Përgatit	Shqyrton	Miraton
1	JANAR	1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar, 2. Përpilimi i Raportit Vjetor të Punës për vitin 2023, 3. Shqyrtimi i informatave, kërkesave të drejtorive të caktuar ose qytetarëve, 4. Të ndryshme.	Kryesuesi i Këshillit Administratori.	Kryesuesi i Këshillit, Anëtarë të Këshillit,	Anëtarë të Këshillit
2	SHKURT	1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar, 2. Përpilimi i planit të punës për vitin 2023, 3. Shqyrtimi i informatave, kërkesave të drejtorive të caktuar ose qytetarëve, 4. Përpilimi dhe dërgesa e kërkesave institucioneve lokale ose qendrore, 5. Të ndryshme.	Kryesuesi i Këshillit Administratori	Kryesuesi i Këshillit, Anëtarë të Këshillit,	Anëtarë të Këshillit
3	MARS	1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar, 2. Shqyrtimi i informatave, kërkesave të drejtorive të caktuar ose qytetarëve, 3. Përpilimi dhe dërgesa e kërkesave institucioneve lokale ose qendrore, 4. Të ndryshme.	Kryesuesi i Këshillit Administratori.	Kryesuesi i Këshillit, Anëtarë të Këshillit,	Anëtarë të Këshillit
4	PRILL	1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar, 2. Shqyrtimi i informatave, kërkesave të drejtorive të caktuar ose qytetarëve, 3. Përpilimi dhe dërgesa e kërkesave institucioneve lokale ose qendrore, 4. Të ndryshme.	Kryesuesi i Këshillit Administratori.	Kryesuesi i Këshillit, Anëtarë të Këshillit,	Anëtarë të Këshillit
5	MAJ	1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar, 2. Shqyrtimi i informatave, kërkesave të drejtorive të caktuar ose qytetarëve, 3. Përpilimi dhe dërgesa e kërkesave institucioneve lokale ose qendrore, 4. Të ndryshme.	Kryesuesi i Këshillit Administratori.	Kryesuesi i Këshillit, Anëtarë të Këshillit,	Anëtarë të Këshillit
6	QERSOR	1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar, 2. Shqyrtimi i kornizës afatmesme buxhetore të parë për vitin 2024, 3. Shqyrtimi i informatave, kërkesave të drejtorive të caktuar ose qytetarëve, 4. Përpilimi dhe dërgesa e kërkesave institucioneve lokale ose qendrore, 5. Të ndryshme.	Kryesuesi i Këshillit Administratori.	Kryesuesi i Këshillit, Anëtarë të Këshillit,	Anëtarë të Këshillit

7	KORRIK	1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar, 2. Shqyrtimi i informatave, kërkesave të drejtorive të caktuar ose qytetarëve, 3. Përpilimi dhe dërgesa e kërkesave institucioneve lokale ose qendrore, 4. Të ndryshme.	Kryesuesi i Këshillit Administratori.	Kryesuesi i Këshillit, Anëtarë të Këshillit,	Anëtarë të Këshillit
8	GUSHT	1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar, 2. Shqyrtimi i kornizës afatmesme buxhetore të dytë për vitin 2024, 3. Përpilimi i tabelarit të shpenzimeve të mjeteve të keshillit të fshatit për vitin 2024, 4. Shqyrtimi i informatave, kërkesave të drejtorive të caktuara ose qytetarëve, 5. Përpilimi dhe dërgesa e kërkesave institucioneve lokale ose qendrore, 6. Të ndryshme.	Kryesuesi i Këshillit Administratori.	Kryesuesi i Këshillit, Anëtarë të Këshillit,	Anëtarë të Këshillit
9	SHTATOR	1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar, 2. Shqyrtimi i informatave, kërkesave të drejtorive të caktuara ose qytetarëve, 3. Përpilimi dhe dërgesa e kërkesave institucioneve lokale ose qendrore, 4. Të ndryshme.	Kryesuesi i Këshillit Administratori.	Kryesuesi i Këshillit, Anëtarë të Këshillit,	Anëtarë të Këshillit
10	TETOR	1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar, 2. Shqyrtimi i informatave, kërkesave të drejtorive të caktuara ose qytetarëve, 3. Përpilimi dhe dërgesa e kërkesave institucioneve lokale ose qendrore, 4. Të ndryshme.	Kryesuesi i Këshillit Administratori.	Kryesuesi i Këshillit, Anëtarë të Këshillit,	Anëtarë të Këshillit
11	NËNTOR	1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar, 2. Shqyrtimi i informatave, kërkesave të drejtorive të caktuara ose qytetarëve, 3. Përpilimi dhe dërgesa e kërkesave institucioneve lokale ose qendrore, 4. Të ndryshme.	Kryesuesi i Këshillit Administratori.	Kryesuesi i Këshillit, Anëtarë të Këshillit,	Anëtarë të Këshillit
12	DHJETOR	1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar, 2. Përpilimi i planit të punës për vitin 2024, 3. Shqyrtimi i informatave, kërkesave të drejtorive të caktuara ose qytetarëve, 4. Përpilimi dhe dërgesa e kërkesave institucioneve lokale ose qendrore, 5. Të ndryshme.	Kryesuesi i Këshillit Administratori.	Kryesuesi i Këshillit, Anëtarë të Këshillit,	Anëtarë të Këshillit

01 Nr. ____/23
Rahovec, 03.02.2023

KUVENDI I KOMUNËS NË RAHOVEC

Bojan Nakalaniq

Kryesuesi i Këshillit



P R O C E S V E R B A L

Nga mbledhja e rregullt e Kuvendit Komunal të Rahovecit, e mbajtur më **28.2.2023 (e martë)**, me fillim në orën **10:00**. Mbledhjen e kryesoi Kryesuesi i Kuvendit, **z. Defrim Kafexhiu**. Në fillim konstatoi se ka kuorum për mbajtjen e mbledhjes.

Kryesuesi: Fillimisht, përshëndetje për të gjithë! I nderuar Kryetar i Komunës, **z. Smajl Latifi**, Nënkryetar i Komunës, **z. Fatmir Iska**, të nderuar anëtarë të Kuvendit komunal, drejtorë të Drejtorive komunale, zyrtarë komunalë, përfaqësues të KFOR-it, media, përshëndetje për nxënësit të cilët kanë ardhur ta përcjellin mbledhjen nga afër. Të nderuar qytetarë të Komunës së Rahovecit, kjo është seanca e dytë (2) për këtë vit kalendarik. Komiteti për Politikë dhe Financa, në mbledhjen e mbajtur më 16 shkurt, për këtë seancë ka përgatitur këtë

R E N D I T E

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Pyetjet dhe përgjigjet në pyetjet e kuvendarëve;
3. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit 01 Nr.406/22, i datës 28.12.2022, për miratimin e Planit të Mobilitetit Urban 2022- 2027;
4. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit 01 Nr.404/22, i datës 28.12.2022, për miratimin e Planit të Vlerësimit të Rreziqeve nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë e Tjera për Komunën e Rahovecit;
5. Shqyrtimi dhe miratimi i ndryshim plotësimit të Rregullores 01 Nr.05/23 të datës 30.01.2023 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores për Taksa Komunale 01 Nr. 80/20 e datës 29.06.2020, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren 01 Nr. 169/21 të datës 26.02.2021;
6. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për faljen e borxheve të papaguara për taksat në aktivitete (afariste), nga data 1.1.2000– 31.1.2017;
7. Shqyrtimi dhe miratimi vendimit për shfuqizimin e vendimit 01 Nr.149/2006 i datës 14.07.2006;
8. Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit për caktimin e komisionit për zgjedhjen e drejtorëve dhe të zëvendës drejtorëve në institucionet edukativo- arsimore;
9. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim - vendimit për bartjen e mjeteve vetanake nga viti 2022, në vitin 2023;
10. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim - vendimit për dhënien e pronës në shfrytëzim afatshkurtër personave fizikë dhe juridikë dhe zhvillimin e procedurave të ankandit publik P-01952-1, zona kadastrale Ratkoc;
11. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale P-01952-1;
12. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim - vendimit për dhënien e pronës në shfrytëzim afatshkurtër personave fizikë dhe juridikë P-02240-73, zona kadastrale Rahovec;
13. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim - vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale P-02240-73;

14. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim - vendimit për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit për zhvillimin e aktiviteteve për nevojat e komunitetit, të fshatit Kramovik P-00330-0;
15. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit për zhvillimin e aktiviteteve për nevojat e komunitetit të fshatit Polluzhë; - P – 00722-0;
16. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për këmbimin e pronës komunale me pronë private P- 01041-1, zona kadastrale – Xërxë;
17. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të Punë së Komitetit për Komunitete për vitin 2023;
18. Raporti vjetor për kontratat e nënshkruara publike - 2022 - Kontratat kornizë;
19. Informatë mbi menaxhimin e aseteve për vitin 2022;
20. Informatë nga DKA-ja për përfundimin e gjysmëvjetorit të parë të vitit shkollor 2022/2023;

Kryesuesi: Ky është rendi i ditës për këtë mbledhje. E kemi edhe një propozim për një pikë shtesë.

Afrim Dina: Faleminderit kryesues! I nderuar kryetar, nënkryetar, kolegë, të nderuar anëtarë të kuvendit. E kam një kërkesë për një vendim që ka të bëjë me ndarjen e një parcele për ndërtimin e fushës sintetike për klubet e futbollit në Komunën e Rahovecit. Ky projekt bëhet me bashkëfinancim me federatën e futbollit.

Kryesuesi: Atëherë këtë propozim po e vendosim në votim. Kush është “për”?... Me shumicë unanime, shtohet edhe kjo pikë në rend të ditës. Rendi i ditës i ka 21 pika. Nëse dikush tjetër nuk ka ndonjë koment rreth rendit të ditës, po e vendosim në votim. Kush është “për”?... Me shumicë unanime miratohet rendi i ditës për seancën e sotme.

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;

Kryesuesi: A ka dikush prej anëtarëve të kuvendit ndonjë koment rreth procesverbalit nga mbledhja e kaluar?... Nëse jo, atëherë po e vendosim në votim. Kush është “për”?... Me shumicë unanime, miratohet procesverbali i mbledhjes së kaluar.

2. Pyetjet dhe përgjigjet në pyetjet e kuvendarëve;

Bjondina Kleqka: I nderuar kryesues, kryetar, nënkryetar, kolegë keshilltarë. E kam një pyetje për drejtorin e arsimit, Avni Morina. E dimë që në shkollën “Bekim Sylka” janë duke u bërë disa riparime (me eficiencë të energjisë) në hapësirën e brendshme të këtij objekti. Kur nxënësit dhe mësimmshënësist e kësaj shkolle do të kthehen në objektin e tyre?

Bejtullah Deliu: Përshëndetje kryesues, kryetar, zëvendës, drejtorë të drejtorive, kolegë, nxënës të pranishëm. Një pyetje për Drejtorinë e Shëndetësisë dhe atë të Inspektoriatit. Me vendim të komunës, është e rregulluar që një barnatore të jetë kujdestare gjatë natës. Dje, personalisht pata një fatkeqësi, rreth orës 01:25 minuta e mëngjesit më është dashur të blej barna. Fatkeqësisht asnjë barnatore nuk ishte e hapur. A ka përcjellje nga inspektorët?... Faleminderit!

Rasim Fazliu: Përshëndetje për juve, kryetarin e komunës, anëtarët e kuvendit, drejtorët, mediat, përfaqësuesit e OSBE-së dhe nxënësit e pranishëm këtu. E falënderoj drejtorin e bujqësisë që e ka kthyer përgjigjen në një pyetje paraprake timen. Pyetja ka qenë rreth kanalit të kullimit të tokave (Fortesë - Celinë). Në përgjigje shumë gjëra janë thënë dhe kanali do të jetë me gypa, i mbyllur. Uroj që gypat e mbyllur të jenë funksionalë. Meqenëse drejtori nuk qenka këtu, në mbledhjen e radhës duhet të tregojë nëse ka shumë gjatësi të gypave të mbyllur apo vetëm në vendet ku duhet të kalojë rruga. Përndryshe, shumë mirë është që po bëhet kullimi i tokave.

Ilir Pallqa: I nderuar kryesues, kryetar, kolegë asambleistë, drejtorë, të pranishëm në sallë. Po flas pak rreth sheshit në qendër të qytetit. Kur kanë nisur diskutimet për atë minishesh, fillimisht jam gëzuar me shpresën që do të ndërtohet diçka më e mirë, më lehtë e qarkullueshme për automjete, ose më saktësisht të bëhet një zgjidhje e menduar mirë në çdo kënd. Nuk keni ofruar zgjidhje, keni shkaktuar kaos dhe shprehimisht shumë banorë janë të zhgënjyer me atë projekt edhe strukturalisht edhe për pamundësinë e qarkullimit të automjeteve. Ju kuptoj, jeni harxhu, po pritoni. Pritoni ta lodhni kokën që para punimit të ndonjë projekti, të hulumtoni më shumë. Ju kuptoj edhe kur pritoni, duke e harxhuar gjithë atë energji në punësime partiake e familjare, shpërndarjen strategjike të subvencioneve dhe jo vetëm. Pritoni edhe duke i lutur operatorët të presin edhe ndonjë ditë për borxhet që i ka komuna. Këto janë punë të rënda, shkaktojnë lodhje dhe për shkak të këtyre lodhjeve të kota, zhvillimi në komunën tonë është në rënie të lirë tash e disa vite. Zgjidheni gjendjen kaotike në qendër.

Lirigzon Kastrati: Faleminiderit kryesues, kryetar, ekzekutiv, kolegë, media. I kam dy pyetje për ekzekutivin në dësinë e kuvendarit dhe të anëtarit të Komitetit për Shëndetësi, pyetjet janë kryesisht për Drejtorinë e Shëndetësisë dhe të Shërbimeve Publike. Është një kërkesë e banorëve të fshatrave Hoçë e Vogël – Brestoc, që ka të bëjë me funksionalizimin e AMF-së. A mund t'i ofrojë Drejtoria e Shëndetësisë së paku gjysmë orari?...

Pyetja tjetër ka të bëjë me rregullimin e rrugëve fushore. Jemi në prag të pranverës dhe ato rrugë duhet të jenë të kalueshme që bujqve t'u mundësohet punimi i tokave (Hoçë e Vogël, rruga e ashtuquajtur e "para-katunit").

Kryesuesi: Faleminiderit Lirigzon! Dikush tjetër?... Atëherë nëse e keni përfunduar me pyetje, e ftoj fillimisht drejtorin Avni Morina për përgjigje.

Avni Morina: Përshëndetje kryesues, kryetar, drejtorë të drejtorive, anëtarë të kuvendit, të nderuar nxënës. E nderuar Bjondina Kleqka, pyetja juaj është shqetësim me vend. I kemi dy projekte cilat jemi duke i zbatuar, projekti i efikasitetit të energjisë, që ka mbetur vetëm ndriçimi i brendshëm dhe deri me 15 mars do të jetë gati dhe projekti për riparime të brendshme në shkollë, që tashmë ka përfunduar.

Erhan Morina: Faleminiderit kryesues. Të nderuar anëtarë të kuvendit, e kam një sqarim në lidhje me pyetjen e asambleistit Ilir Pallqa. Sa i përket projektit të sheshit në qendër, projekti në fjalë është hartuar nga një kompani projektuese. Duke angazhuar edhe ekspertë nga jashtë. Ka qenë në diskutim publik dy herë radhazi me qytetarë. Ky projekt ende nuk është përfunduar, është në vazhdimësi të punëve dhe me rregullimin e kohës do të përfundojë.

Kryetari: Përshëndetje për kryesuesin, nënkryetarin, anëtarët e kuvendit, drejtorët e drejtorive, OJQ-të, LMT-në, OSBE-në. Rreth shqetësimit të paraqitur të Bejtullah Deliut, është një rregullore e kuvendit të komunës, e cila mendojmë që nuk po zbatohet plotësisht. Është një angazhim i inspektoriatit të komunës, madje me gjoba mandatore (me shumë deri 50 euro, jo më të lartë), por përsëri po vazhdohet. Rreth shqetësimit të Rasim Fazliut, besoj që edhe Berat Duraku do të japë sqarime. Po, ka filluar faza e aplikimit për subvencione dhe i kemi disa punë teknike që shumë shpejt duhet t'i përfundojmë. Lirigzon Kastrati, shpresojmë të kemi mjekë, kemi shpallur një konkurs për 5 mjekë të rinj, do të vazhdojmë me konkurse për personel shëndetësor. Ka filluar aktiviteti për rrugë fushore nga operatori kontraktues, që e ka edhe zonën që lidhet me Hoçën e Vogël, Zoqishtin, Brestocin, Retijën, Opterushën... Ilir, ndoshta neve na ka lodhur aeroplani, kemi qenë jashtë shtetit. Punët e e papërfunduara nuk janë argumente të mjaftueshme për ta nxjerrë një vlerësim objektiv. Punimet në qendër do të vazhdojnë dhe do të merremi me trajtimin e kabllove elektrike që do të futen nën tokë dhe besoj që ky shesh nuk do të bëjë çrregullime. Do ta shohim mundësinë që aty ta bëjmë rrugën një - kahore. Aty të krijohet përshtypja që krijohet tollovi, sepse shumë vetura parkohen pa vend, gjithashtu kemi një mungesë të aktiviteteve policore.

Bejtullah Deliu: Kryetar, faleminiderit për përgjigje dhe angazhimin rreth pyetjes. Gjohet the që janë të vogla, gjithashtu nuk jam i mendimit që gjobat të rriten, por ekziston mundësia edhe një herë për bashkëbisedim me pronarët e barnatoreve.

Kryetari: Po, personalisht i kam takuar pronarët e barnatoreve. Ata zakonisht e bëjnë një plan bashkë, e respektojnë një periudhë, por pastaj fillojnë ta dobësojnë përkushtimin e tyre. Do ta marrim përsipër përsëri këtë shqetësim.

3. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim - vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit 01 Nr.406/22, i datës 28.12.2022, për miratimin e Planit të Mobilitetit Urban 2022- 2027;

Përparim Krasniqi: Faleminiderit kryesues! Përshëndetje kryetar, anëtarë të kuvendit. Është bërë një lëshim teknik të cilin do ta marr përsipër. Në tetë ligjet që janë referuar në Plan të Mobilitetit, tre prej tyre kanë pësuar ndryshime. Kanë kërkuar që të rregullohet ligjshmëria në tri ligje. Para jush e keni materialin e ndryshuar dhe kërkojmë nga ju aprovimin e këtij vendimi.

Burim Krasniqi: Përshëndetje kryesues, ekzekutiv, kolegë asambleistë, përfaqësues të KFOR-it, nxënës prezent. Drejtor, në seancën kur është votuar Plani i Mobilitetit dhe Plani për Transport, kam kërkuar të largohen nga rendi i ditës me arsyetimin që nuk janë dokumente formale, por janë dokumente të rëndësishme për komunën dhe kërkojnë më shumë rëndësi dhe kohë për shqyrtim. Nuk i keni trajtuar me rëndësi, sepse edhe baza ligjore ka gabime, kurse dokumenti brenda mund të jetë gjithçka, por serioz jo. Janë dokumente të zbrazëta dhe tendenca vetëm që të kalojë tutje diçka, për mua është e paarsyeshme. Për fushën që unë i takoj, dokumentet më të rëndësishme janë Plani i Transportit dhe i Mobilitetit dhe ju kërkoj të jemi serioz në këtë drejtim.

Përparim Krasniqi: Faleminiderit Burim! Të kam ftuar zyrtarisht nëpër diskutime publike për këto dokumente. E ke pasur mundësinë të japësh mendime dhe sugjerime dhe e di që je ekspert në këtë fushë. Plani i Transportit Rrugor ka kaluar ligjshmërinë, ndërsa Plani i Mobilitetit ka pasur një mungesë të vëmendjes nga grupi punues për këto

komandime në këto tri ligjet e para që kanë pësuar ndryshime, ndërsa në përmbajtje të Planit të Mobilitetit nuk kemi pasur as edhe një vërejtje.

Burim Krasniqi: Fiskulturat politike të mira janë ndonjëherë, por jo gjithmonë. Në asamble komunale jam për kontribut këtu. Për punë të tjera, janë zyrtarët e tjerë. Me shumë përgjegjësi e them që të dyja dokumentet janë të trazëta dhe nuk je inxhinier i komunikacionit, nuk e kupton fushën dhe nuk e di kë e ke pyetur prej profesionistëve.

Ilir Pallqa: Te Plani i Mobilitetit, nuk po flas për pjesën ligjore shumë, por për gjendjen faktite që e kam lexuar. Këtu jemi të informuar sado pak për gjendjen momentale, por jo për zgjidhjen e problemit. P.sh. te trafiku për këmbësorë është cekur që ka shumë mungesë të trotuareve dhe rruga që të çon në drejtim të Shkollës së Mesme “Xhelal Hajda” është specifikuar si shumë problematike. A do të funksionalizohet rruga njëkahore më shpejt në atë rrugë, apo do të vazhdojë diskutimi derisa të ndodhë ndonjë aksident fatal. Gjithashtu, në fshatra të komunës, ka shumë mungesë të trotuareve, kryesisht rrugët që të çojnë në drejtim të shkollës. P.sh. (Vrajakë). Te shtegu i biçikletave (rruga për Hamoc), gjerësia e shtegut është 60cm, kurse biçikletat me dy rrota janë zakonisht 60-70 cm të gjera dhe nevojiten 20 cm shtesë për ta ruajtur ekuilibrin. Gjerësia, faktikisht, duhet të jetë minimumi një metër. Gjerësia më e vogël ndikon në çekuilibrim, vështirëson vozitjen dhe lë hapësirë për aksident. Te përshtatja e infrastrukturës për biznese, keni menduar që bizneseve t’i ofroni mundësi legale për vendosjen e automjeteve në trotuar, a e keni menduar zgjidhjen që të mos keqpërdoret kjo mundësi?... Së fundi e keni caktuar një zyrtar për mobilitet urban. Pse nuk e keni caktuar më herët?... Po harroni që drejtorët në ekzekutiv nuk janë për të kryer punë robotike, por duhet ta lodhin trurin pak. Ju jeni në pushtet që 8 vjet dhe Rahoveci për nga zgjidhja problematike dhe të mobilitetit është i njëjti që 10 vjet, nuk keni bërë asgjë. Komunitet e tjera, bagerat e kamionat i kanë në terren, në Rahovec është qetësi absolute, e frikshme.

Përparim Krasniqi: Faleminderit Ilir, sa për info., nuk je fokusuar mirë dhe nuk e ke lexuar sa duhet dokumentin. Plani i Mobilitetit përfshin zonën urbane dhe jo zonën që përfshihet jashtë qytetit të Rahovecit. Rruga Rahovec – Fortesë nuk është në Planin e Mobilitetit, gjithashtu as shtegu i biçikletave. Sa i përket Planit të Mobilitetit, pas vendimit të kuvendit, caktohet zyrtari për menaxhim, nuk mund të bëhet para vendimit. Në rrugën “Gëzim Hamza” dhe “Xhelal Halda” do të ketë punime shtesë në infrastrukturë, para se të vendoset në Plan të Mobilitetit.

Ilir Pallqa: Është mirë që drejtori mos të flasë me arrogancë, këtu është për të dhënë përgjegjësi. Projektin e kam lexuar të tërën. Te pika e trafikut për çiklist është e përshkruar dhe shtegun dje e kam matur (është 60cm) dhe 60cm është vetëm gjerësia e biçikletës. Po flas pa arrogancë, me qetësi dhe dashuri.

Merisa Sharku: Përshëndetje për të gjithë! Gjatë shfletimit të Planit të Mobilitetit, shihet që strategjitë i keni të mira dhe shpesh e kam cekë që punët i bëni vetëm për tik-at. Punën kur e bëni duhet ta përfundoni në mënyrë të dukur. Këtu ceket që rrugët janë të asfaltuara me kualitet të lartë. Rrugët e qytetit janë totalisht të shkatërruara, për fat jam shofere dhe duke vozitur duhet shmangur gropave të shumta. Jeni munduar të bëni diçka në lidhje me personat me aftësi të kufizuara, por punët janë përfunduar në mënyrë jo të duhur. I kemi edhe disa foto të cilat janë për “meme”.

Kryetari: Plani i Mobilitetit është miratuar në kuvend të komunës. Me qetësi, respekt, pa arrogancë dhe me simpatinë më të madhe ju ftoj të jeni të përkushtuar dhe të angazhuar kur bëhet fjalë për dokumente të cilat kanë peshë të madhe. Natyrisht që ne angazhohim edhe shumë ekspertë të cilët janë për këto punë dhe drejtori ka detyrën e menaxhimit të të gjitha atyre ideve pozitive dhe të kontributeve të veçanta që i japin ata. Edhe ti Merisë je profesioniste e fushës dhe pse jo, ta jepni mendimin tuaj me kohë në të gjitha çështjet të cilat lidhen me aspekte rreth një infrastrukture sa më moderne. Projekti për të cilin fole ti, ka pasur vlerësime shumë të mira nga DEMOS-i. Ndërsa Iliri ka nisë të bëhet më aktiv tani, ditë më parë ka pushuar sado pak. Para se të vijmë këtu në kuvend, pse jo, mund të japë edhe ide të tjera dhe nuk kemi pritëse për akceptim.

Merisa Sharku: Kryetari në shpjegim, tha që kemi marrë vlerësime nga DEMOS-i, por pak mund të ketë lajthitje gjatë implementimit. Më e rëndësishme, sipas meje, është rezultati final në terren. Sa i përket kontributit tonë, kemi dhënë kontribut në rastin e sheshit në qendër, në fund, këshillat tona nuk po dëgjohen. Një çështje tjetër te sheshi në qendër, the që do të provojmë ta bëjmë rrugën aty afër, një - kahore. Mirë është që kjo çështje të mendohet mirë, sepse ka shumë ankesa prej qytetarëve që mos të bëhet një - kahore.

Kryesuesi: Unë jam që diskutimet të zhvillohen, por diçka që është dashur të diskutohet në pikën e dytë, mund të diskutohet në po atë pikë. Nuk do të kthehmi pas, të pathënat mund t’i diskutojmë në seancën e radhës.

Kryetari: Tani bëhet fjalë për plotësim - ndryshim të Planit, në mënyrë që ky plan të jetë në përputhshmëri të plotë me bazën ligjore. Sfidat e implementimit mund të jenë çdo herë, sepse edhe operatorët mund t’i kenë sfidat e veta.

Punët në sheshin në qendër nuk kanë përfunduar dhe rruga njëkahëshe nuk bëhet pa ekspertizë. Çrregullimi ka të bëjë më shumë me elementin e papërgjegjshëm që i parkojnë makinat aty dhe mungesën e veprimit të mjaftueshëm të policisë në atë pjesë.

Kryesuesi: Faleminderit kryetar! Atëherë, pikën e tretë të rendit të ditës po e vendosim në votim. Kush është “për”?... Abstenim?... Kundër?... Me 21 vota “për”, një abstenim dhe një kundër, kalon plotësim - ndryshimi i Planit të Mobilitetit Urban 2022 - 2027.

4. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim – vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit 01 Nr.404/22, i datës 28.12.2022, për miratimin e Planit të Vlerësimit të Rreziqeve nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë e Tjera për Komunën e Rahovecit;

Përparim Krasniqi: Faleminderit kryesues! Paraprakisht faleminderit për votimin e ndryshim - plotësimit të planit të mobilitetit. Sa i përket dokumentit të vlerësimit të rrezikut, ju njoftojmë që nuk ka pasur gabime në ligjshmëri, gabimet kanë qenë në strukturimin e këtij dokumenti. Komuna e Rahovecit është komuna e parë në nivel vendi që e ka kaluar këtë dokument, komunat e tjera janë në proces.

Sejfullah Sejfullahu: Faleminderit kryesues, përshëndetje për të gjithë! E vlerësoj materialin e Planit të Mobilitetit, por nuk mund ta bëj një vlerësim brenda ditës, sepse materiali ka ardhur dje.

Përparim Krasniqi: Ne e kemi kërkuar një sqarim prej Agjencionit të Menaxhimit të Emergjencave (AME), por dje na kanë konfirmuar në telefon që për shkak të ndërrimit të objektit edhe nuk kanë pasur mundësi ta dërgojnë e-mailin zyrtar. Ky dokument zyrtarisht ka kaluar, vetëm duhet të jetë i ndarë në tri pjesë.

Burim Krasniqi: Kryesues, e kam një pyetje për juve. A po ndiheni keq, me të gjitha këto rishqyrtime të vendimeve?

Kryesuesi: Faleminderit për pyetjen! Në seancën e parë të këtij viti kalendarik, në raportin vjetor kanë qenë gjithsej 7-8 vendime, janë kthyer në rishtyrtim të ligjshmërisë. Në takimet e rregullta me kolegjin e kryesuesve, Komuna e Rahovecit qëndron më së miri në këtë aspekt të rishqyrtimit. Atëherë nëse dikush tjetër prej anëtarëve nuk ka ndonjë koment?... Po e vendosim në votim. Kush është “për”?... Me 20 vota “për” miratohet edhe plotësimi i Planit të Vlerësimit të Rreziqeve nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë e tjera.

5. Shqyrtimi dhe miratimi i ndryshim plotësimit të Rregullores 01 Nr.05/23 të datës 30.01.2023 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores për Taksa Komunale 01 Nr. 80/20 e datës 29.06.2020, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren 01 Nr. 169/21 të datës 26.02.2021;

Erhan Morina: Faleminderit kryesues! I nderuar nënkryetar, drejtorë, anëtarë të kuvendit, media. Në seancën e janarit të këtij viti, është votuar plotësim - ndryshimi i rregullores me nr.80/20 për taksat dhe tarifa. Ky dokument në parim është miratuar nga MAPL-ja. Kërkesë e Ministrisë së Bujqësisë ka qenë që të shtohen edhe dy paragrafë të tjerë, rreth caktimit të tarifës për prerjen e pyjeve private dhe caktimi i tarifave për kullosa. Si komunë jemi të obliguar t'i inkorporojmë këto tarifa në rregullore.

Kryesuesi: Faleminderit drejtor! A ka dikush diçka për të diskutuar rreth kësaj pike?... Nëse jo, atëherë po e vendosim në votim. Kush është “për”?... Me shumicë unanime, miratohet edhe pika e 5-të e rendit të ditës.

6. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për faljen e borxheve të papaguara për taksat në aktivitete (afariste), nga data 1.1.2000 – 31.1.2017;

Erhan Morina: Të nderuar anëtarë të kuvendit, para jush keni materialin e propozim - vendimit për faljen e borxheve të papaguara të taksave afariste, bëhet fjalë për të gjitha borxhet e akumuluar nga viti 2000 deri më 31 dhjetor 2017. Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm, propozon që këto borxhe të falen me qëllim që ky borxh i “keq” mos ta ngarkojë performancën komunale. Bizneset me këtë borxh aktualisht janë fiktive (pa pronarë), inkasimi i këtyre mjeteve pothuajse është i pamundur.

Kryesuesi: Në mbledhjen e KPF-së, si kryesues, kam kërkuar që në seancën e rregullt të bashkëngjitet materiali, por drejtori e ka parë të arsyeshme që ta thotë gojarisht.

Burim Krasniqi: Drejtor, the që borxhet janë të akumuluar prej bizneseve që sot nuk janë funksionale. A ka biznese funksionale që kanë borxhe?... Edhe këtyre jofunksionale që iu falet borxhi deri në 2017, a do ta kenë kusht që pjesën tjetër ta barazojnë?... Në vendim nuk po shoh diçka të ngjashme. Mendoj që duhet të jetë edhe një nen tjetër ku kërkohet që të lshyhen borxhet tjera 2017-2022. Nuk jam ekonomist me profesion, por mendoj që bizneset duhet të obligohen që ta paguajnë borxhin 2017-2022 si kriter për faljen e borxhit 2000-2017.

Sinan Kryeziu: Faleminderit kryesues, përshëndetje për të gjithë të pranishmit! I inkurajoj për votim në këtë pikë

sepse nga ana ligjore konsiderohet parashkrim. Te personi juridik, parashkrimi, sipas ligjit, është 3 vjet. Te personi fizik është 1.5 vjet. Personi juridik ka të drejtë të bëjë prapësim në përmbarim, nëse kemi propozim për përmbarim.

Leonard Morina: Përshëndetje kryesues, nënkryetar, kolegë, drejtorë, media! Meqenëse ky material nuk është i kompletuar, nuk jemi në dijeni sa firma janë, sa është shuma e faljes, a ka firma që ekzistojnë?... Nëse është vetëm te performanca, besoj që nuk është në rregull vetëm për performancë ta dëmtojmë komunën në buxhet në këmbim të një letre të mirë.

Lirigzon Kastrati: Faleminderit kryesues, të nderuar anëtarë! Sa i përket kësaj pike, dua ta pyes drejtorin pse kanë lindur këto borxhe? ... A janë marrë veprimet e nevojshme ligjore para se këto borxhe të akumulohen?... Realisht duhet të njoftohemi të gjithë që komuna kërkon faljen e borxheve të cilat e kanë humbur afatin ligjërisht. Kjo është çështje politike, sepse këto borxhe nuk mund të inkasohen. Më pëlqeu propozimit i shefit, z. Burim, që të vazhdohet me një procedurë për faljen e borxheve që bizneset që kanë borxhe deri në vitin 2017, duke përfutur nga ky vendim i kuvendit, t'i paguajnë borxhet pas 2017-tës.

Ilir Pallqa: Faleminderit kryesues! Nuk kam pyetje, kam thirrje. Falja e borxheve nga ana e Komunes është thirrje për mosrespektim të institucionit, mosbindje ndaj përgjegjësisë që e ka secili që i gëzon asetet komunale, destimulim për ata që i kanë paguar borxhet. Sinqerisht, e pakuptimtë falja e borxhit nga Komuna. Privatist mund të falim borxhe, jo si përgjegjës publik. Pastaj, çfarë dobie ka Komuna me faljen e borxheve ndaj afaristëve?... Duhet ta kemi parasysh që afaristët që i kanë lokalet komunale, qiratë i kanë më të ulëta sesa këta që i kanë lokalet private. Me këtë rast, po bëhet padrejtësi për shkak të dallimit në pagesë, kësaj ia shtojmë mospagesën dhe në fund faljen e borxhit. Borxhet nuk duhet të falen, duhet të ndëshkohet vonesa e borxhit.

Burim Krasniqi: Drejtor, nuk kam pa prej praktikave deri sot, që komuna iu dërgon bizneseve fletëdërgesë për borxhe që i kanë për taksa komunale. A ka ndodh në mandatin tënd t'i dërgoni (fatura)?...

Sejfullah Sejfullahu: Faleminderit kryesues! Është mirë që t'i falni borxhet deri në 2020 se m'u drejtua edhe mua. Kryesisht borxhet e mia janë pas 2018-tës. Në komunën tonë, 4-5 kompani ia shohin "hajrin" komunës, ne të tjerët jemi të ndëshkuar, kështu që është mirë deri në 2020-tën të jetë ky vendim.

Rasim Fazliu: Faleminderit kryesues! Unë jam "për" faljen e borxheve të këtyre taksapaguesve afaristë të Komunes së Rahovecit. Mendoj që para faljes së borxhit, drejtori duhet të na bie listën e borxhlinjve dhe shumën e borxhit, pastaj e shikojmë vlerën edhe e kryejmë veprimin. Meqenëse sot nuk mund të na siguron këto të dhëna, atëherë këtë pikë është mirë ta shyejmë për trajtim për mbledhjen e radhës.

Erhan Morina: Faleminderit për të gjithë që parashtruat pyetje! Aktualisht, në Komunën e Rahovecit, janë të regjistruara 4216 biznese, që nga viti 2000 deri më sot, 1800 prej tyre janë aktive, 1712 janë pasive, 688 është numri i bizneseve të shuara. Bëhet fjalë për një borxh të bizneseve, me rreth 57% janë pasive ose të shuara, vlera e këtij borxhi është rreth 509.000 euro. Ky problem është analizuar shumë mirë dhe fare nuk ka të bëjë me çështje politike, por ka qenë rekomandim prej auditorit të jashtëm.

Kryesuesi: Faleminderit drejtor! Pa ndonjë qëllim të keq, besoj që informata më të hollësishme është dashur të kenë secili anëtar në formë të shkruar. Atëherë, fillimisht propozimin e Rasim Fazliut për shtyerjen e kësaj pike të rendit të ditës, që t'i bashkëngjitet materiali shtesë në seancën e ardhshme. Kush është "për"?... Atëherë me 15 vota "për" dhe 14 kundër, kalon propozimi i Rasim Fazliu dhe kjo pikë shtyhet për në seancën tjetër.

7. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për shfuqizimin e vendimit 01 Nr.149/2006, i datës 14.07.2006;

Erhan Morina: Faleminderit kryesues! Para jush keni materialin për shfuqizimin e vendimit Nr.149/2006, i datës 14.07.2006 për dhënien në shfrytëzim në kohë të caktuar prej 10 vitesh, të pronës së paluajtshme të Komunes, ky vendim është i skaduar dhe nuk prodhon ndonjë efekt juridik, por shfrytëzuesi i deritanishëm nuk i përgjigjet ftesës sonë sepse nuk gjendet në Kosovë, kërkojmë ta shfuqizojmë dhe të vazhdojmë me procedura të tjera për ta futur përsëri në ankand publik.

Burim Krasniqi: Faleminderit drejtor! E the edhe vetë që vendimi nuk ka efekt juridik, pse ka nevojë të votohet, në momentin që kanë kaluar 10 vjet, ky vendim shfuqizohet me automatizëm. Këtu mund të vije propozim - vendimi për shpalljen në ankand të parcelës dhe jo të shfuqizojmë vendim që ka efekt juridik. E paarsyeshme kjo punë. E keni edhe Sinanin në grup të asambleistëve, mund t'ju ndihmojë sado pak, sepse si jurist e respektoj shumë. Në qoftë se zyra ligjore thotë që duhet të shfuqizohet, atëherë pajtohem, por unë konsideroj që një vendim pa afat nuk ka logjikë ta votojmë edhe një herë.

Isak Hoti: Faleminderit kryesues! Ai që e ka marrë në shfrytëzim në vitin 2006, ka qenë i kujdesshëm në çdo aspekt, duke përfshirë këtu edhe marrjen e kontratës, që tanimë nuk e dimë ku është. Jemi të obliguar që në kadastër ta largojmë shfrytëzuesin. Shfrytëzuesin aktual nuk mund ta largojmë pa e pasur vendimin për prishje të kontratës. Në këtë rast ne nuk kemi kontratë. E vetmja që kemi është një vendim. Ai ka tentuar që edhe palës së tretë t'ia japë në shfrytëzim, gjë që ligji e ndalon një gjë të tillë. Tani, në mungesë të kontratës, jemi të obliguar ta marrim një vendim për shfuqizim të këtij vendimi dhe pastaj i fillojmë procedurat për ta dhënë në shfrytëzim.

Burim Krasniqi: Meqenëse është 10 - vjeçar, a shfuqizohet me automatizëm vendimi, kur të kalojë data e afatit të shfrytëzimit?... Konsideroj që Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër, ka mundur automatikisht pas kalimit të afatit (më 15.7.2006).

Isak Hoti: Në vitin 2006, kur ia ka dhënë komuna pronën atij, ka qenë e thatë (lëndinë). Sot, aty i kemi dy objekte pa leje ndërtimore, e keqja e kësaj është që edhe pajisjet milionëshe janë brenda, pajisje të cilat iu kanë shitur palës së tretë. Këtë gjendje duhet ta analizojmë në mënyrë më të mirë të mundshme, hapi i parë është ky, hapi i dytë është për dhënien në shfrytëzim për palën tjetër. Dy objektet që janë aty, me marrjen e këtij vendimi, kalojnë automatikisht në pronë të komunës, sepse nuk kanë leje ndërtimore. Nëse eventualisht, nëse objektet do të ishin me leje, Komuna duhet t'i kompensonte.

Kryesuesi: Isak, meqenëse i ka kaluar afati kohor, pse tani pas 6 vitesh, Kuvendi Komunal duhet ta marrë një vendim të tillë?...

Sejfullah Sejfullahu: E kanë lënë deri tani, sepse "ne jemi legjislacioni më inteligjent".

Isak Hoti: Është një djalë i papërgjegjshëm që ne nuk po mundemi ta gjejmë, aq i kujdesshëm ka qenë, sa që i ka vjedhur edhe kontratat që i kemi pasur në Komunë. E kemi vetëm një vendim të Kuvendit që ne duhet ta shfuqizojmë, sepse nëse fillon një procedurë gjyqësore, do të kemi probleme në pafundësi. Si përfundim, pas konsultave me komunat që kanë pasur situata të ngjashme, proceduralisht duhet ta bëjmë shfuqizimin e vendimit, sepse komuna përfiton duke mos e dëmtuar askënd.

Burim Krasniqi: Të dëgjova me vëmendje dhe e njoh problemin mirë. Asetet që janë brenda, janë asate të lëvizshme që i takojnë palës, komuna nuk ka të bëjë me ato makineri. Ne sot mund ta shfuqizojmë këtë vendim që i ka dalë afati, për të cilin nuk jam "pro" dhe nesër ta vendosim në ankand, për çka?... për t'i dhënë në shfrytëzim objektet pa leje ndërtimi?... Ka procedura të tjera para se të vijmë te ankandi. A ka paguar qira ai, pas vendimit deri më sot? ... Nuk është e thjeshtë, është shumë e komplikuar. LDK-ja nuk e voton këtë vendim.

Bejtullah Deliu: Faleminderit kryesues! A po na krijon tani kjo një precedent tjetër ndërkohë. Në rastin konkret, kjo i bie që "merre token në shfrytëzim, ndërto, e më vonë e bëjmë legalizimin" d.m.th kanë kaluar shumë vite dhe nuk është ndërmarrë asnjë hap. Përgjegjësi të madhe kemi si kuvendarë e sidomos ekzekutivi i komunës.

Sejfullah Sejfullahu: Me para, nëse e shfuqizojmë dhe ia japim dikujt në ankand, problemet që janë në atë objekt, e bëjnë që askush tjetër mos ta marrë. Duhet të jemi në dijeni nëse është ndonjë marrëveshje që e kanë bërë ata, por në fund nëse nuk ekziston marrëveshja, lëreni të rrijë ashtu siç është, qiraja ec tutje dhe në fund Komuna ia konfiskon shkaku i qirasë.

Sinan Kryeziu: Sa e kuptova nga parafolësit, kjo nuk qenka çështje civile por penale (mashttrim). Nuk e di a është bërë kallëzimi penal. Në momentin kur është në kontekst në mes të dy palëve apo palës së tretë, duhet të vendoset një masë sigurie, kjo është çështje e gjyqësorit, jo e asamblesë. E pyes Isakun nëse ka shkresa nga ana e gjykatës.

Rasim Fazliu: Faleminderit kryesues. Unë pajtohem me mendimet e kolegëve. Mendoj që të gjitha pronat komunale që jepen në shfrytëzim dhe kanë një afat të caktuar, duket që zyrtarët ligjorë t'i përcjellin këto afate, faktikisht, i bie që në 2016, i ka kaluar afati, tani jemi në 2023. Për mua është shqetësuese kjo, duhet përcjellë kontratat dhe në çastin kur t'i kalojë afati, të vije në Kuvend për ta ndërprerë ose vazhduar.

Isak Hoti: Sinan, nuk kemi nevojë me dërgu në gjyq, kur jemi duke kërkuar ta marrim vetëm tokën tonë (tokën e Komunës). Kërkojmë t'ia marrim ato dy objekte atij (si aset i Komunës në të ardhmen), që ai i ka ndërtuar pa leje. Rreth çështjes se a duhet dikush t'i përcjellë këto kontrata, janë përcjellë me kujdes, por për shkak të problemeve, kemi qenë të obliguar që personit në fjalë, të cilin nuk mund ta gjejmë, ia kemi dërguar 3 ftesa, nuk është përgjigjur dhe tani nuk kemi nevojë ta pyesim se çka të bëjmë me pronën tonë, por si procedurë duhet ta përfundojmë dhe zhvillojmë, votojeni si vendim. Nëse dikush mendon që ka diçka prapavijë këtu, i pari që duhet të shkojë "aty ku nuk duhet", jam unë.

Ilir Pallqa: Sa herë po flet Isak Hoti, nuk e di pse, por çdo herë më duket që ka diçka me prapavijë.

Hasan Përboqi: Nuk mund t'i themi që e ka me prapavijë sepse ai është zyrtar ligjor dhe në këtë rast nuk duhet të kërkohet interpretime prej tij nëse kemi dyshime.

Ilir Pallqa: Ne e dimë që ka gjëra faktike dhe juridike. Isaku, juridikisht është zyrtar ligjor, faktikisht është artist.

Kryesuesi: Faleminderit shumë, nëse edhe dikush nuk ka diçka për të thënë, atëherë po e vendosim në votim. Kush është "për"?... Kundër?... Abstenim?... Atëherë me 14 vota "për" dhe 15 kundër, nuk kalon miratimi i vendimit për shfuqizimin e vendimit 01 Nr.149/2006, i datës 14.7.2006.

Para se të fillojmë me pikat e rendit të ditës, një njoftim për të gjithë anëtarët e kuvendit. Prej muajit mars, fillon raportimi apo deklarimi i rregullt i pasurisë. Këtë vit, Agjencioni Kundër – Korrupsion, deklarimin e ka bërë në mënyrë elektronike. Ju lus të gjithëve që në muajin mars ta bëni deklarimin e pasurisë në kohën dhe mënyrën e duhur, duke iu shmangur problemeve të ndyshme.

Kryetari: Përshëndetje për të pranishmit. E pata një detyrë tjetër dhe u informova që është hequr prej rendit të ditës, shfuqizimi i vendimit për dhënien në shfrytëzim në kohë të pacaktuar të një parcele. Zakonisht kur mungoj, dikush e shfrytëzon rastin dhe bën veprime të cilat kanë nevojë për sqarime. Ne kemi obligim ta shfuqizojmë me vendim kontratën e skaduar të një parcele e cila është në shfrytëzim, e lidhur më 2006 (në kohën kur ka qeverisur LDK). Gëzim Shala e posedon në shfrytëzim i cili është jashtë vendit dhe nuk e dimë se ku është, i njëjti vazhdimisht i ka nxjerrë telashe komunës. Dikush e ka zhdukur kontratën. Meqë kontrata për atë objekt nuk ekziston, ne jemi të obliguar ta shfuqizojmë vendimin sepse nuk ekziston kontrata më për atë objekt. E ftoj edhe një herë Kuvendin e Komunës që ta rikonsiderojë edhe një herë këtë pikë të rendit të ditës, sepse ne duhet t'i japim përgjigje juridike si organe kompetente – ligjërish. Shfrytëzuesi aktual ka investuar shumë aty, por ne nuk guxojmë ta vazhdojmë marrëdhënien e jashtëligjshme me shfrytëzuesin aktual, i cili ka bërë transaksion me shfrytëzuesin e parë. Shfrytëzuesi i parë, tashmë, nuk ka asnjë lloj adrese. Ju ftoj ta riktheni pikën dhe ta votojmë shfuqizimin për të vazhduar me procedura të tjera ligjore - administrative.

Kryesuesi: Faleminderit kryetar! Pas këtij propozimi, tashmë është bërë precedent edhe në seancat e kaluara, i ftoj shefat e grupeve për fjalë.

Burim Krasniqi: Faleminderit kryesues! Kryetar, si me qenë prezent ju, si mos me qenë, qëndrimin tim e them ashtu siç është. Problemin me "fenomenin" Gëzim, e dimë. Nuk jemi të interesuar që çëshjen ta lëmë pezull e të presim që të lajmërohet ndonjëherë ndonjë "Gëzim". Është e palogjikshme ta shfuqizojmë një vendim të cilit i ka skaduar afati para 7 vitesh. Nuk e di që ka jurist edhe thotë që, shfuqizoni një vendim, i cili nuk ka afat. Kur të vije propozimi për shpalljen në ankand, LDK-ja e voton.

Kryetari: Edhe unë jam ithtar i pikëpamjes që nuk ka nevojë për shfuqizim, por ne gjithmonë duhet ta kemi planin B ose C, sepse aty kanë ndodhur investime dhe objekti është ndërtuar, shfuqizimi për ne është siguresë, e krijon një argument shtesë si masë mbrojtëse, Burim, kuvendi për ne është siguresë, është procedurë shumë normale dhe formale. Ju propozoj rikthimin e pikës në rend dite.

Rasim Fazliu: Faleminderit kryesues! Kur të miratohet rendi i ditës, çdo lëvizje që bëhet më pas, është e jashtëligjshme. Sa i përket kërkesës së kryetarit, me përgjegjësinë më të madhe i them që ne nuk jemi për mosmiratim të kësaj pike, mirëpo për shkak të dyshimeve dhe të paqartësive, pasi ka pritur 7 vite, duhet të presë edhe pak, që në mbledhjen e radhës, të vije komplet materiali dhe zotohemi që e votojmë, si dhe nuk është mirë të luajmë me dinjitetin e këshilltarit, herë e kthejmë pikën, herë jo, kjo është joserioze. E lus kryetarin dhe kryesuesin të vazhdojmë me pikat e rendit të ditës siç kanë qenë.

Kryetari: Me respekt e dëgjova Rasimin. Çuditërisht edhe unë se si ka pritur 7 vjet. Çdo pritje e mëtutjeshme "na hap dorezat". Nuk bëhet fjalë për mosrespekt, për në disa tema duhet të reagojmë me kohë. Informata të tjera në seancën e marsit nga Komuna nuk ka, sepse do të jetë i njëjti material. Urgjenca e shfuqizimit të vendimit është legjitime dhe e madhe.

Sejfullah Sejfullahu: Me sa e kuptova unë, kjo më tepër është punë e prokurorisë. Në dy apo tre raste i kemi rikthyer pikat, sepse është shumë e vërtetë që na keni bindur. Nuk jemi fëmijë që tani brenda një ore përsëri ta ndërrojmë qasjen, ta tërheqim votën. Pas një muaji edhe unë do të votoj "pro".

Kryetari: Unë e di që është hequr ajo pikë, por nuk është mirë, sepse ajo pikë është votuar në rend dite. Meqenëse është votuar, unë jo rastësisht kërkoj rikthimin për votimin e shfuqizimin e këtij vendimi.

Kryesuesi: Atëherë, antëtarët e kuvendit janë ata të cilët duhet të vendosin përsëri me votë. Kush është "për" rikthimin e kësaj pike në rend dite?... Kundër?... Si kryesues i Kuvendit Komunal, rreshtohem me anëtarët e kuvendit

pa t'i krijuar zgjidhje situatave jo të favorshme. Pavarësisht arsytetimeve dhe informatava që i dëgjova, unë votoj kundër që kjo pikë të rikthehet në rend dite për sot.

Kryetari: E di që në këtë rast, vota kundër është votë e papërgjegjshme dhe e di që kjo situatë nuk do të jetë në seancat e ardhshme. I falënderoj Rasimin edhe Burimin, të cilët kanë qenë mirë të informuar për këtë çështje dhe kanë kontribuar që kjo pikë të hiqet. Kryesuesi duhet të jetë në dijeni që vota e tij e dyfishtë nuk duhet të anojë veç në kërkim e atyre që e kanë zgjedhur, sepse të njëjtit mund ta shkarkojnë dhe ta zgjedhin një tjetër. Ne kemi nevojë për kryesues kompetent.

Rasim Fazliu: Kryetari i nderuar, kuvend më të përgjegjshëm se ky, nuk ka në gjithë Kosovën, prandaj duhet të keni konsideratë në këtë që po flas. Ishin shumë korrektë, konkretë, jotendenciozë, pa ngjyra politike dhe do të ishte serioze për kuvendin nëse do të ishte rikthyer pika. Në mbledhjen e radhës, u zotua për shqyrtim dhe do ta kalojmë. Të ftoj për respekt në mënyrën e njëjtë, siç ne jemi me juve. Pajtohem 100% që pronari – Gëzimi, vërtetë është një matrapaz, sepse edhe në legjislaturat e kaluara kemi pasur kontakt me të. Ka kërkuar një sipërfaqe në shfrytëzim, nuk ia kemi dhënë për shkak të këtyre zhvillimeve që kanë qenë etj.. etj.. Do ta votojmë në mbledhjen e radhës.

Kryetari: Së pari nuk më keni mirëkuptuar. I keni hequr dy pika të rendit të ditës, njërin për mungesë shënimesh, që është shumë në rregull. Për pikën e dytë, këtu nuk është mirëkuptuar mirë. Vonesat na kushtojnë, zotëria nuk ka kontratë. Ai ka nevojë për sqarim, mos të vonohet ankandi.

Burim Krasniqi: Unë nuk e shfrytëzoj rastin e mungesës së dikujt. Te kontrata, përgjegjësia është individuale, jo politike edhe prindi im (baba Skenderi) nëse është dhe nëse e ka zhdukur, duhet të japë përgjegjësi ligjore. Burim Krasniqi si individ, ka mendim të kjashtë, nuk e voton shfuqizimin me afat të skaduar, sepse nuk mund ta bindë veten të shfuqizojë diçka që nuk ka afat. Nuk ka efekt juridik, është nul.

Kryetari – Ju lutem, kryesuesi është kompetent t'i udhëheq takimet e kuvendit, ju po e bëni inkompetent duke u munduar ta dirigjoni, kështu nuk është mirë. Burim Krasniqi kurrë mund të mos bindet me vetëveten, nuk i kam faj për këtë punë. Kemi konsultuar zyrën ligjore dhe jurista tjerë, sepse nesër zotëriu mund ta bëjë një padi dhe ky tjetër këtu që ia ka blerë atij. Argumentet tona duhet t'i fuqizojmë me kuvend të komunës si siguresë dhe ky le të voton kundër sa të dëshiron, është çështje e tij individuale.

Kryesuesi: Faleminderit kryetar, vazhdojmë me 5 minuta pauzë dhe rikthehemi...

Atëherë përshëndetje edhe një herë për të gjithë! Meqenëse kryetari nuk është këtu, besoj që i tregoni. E tha që kryesuesi nuk ka konstruktivitet, kjo është e padrejtë. Në çdo seancë, 80% e pikave votohen nga kryesuesi. Pavarësisht kësaj, kryesuesi e ka të drejtën e votës së dyfishtë, që me arsyeshmërinë e plotë e merr kahjen, të cilën e sheh të arsyeshme, në bazë të arsytetimeve nga Kuvendi apo ekzekutivi. Konstruktivitet këtu nuk tregojnë anëtarët e Aleancës, bashkë me kryetarin që asnjëherë nuk tentojnë t'i kuptojnë anëtarët e tjerë të kuvendit komunal. Mua nuk më dirigjon askush, nga anëtarët e kuvendit i kam marrë shumicën e votave dhe vazhdoj të jem kryesues deri në momentin kur shumica e Kuvendit e sheh të arsyeshme që unë duhet t'i udhëheqi seancat, apo përfaqësimin e Kuvendit komunal në përgjithësi.

Kryesuesi: Atëherë, fillojmë me pjesën e mbetur të seancës. I nderuar nënkryetar, anëtarë të kuvendit, drejtorë.

8. Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit për caktimin e komisionit për zgjedhjen e drejtorëve dhe të zëvendës drejtorëve në institucionet edukativo - arsimore;

Avni Morina: Bazuar në ligjin për arsim në komunat e republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 5, pika 3.1 e UA nr.151/2020. Procedurat e zgjedhjes, të emërimit, të përfundimit të kontratës dhe të emërimit të përkohshëm dhe duke u bazuar në këtë bazë ligjore, DKA-ja bën këtë propozim për antarë të komisionit përzgjedhës drejtorë apo drejtoresha, zëvendës drejtorë, zëvendës drejtoresha të institucioneve edukative - arsimore të komunës sonë. Propozimi është që të miratohen këta dy emra: Anëtar kryesues – Ardit Halilaj (zyrtar për arsimin e mesëm të lartë në DKA), Erseka Cana – anëtare e dytë – mësimdhënëse e programit fillor dhe anëtar i tretë përcaktohet nga MASHT-i. Kërkoj nga Kuvendi miratimin e këtyre propozimeve.

Lirigzon Kastrati: Të nderuar anëtarë të Kuvendit! UA-ja e përcakton funksionimin, përbërjen dhe procedurën për zgjedhjen e drejtorëve të shkollave. Anëtar i parë, apo kryetari i komisionit, është pranuar tani në punë dhe UA-ja kërkon (neni 7) përvojë tri - vjeçare në fushën e arsimit. Kërkoj sqarim nga ana e drejtorit.

Leonard Morina: I bashkëngjitem parafolësit dhe është dashur ta keni nga një CV të anëtarëve dhe ta shikojmë përvojën e tyre të punës, sepse ne do t'i ulim disa drejtorë përballë tyre që të merren në intervistë. Ndoshta drejtori i

ka 30 vjet përvojë pune, me kualifikim dhe në fund të ulen përballë njerëzve që janë punësuar që 1 muaj. Me sa kam info., kryetari i komisionit paska punuar në Gjakovë në arsim, por nuk e di a e plotëson kushtin prej 3 vitesh. Përndryshe, rastet e tilla do të përfundojnë nëpër gjykata si rastet e tjera.

Rasim Fazliu: Faleminderit kryesues! Desha ta pyes drejtorin nëse ka pasur kandidatë të tjetër të interesuar për këtë komision, nuk e di anën ligjore, por do të ishte më mirë të kishte edhe kandidatë të tjerë e që kuvendi të ketë mundësi të zgjedhjes. U bashkëngjitem parafolësve në lidhje me atë që duhet ta kenë CV-në.

Avni Morina: Këta dy emra për anëtarë të komisionit janë propozuar nga DKA-ja, bazuar në UA-në për detyrat dhe përgjegjësitë e drejtorit dhe të zv. drejtorit të institucionit publik edukativo - arsimor dhe aftësues parauniversitar në Republikën e Kosovës. Kjo punë nuk ka shkuar përmes konkurseve. Në udhëzim administrativ (UA), nuk thuhet që DKA-ja duhet të paraqesë CV-në e kandidatëve, por duhet të jenë me kualifikim adekuat.

Burim Krasniqi: A jemi në rregull ligjorisht me këta dy emra të propozuara nga DKA-ja?...

Avni Morina: Mendoj që po, sepse UA thotë që duhet të jenë me kualifikim, të paktën të barasvlefshëm me kandidatët për drejtorë të shkollave.

Fahrije Lushi: Te kandidati i parë, Ardit Halilaj, nëse ka punuar në Universitet të Gjakovës, në cilën pozitë ka punuar?... Nuk do të kishte hapësirë për këto pyetje nëse kishin qenë edhe CV-të e kandidatëve.

Avni Morina: Ju kërkoni CV-të e kandidatëve, por UA nuk thotë që duhet të sillen në kuvend CV-të e kandidatëve. Por nëse ju kërkoni një gjë të tillë, unë mund t'i marr të dhënat për ta dhe t'ju prezantoj juve.

Burim Krasniqi: Drejtor, mos na keqkupto, personalisht nuk e njoh Arditi. Nëse i ka përvojë pune 3 vjet, sipas UA-së, jemi në rregull, nëse nuk i ka, mos ta emërojmë dikë që nuk i plotëson kriteret.

Kryesuesi: Faleminderit drejtor, derisa ta gjeni informatën, vazhdojmë me pikën tjetër dhe pastaj rikthehemi te kjo pikë.

9. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim - vendimit për bartjen e mjeteve vetanake nga viti 2022, në vitin 2023;

Afrim Limani: I nderuar kryesues, kryetar, nënkryetar dhe ju asambleistë. Para jush e keni një propozim për bartjen e mjeteve nga 2022 në 2023, i cili bazohet në kuadër të ligjit të financave publike dhe përgjegjësi (neni 30). Shuma e mjeteve të bartura në total është 479.989.22euro. Në bazë të një analize të bërë nga Drejtoria për Buxhet dhe Financa, kemi bërë shpërndarjen e mjeteve, prioritet u kemi dhënë disa obligimeve financiare. Kemi ndarë rreth 60.000 për mallra dhe shërbime. Tjetër, ka qenë një kërkesë nga ana e asambleistit Rasim Fazliu, e kemi futur si projekt të ri dhe është fjala për ndërtimin dhe rregullimin e shtëpisë së kulturës në Celinë.

Lirigzon Kastrati: Rreth kësaj pike të rendit të ditës, pasi bartja e mjeteve është bërë në destinime të caktuara, megjithëse komuna ka mundur që ta përcaktojë radhën e përparësisë për projektet që janë më të nevojshme për qytetarët. Në të ardhmen, presim që planifikimet buxhetore dhe projektet kapitale të përfundojnë brenda një viti kalendarik dhe mos të krijohet për çdo vit suficit.

Rasim Fazliu: Faleminderit kryesues! Fillimisht e falënderoj Drejtorin e Financave për propozimin e bartjes së mjeteve nga 2022 në 2023. Drejtori e ceku propozimin tim. E falënderoj Kryetarin e Komunës, Drejtorin e Financave dhe Drejtorin e DKRS-së për këtë punë. Do ta votoj këtë bartje të mjeteve.

Burim Krasniqi: Te shpenzimet, një herë këqyret të shpenzohet granti qeveritar, më pas të hyrat vetanake, që mos të shkojnë në suficit, por ta kenë mundësinë e bartjes prej vitit në vit (është veprim logjik që e përdorin komunat). Janë disa pozita ose kode, rregullimi i varrezave në Celinë dhe Krushë të Madhe, vetëm 10.000 euro, ndërtimi i shtëpisë - muze në Krushë të Madhe, 25.000 euro. A janë këto obligime të punëve të kryera, apo...? Te mallrat dhe shërbimet - 60.000, te planifikimi urban dhe mjedisor, çka është menduar me këto në të ardhmen?...

Hasan Përboqi: Përshëndetje kryetar, kryesues, nënkryetar, kolegë, drejtorë, media! Ne, si grup i Aleancës, i ofrojmë mbështetje këtij propozimi të ekzekutivit. Propozimet e Drejtorit të Financave janë çdo herë me vend, sepse vetëm ai e di se ku janë punët më "ngushtë" dhe ku duhet paraparë mjetet.

Sejfullah Sejfullahu: Do ta votojmë bartjen, sepse gjërat e mira duhet t'i mbështesim. Faleminderit shumë për buxhetin e ndarë për shtëpinë - muze. Shpresojmë më shpejt t'ia fillojnë punimet.

Kryesuesi: Faleminderit! Dikush tjetër?... Nëse jo, atëherë po e vendosim në votim, kush është për?... Me shumicë unanime, aprovohet bartja e mjeteve vetanake nga 2022 në 2023... Nëse e ka gati informatën drejtori i DKA-së rreth çështjes së komisionit për zgjedhjen e drejtorëve dhe të zëvendës drejtorëve?...

Avni Morina: Atëherë, pas konsultimeve të bëra në DKA, rrjedh që kandidati i parë i propozuar për kryetar të komisionit nuk i paska 3 vjet përvojë pune, por vetëm 2.5 vite. Në përfundim erdhëm me një propozim tjetër: Vjollca Vuçitërna (Master - Kimi dhe përvojë mbi 10 - vjeçare në arsim).

Kryesuesi: Faleminderit drejtor! Atëherë, këtë pikë të rendit të ditës po e vendosim në votim, bashkë me propozimin e ri. Kush është për?... Me shumicë unanime, aprovet pika e tetë e rendit të ditës. Para se të vazhdojmë me pikën e 10-të të rendit të ditës, e kam një fjalë të shkurtër.

Kur e fillova fjalimin, e kam ditur që informatën do t'ia dorëzoni kryetarit, por nuk ia keni treguar në formën e duhur. Këtu ka ardhur një keqkuptim mes kryetarit dhe meje, për një fjalë jo të mirë që e patëm mes nesh. Meqenëse është këtu, më lejoni ta qartësoj. Unë nuk jam duke qëndruar kryesues me zor, e respektoj secilën votë të secilit anëtar dhe përderisa unë e kam besimin e këtij Kuvendi, vazhdoj të jem kryesues, pavarësisht asaj që nuk është e rëndësishme koha edhe sa do të jem kryesues. Maksimalisht që e kam respektuar deri tani ka qenë Kryetari i Komunës, respekt ky, që nuk ka qenë i ndërsjelltë. Kryetar, nëse mendon që mund ta zmadhosh grupin e Aleancës, i cili po zmadhohet shumë, por edhe zvogëlohet ndoshta, mund të marrësh hapa konkretë ligjorë për zëvendësimin e kryesuesit dhe besoj që e kam dëshmuar që nuk e kam asnjë problem në këtë aspekt.

Kryetari: Kryetari i Komunës nuk shkarkon, as nuk emëron kryesues. Nëse e kisha pasur këtë kompetencë, Defrim Kafexhiu nuk do të ishte kryesues, sepse e kam njohur pas zgjedhjes anëtar i kuvendit dhe jo më herët. Mendoj që kryesuesi duhet të reflektojë ndjenjë të lartë të përgjegjësisë, të korrektësisë dhe të sinqeritetit, duhet të jetë i paanshëm dhe nuk duhet të merret me fushata e ideologji politike sepse është kryesues, si asambleist po, gjithmonë ka të drejtë. Të çmoj si djalë të ri, por karriera jote nuk duhet të ndërtohet me një pozicionim të tillë. Kuvendin e ftoj për më shumë pozitivitet dhe më pak inate.

Kryesuesi: Nuk besoj që mua më mbron Kryetari, vetëm një e them, që për djalë të mirë nuk më mban këtu, pavarësisht kësaj, kam respekt për çfarëdo iniciative që vjen për anëtarëve të kuvendit dhe që e shohin të arsyeshme me vendos ndryshe.

10. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për dhënien e pronës në shfrytëzim afatshkurtër personave fizikë dhe juridikë dhe zhvillimin e procedurave të ankandit publik P-01952-1, zona kadastrale Ratkoc;

Erhan Morina: Faleminderit kryesues! Para jush keni propozim - vendimin për dhënien e pronës në shfrytëzim afatshkurtër personave fizikë dhe juridikë dhe zhvillimin e procedurave të ankandit publik P-01952-1. Bëhet fjalë për tregun ditor i cili gjendet në Ratkoc.

Kryesuesi: Faleminderit drejtor! A ka dikush diçka prej anëtarëve të kuvendit rreth kësaj pike?... Nëse jo, atëherë po e vendosim në votim, kush është "për"?... Me shumicë unanime miratohet pika e dhjetë.

11. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale P-01952-1;

Erhan Morina: Faleminderit kryesues! Para jush keni propozim - vendimin për formimin e komisionit, kjo pikë ndërlihet me pikën paraprake. Duhet t'i zhvillojmë procedurat edhe të krijojmë komisionin prej 5 anëtarëve (2 nga ekzekutivi, 2 nga kuvendi, 1 nga sektori joqeveritar).

Kryesuesi: Po i ftoj grupet e asambleistëve që t'i japin propozimet e tyre.

Hasan Përboqi: AAK, ne propozojmë Feriz Thaqin.

Vlora Vuçitërna: LVV, ne propozojmë Leonard Morinën.

Edonë Kryeziu: LDK, propozojmë Lirigzon Kastratin.

Sejfullah Sejfullahu: PDK, nuk ka kandidat.

Kryesuesi: Faleminderit! Atëherë meqë kemi tre propozime, vazhdojmë me votim.

Rasim Fazliu: Mendoj që është mirë që VV dhe LDK të merren vesh që njëra një komision, tjetra një tjetër. Mos të shkojmë në votim, thjesht mendim personal, vazhdojmë.

Kryesuesi: Faleminderit shumë! Në mungesë të vullnetit, vazhdojmë me mënyrën e njëjtë të zgjedhjes së anëtarëve, sikurse më herët. Feriz Thaqi (AAK), kush është "për"?... Leonard Morina (LVV), kush është "për"?... Lirigzon Kastrati (LDK), kush është "për"?... Atëherë, si pjesë përbërëse e këtij komisioni, dy asambleistët më të votuar janë: Leonard Morina dhe Lirigzon Kastrati. Po e vendosim në votim si të tillë, kush është "për"?... Me 14 vota "për" miratohet pika e 11-të.

12. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim - vendimit për dhënien e pronës në shfrytëzim afatshkurtër personave fizikë dhe juridikë P-02240-73, zona kadastrale Rahovec;

Afrim Oruqi: Faleminderit kryesues, para jush keni propozimin e kryetarit të komunës, për dhënien e pronës me qira, personave fizikë dhe juridikë në afat prej 15 viteve P-02240-73 (2 ha, 50 ari e 99m katror), zona kadastrale Rahovec, qëllimi është zhvillimi i turizmit dhe i rekreacionit.

Kryesuesi: Faleminderit drejtor! A ka dikush diçka prej anëtarëve të Kuvendit rreth kësaj pike?... Nëse jo, atëherë po e vendosim në votim, kush është “për”?... Me shumicë unanime miratohet pika e dymbëdhjetë.

13. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim - vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale P-02240-73;

Afrim Oruqi: Faleminderit kryesues, para jush keni propozimin për komisionin i cili do t'i zhvillojë procedurat për dhënien e kësaj prone me qira (që aktualisht morëm vendim) P-02240-73, komisioni ka si zakonisht 5 anëtarë.

Kryesuesi: Faleminderit drejtor! Sikurse komisionet paraprake, edhe këtu janë dy prej kuvendit, i ftoj grupet e asamblesë për propozime.

Hasan Përboqi: AAK, Feriz Thaqin.

Ilir Pallqa: LVV, e propozojmë Leonard Morinën.

Edonë Kryeziu: LDK, propozojmë Lirigzon Kastratin.

Sejfullah Sejfullahu: PDK, nuk ka kandidat.

Kryesuesi: Meqenëse përsëri i kemi tri propozime, vazhdojmë me votim. Feriz Thaqi (AAK), kush është “për”?... Leonard Morina (LVV), kush është “për”?... Lirigzon Kastrati (LDK), kush është “për”?... Atëherë dy përfaqësues të kuvendit, në këtë komision, janë: Leonard Morina dhe Lirigzon Kastrati. Kush është “për” komisionin si të tillë?... Me 15 vota “për” miratohet edhe pika e trembëdhjetë.

14. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim – vendimit për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit për zhvillimin e aktiviteteve për nevojat e komunitetit, të fshatit Kramovik P-00330-0;

Afrim Oruqi: Faleminderit kryesues, para jush keni propozimin për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit për zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme për nevojat e komunitetit në fshatin Kramovik P-00330-0, të ndajmë një pjesë të kësaj parcele për ndërtimin e objektit në sipërfaqe prej 4 ari.

15. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim - vendimit për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit për zhvillimin e aktiviteteve për nevojat e komunitetit të fshatit Polluzhë; - P – 00722-0;

Afrim Oruqi: Bëhet fjalë për parcelë me sipërfaqe prej 16 ari e 89 m katror P – 00722-0, ata kanë kërkuar prej neve që në sipërfaqe prej 2 ari, të caktojmë një lokacion me qëllim të ndërtimit të një objekti për nevojat e komunitetit. Ftoj anëtarët që t'i votojnë veç e veç të dyja pikat.

Rasim Fazliu: Faleminderit kryesues! E falënderoj drejtorin për prezantimin e këtyre dy pikave. Pyetja ime është nëse ka pasur kërkesë prej fshatit për këto gjëra dhe nëse po, pse nuk është materiali i bashkëngjitur i kompletuar?...

Afrim Oruqi: Faleminderit kryesues! Për të dyja propozimet ka kërkesa të fshatit Kramovik dhe Polluzhë, qëllimisht nuk i prezantojmë, sepse materiali shkon në MAPL për ligjshmëri dhe kërkesat i lëmë për konsum të brendshëm.

Kryesuesi: Faleminderit drejtor! A ka dikush diçka prej anëtarëve të kuvendit rreth kësaj pike?... Nëse jo, atëherë po e vendosim në votim, kush është “për”?... Me shumicë unanime miratohet pika e katërbëdhjetë.

Gjithashtu pikën e 15-të e prezantoi drejtori, nëse dikush prej anëtarëve ka diçka rreth kësaj pike?... Nëse jo, atëherë po e vendosim në votim, kush është “për”?... Me shumicë unanime miratohet pika e pesëmbëdhjetë.

16. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për këmbimin e pronës komunale me pronë private P- 01041-1, zona kadastrale – Xërxë;

Afrim Oruqi: Sipas ligjeve në fuqi, para jush e keni materialin për pëlqim për këmbimin e pronës komunale me atë private. Vendi i quajtur Skeja në Xërxë (12 ari e 31m katror), e cila i jepet në posedim Hysni Vehbi Thaqit nga Xërxa. Prona private është 14 ari e 72m katror, i jepet Komunës së Rahovecit, në emër të këmbimit për hapjen e rrugës publike, me qëllim të interesit publik.

Kryesuesi: Faleminderit drejtor! A ka dikush diçka prej anëtarëve të kuvendit rreth kësaj pike?... Nëse jo, atëherë po e vendosim në votim, kush është “për”?... Me shumicë unanime miratohet pika e gjashtëmbëdhjetë.

17. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të Punë së Komitetit për Komunitete për vitin 2023;

Kryesuesi: Është formë formale që duhet ta kalojmë këtë plan për shkak të ligjit, atëherë kush është “për”?... Me shumicë unanime miratohet edhe Plani i Punës së Komitetit për Komunitete.

18. Raporti vjetor për kontratat e nënshkruara publike 2022 - Kontratat kornizë;

Astrit Mullabazi: Përshëndetje të nderuar! Sipas raportit vjetor të kontratave të nënshkruara publike 2022, gjithsej janë 27 kontrata publike kornizë. Këto lloj kontrata janë sipas rregullores dhe udhëzuesit operativ për prokurimin publik (neni 56). Kontratat kornizë, afatin e kanë jo më shumë se 36 muaj me devijim të lejuar plus-minus 30% (furnizime, shërbime, punë).

Burim Krasniqi: Faleminderit për raportin! Kam dy pyetje, e para: Kontratat kornizë a duhet të jenë të mbuluara financiarisht komplet?... E dyta: A ka kontrata kornizë që e kanë tejkaluar buxhetin, që ka borxhe pas 3 vitesh, (a janë shpenzuar më shumë sesa është paraparë).

Astrit Mullabazi: Sipas ligjit të prokurimit, kontratat kornizë bëhen me çmim për njësi, vlera totale indikative e kontratës publike kornizë, duke përfshirë plus - minus 30%, pa marrë parasysh datën e skadimit të kontratës.

Burim Krasniqi: Këto kontrata kornizë, a janë mbyllë të gjitha financiarisht, a ka komuna borxhe për kontratat kornizë, sepse ju e bëni menaxhimin e kontratave.

Astrit Mullabazi: Menaxhimin e kontratave kornizë e bën menaxheri i kontratës me vendim nga Kryetari i Komunës. Te kontratat kornizë nuk kemi borxhe, bëhet sipas porosive.

Vlora Vuçiterna Çmega: Përshëndetje për të gjithë! Dua të ndërlidhem te kontratat për furnizim me material mjekësor (ampula emergjente dhe material sanitar). Duke pasur parasysh vlerën jo të ulët të kësaj kontrate, nga ana tjetër duke e ditur koston e një ampule, që mesatarja është 20 cent, dyshimi im është rreth asaj se çka është duke ndodhur me menaxhimin e barnave ampulare në QKMF dhe pse pacienti detyrohet që në orët e vona të natës të kërkojë barnatore në kujdestari për një ilaç të tillë, përderisa QKMF-ja duhet ta ketë ilaçin për shkak të ndjeshmërisë së rasteve që ndodhin.

Astrit Mullabazi: Sa i përket kontratës së furnizimit të materialit shpenzues në QKMF, kjo kontratë është ndarë në 4 lott-e, furnizim me material reagenca shpenzues për laborator, furnizim me material reagenca shpenzues për stomatologji, furnizim me barna ampulare emergjente dhe materiale sanitare. Këtu është kontratë kornizë për shkak të sasive.

Vlora Vuçiterna Çmega: Vlera e kontratës është 20.000 euro, një ampulë kushton vetëm 20 cent dhe përsëri të kemi mungesë në orët e vona sidomos në kujdestari, pak është e dyshimtë.

Kryesuesi: Faleminderit Astrit, Vlorë! Atëherë, nëse edhe dikush tjetër nuk ka diçka për të thënë rreth këtij raporti vjetor për kontratat kornizë, kalojmë te pika e 19-të.

19. Informatë mbi menaxhimin e aseteve për vitin 2022;

Erhan Morina: Si çdo vit kalendarik, Drejtoria për Ekonomi Zhvillim dhe Turizëm përgatit pikën informuese mbi menaxhimin e aseteve komunale. Gjatë vitit 2022, janë formuar këto komisione lidhur me pasuritë e Komunës së Rahovecit: Komisioni për regjistrimin e pasurive jofinanciare, komisioni për inventarizimin e pasurive jofinanciare, komisioni për tjetërsimin e pasurive jofinanciare dhe komisioni për asgjësimin e pasurive jofinanciare. Të gjitha këto komisione e kanë kryer punën me kohë, duke filluar nga procesi i regjistrimit të aseteve dhe inventarizimit në administratë, QKM dhe QKMF.

Burim Krasniqi: Raporti është shumë përmbledhës, por nuk ka vlerë për pajisje, p.sh: në tabelën e fundit thotë, kamionë ka 18.000 euro, duhet të jetë e specifikuar secili mjet për vlerën që e ka. Një komision po ashtu duhet të merret edhe me zhvlerësimin e vlerës ndër vite. Në pikën 19 dhe 20 të të njëjtës tabelë thotë: Vetura zyrtare (nuk ka vlerë monetare) dhe automjete të transportit (nuk ka vlerë monetare).

Erhan Morina: Sa u përket veturave zyrtare, veturat që i përdorë komuna janë jashtë standartit (të amortizuara 100% sipas vlerës së kontabilitetit).

20. Informatë nga DKA-ja për përfundimin e gjysmëvjetorit të parë të vitit shkollor 2022/2023;

Avni Morina: Përshëndetje edhe një here! Në këtë informatë kam paraqitur të gjitha aktivitetet e Drejtorisë së Arsimit gjatë gjysmëvjetorit të parë (katër muaj) të vitit shkollor 2022/2023. Me vendim të Ministrisë, periudhat janë kthyer përsëri me metodën e vjetër (2 periudha). Në informatë kam treguar faktin që, për ndryshim nga vitet e tjera, ky vit nuk ka filluar me kohë, ka filluar me 3 tetor 2022, për shkak të grevës që ishte e organizuar nga sindikalistët. Kam cekur faktin që, edhe pse është kërkuar nga Ministria e Arsimit për zëvendësimin e orëve të humbura (të zëvendësoheshin të shtuneve), kjo gjë nuk ka ndodhur. Në mënyrë kronologjike, kam paraqitur të gjitha aktivitetet që kanë ndodhur prej 3 tetorit deri më 27 janar. Është lidhur kontrata për objektin e ri të Shkollës Fillore të Mesme të Ulët "Hamëz Thaqi" Xërxë, është lidhur kontrata për projektin e ndërtimit të

aneksit të objektit të shkollës “Katër Dëshmorët” – Ratkoc. Në bashkëpunim me Drejtorinë e Shëndetësisë dhe Përkujdesjes Sociale, janë zhvilluar vizita sistematike shëndetësore te nxënësit e klasave të para dhe të pesta. Ka përfunduar fusha sportive në oborrin e shkollës “12 Maji” – Ratkoc. Ka përfunduar furnizimi me inventarë për objektin e ri të shkollës në Reti. Me 19 nëntor është mbajtur gara komunale e olimpiadës në matematikë. Në dhjetor rregulluam këndin e lodrave në oborrin e çerdhes për fëmijë “Tulipanët” në qytet. Është bërë përrurimi i objektit të ri të çerdhes në Xërxë. Janë kryer punimet e renovimit të brendshëm të shkollës “Bekim Sylka” për të cilën bëri pyetje edhe asambleistja Bjondina Kleqka.

Lirigzon Kastrati: Të nderuar anëtarë të ekzekutivit, kolegë të Kuvendit Komunal. Sa i përket informatës së DKA-së, pajtohem që këto informacione janë të nevojshme për Asamblenë Komunale për diskutim. Konsideroj që asamblesë duhet t’i ofrohen më shumë çështjet që lidhen me cilësinë e arsimit në komunën tonë. Për këtë çështje i kam disa pyetje: Sa ka qenë pjesëmarrja e rregullt e nxënësve në procesin mësimor? Sa inspektime janë bërë nga niveli komunal i DKA-së në mbarëvajtjen e procesit mësimor? Nëse DKA-ja i ka këto të dhëna dhe nuk janë të kënaqshme, atëherë na tregoni se çfarë masa janë marrë nga DKA-ja për ta përmirësuar cilësinë e arsimit në nivel komunal. Sa ka qenë suksesi i nxënësve i shprehur në % në këtë gjysmë-vjetor? ... Pyetjet e parashtruara mendoj që duhet të jenë pjesë e kësaj informate të DKA-së.

Avni Morina: Faleminderit Lirigzon! Mendoj që po të zgjerohesha më shumë do ta merrte karakterin e raportit. Përndryshe ne si DKA, vazhdimisht e përcjellim procesin mësimor dhe mbarëvajtjen e tij, mungesat e mësimdhënësve dhe të nxënësve, për këta të fundit, çdo fund të gjysmë-vjetorit, drejtorisë i vije raporti i shkollës. Kemi mungesë të inspektimeve profesionale nga inspektorët e arsimit, sepse kemi mungesë të kuadrit të inspektorëve në nivel regjional. Sikur t’i përfshija në këtë informatë statistikën dhe suksesin e nxënësve, informata do të shndërrohej në raport, për çdo interes tjetër, në DKA, i kemi të gjitha shënimet.

Lirigzon Kastrati: Faleminderit drejtor! Meqenëse i keni këto informacione, kërkoj që, nëse e sheh të arsyeshme, të na dërgosh në e-mail.

21. Shqyrtimi dhe miratimi i propozimvendimit për ndërtimin e fushës sintetike për klubet e futbollit në Komunën e Rahovecit;

Afrim Dina: Faleminderit kryesues! Të nderuar anëtarë të kuvendit, jemi komuna e vetme e cila nuk ka një fushë sintetike, që federata e futbollit në bashkëpunim me komunat, i ndërton ato. Kemi pasur kërkesa nga KF. Anadrini, KF. Xërxa dhe në fund KF. Rahoveci, të cilët kanë kërkuar gjetjen e një parcele dhe rregullimin e një fushe sintetike. Nga Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër, kemi marrë informacione se prona komunale kemi në Krushë, Celinë, Fortesë, Xërxë, Dejnë, Kramovik. Ne si komunë, konsiderojmë që parcela më e përshtatshme është në Xërxë (2 ha e 89 ari total), kërkojmë që të ndahen 1 ha e 40 ari për këtë fushë sintetike.

Kryesuesi: Faleminderit drejtor! A ka dikush ndonjë pyetje?... Nëse jo, atëherë po e vendosim në votim, kush është “për”?... Me shumicë unanime aprovohet edhe pika e fundit për këtë mbledhje. Faleminderit për vëmendjen tuaj, mirëmbetshi!

Procesmbajtësi:

Albion Krasniqi

K R Y E S U E S I:

Defrim Kafexhiu



Republika e Kosovës /Republika Kosovo / Republic of Kosovo



Kuvendi Komunal Rahovec /Skupstina Opstina Orahovac /Municipal Assembly Rahovec

DRAFT

RREGULLORJA PËR MENAXHIMIN E MBETURINAVE NË TERITORIN E KOMUNËS SË RAHOVECIT

Mars 2023

Në mbështetje të nenit 11, 12.2 (c), dhe nenit 17 (f), nenit 40 paragrafi 2 pika (a) dhe (g) të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare, nr. 28 4 qershor 2008), nenit 15.paragrafit 7, nenit 34 paragrafi 2 dhe paragrafi 7 dhe nenit 80 të Ligjit nr. 04/L-060 për mbeturina (Gazeta Zyrtare, nr.17, 29 qershor 2012) i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 08/L-071 (Gazeta Zyrtare, nr. 29, 1 shtator 2022), si dhe nenit 92 të Statutit të Komunës së Rahovecit të datës 29.03.2017, Kuvendi i Komunës së Rahovecit në mbledhjen e mbajtur më 00.03.2023, miraton këtë:

RREGULLORE PËR MENAXHIMIN E MBETURINAVE NË TERRITORIN E KOMUNËN E RAHOVECIT

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi

Me këtë rregullore përcaktohen rregullat dhe procedurat për organizimin dhe funksionimin e sistemit dhe standardet e shërbimit për menaxhimin e mbeturinave: mbeturinat nga ndërtimi dhe rrënimi si dhe mbeturinat nga aktivitetet tjera, të natyrës së ngjashme me ato të amvisërisë, lartësinë e tarifës së taksës për menaxhimin e mbeturinave nga amvisëritë me qëllim që të krijohet një sistem i qëndrueshëm, për administrimin financiar, ruajtjes së natyrës, ambientit jetësor dhe interesat tjera të përgjithshëm si dhe hartimin e Planit komunal për menaxhimin e mbeturinave, krijimin e kushteve për zbatimin e tij si dhe detyrat dhe përgjegjësitë e organit kompetent komunal për kryerjen e shërbimeve për menaxhimin e mbeturinave në territorin e Komunës së Rahovecit në mënyrë që të mbrohet shëndeti publik dhe të zvogëlohet ndikimi i mbeturinave në mjedis.

Neni 2

Fushëveprimi

1.Kjo Rregullore zbatohet:

- 1.1. Në territorin e Komunës së Rahovecit , për aktivitetet e menaxhimit të mbeturinave, dhe
- 1.2. Ndaj të gjithë personave fizik dhe juridik, prodhuesve dhe zotëruesve të mbeturinave dhe operatorëve që merren me menaxhimin e mbeturinave në/dhe për territorin e Komunës së Rahovecit.

- 2.Dispozitat e kësaj rregulloreje përcaktojnë veprimet e orjentuara në minimizimin e mbeturinave, ndarjen, ruajtjen, shkarkimin, grumbullimin, transportimin, aktivitetet e riciklimit dhe tarifë për mbeturina me qëllim të ruajtjes së mjedisit jetësor të shëndetshëm që është nën juridiksionin e Komunës së Rahovecit.
- 3.Dispozitat e kësaj rregulloreje nuk zbatohen për kategoritë e mbeturinave të përjashtuara sipas Ligjit për mbeturina dhe ligjeve dhe akteve të veçanta.

Neni 3

Përkufizimet

1. Shprehjet e përdorura në këtë Rregullore kanë këtë kuptim:

- 1.1. **Administrata komunale** - të gjithë personat e punësuar nga autoriteti komunal siç përkufizohet në Ligjin nr. 03/L-040 për vetëqeverisjen lokale (Gazeta Zyrtare, nr. 28, 04 qershor 2008);
- 1.2. **Deponi** - vendi i caktuar dhe rregulluar për mbeturina, ku do të vendosen mbeturinat nën apo mbi sipërfaqe të tokës;
- 1.3. **Gazeta Zyrtare** – Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës;
- 1.4. **Impiant** - objekti me pajisje të dedikuara për kryerjen e procesit të caktuar;
- 1.5. **Komunë** - Komuna e Rahovecit, njësi e vetëqeverisjes lokale, në territorin dhe me kufijtë administrativë të përcaktuar sipas Ligjit nr.03/L-041 për kufijtë administrativ të komunave (Gazeta Zyrtare, nr. 26, 2 qershor 2008);
- 1.6. **Konsumator** - personi i cili ka lidhur kontratë për shërbime me ofruesin e shërbimeve ose merr shërbime të caktuara sipas Ligjit për mbeturina dhe kësaj rregulloreje;
- 1.7. **Kompostim** - është procesi i dekompozimit të kontrolluar të mbeturinave organike me qëllim të prodhimit të kompostit;
- 1.8. **Kryetar** - Kryetari i Komunës së Rahovecit ;
- 1.9. **Kuvend** - Kuvendi i Komunës së Rahovecit ;
- 1.10. **Ligj/Ligji për mbeturina** - Ligji nr. 04/L-060 për mbeturina (Gazeta Zyrtare, nr.17, 29 qershor 2012) i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 08/L-071 (Gazeta Zyrtare, nr. 29, 1 shtator 2022);
- 1.11. **Ligji për Vetëqeverisjen Lokale** - Ligji nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare, nr. 28, 4 qershor 2008);
- 1.12. **Ligji për bashkëpunim ndërkomunal** - Ligji nr. 04/L-010 për bashkëpunim ndërkomunal (Gazeta Zyrtare, nr. 7, 10 gusht 2011);
- 1.13. **Leje përkatëse mjedisore** - nënkupton Leje mjedisore ose Leje mjedisore të integruar ose Leje mjedisore komunale, të përkufizuara sipas ligjit përkatës për mbrojtjen e mjedisit dhe Ligjit përkatës për Parandalimin dhe Kontrollin e Integruar të Ndotjes;
- 1.14. **Magazinim** - ruajtja e sigurt dhe e përkohshme e mbeturinave në objektet e parapara për këtë qëllim.
- 1.15. **Mbeturina** - substancë apo objekt që prodhuesi apo zotëruesi e hedh, ka për qëllim ta hedh apo është i detyruar t'a hedh;
- 1.16. **Menaxhimi i mbeturinave** - nënkupton aktivitetet përfshirë mbledhjen, grumbullimin, transportin, përpunimin-rikuperimin, klasifikimin, deponimin e mbeturinave, mbikëqyrjen e operacioneve të tilla dhe kujdesin, mirëmbajtjen e mëvonshme të vendeve të depozitimit, si dhe veprimet e ndërmarra nga një tregtar ose ndërmjetësues;
- 1.17. **Mbeturina të rrezikshme** - nënkupton mbeturina që paraqesin një apo më shumë veti të rrezikshme të listuara në Shtojcën I të Ligjit për mbeturina;

- 1.18. **Mbeturina e parrezikshme** - mbeturinat që nuk paraqesin rrezik për mjedisin dhe shëndetin e njeriut dhe që nuk posedojnë karakteristika të mbeturinave të rrezikshme;
- 1.19. **Mbeturina të veçanta** - mbeturinat të cilat për nga natyra e krijimit dhe trajtimit konsiderohen të veçanta sipas nenit 38.4. të Ligjit për mbeturina;
- 1.20. **Mbeturina inerte** - mbeturinat të cilat nuk pësojnë ndonjë ndryshim të rëndësishëm fizik, kimik dhe biologjik në vendet ku janë deponuar si:
- 1.20.1. mbeturina inerte që nuk treten, nuk ndizen ose nuk reagojnë fizikisht apo kimikisht, nuk zbërthehen biologjikisht në kontakt me materiet tjera dhe nuk ndikojnë në mënyrë të ndjeshme në mjedisin dhe shëndetin e njeriut;
 - 1.20.2. i tërë kullimi dhe përmbajtja ndotëse e mbeturinës, mbetjet ekotoksike duhet të jenë të vlerës së papërfillshme dhe të mos rrezikojnë cilësinë e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore;
- 1.21. **Mbeturinat komunale** - nënkupton:
- 1.21.1. mbeturinat e përziera dhe mbeturinat shtëpiake të grumbulluara veç e veç, duke përfshirë letrën dhe kartuçin, qelqin, metalet, plastikën, mbetjet bio, drunjtë, tekstilet, paketimin, pajisjet e mbeturinave elektrike dhe elektronike, bateritë dhe akumulatorët e mbeturinave, mbeturinat vëllimore, përfshirë dyshekët dhe mobiliat;
 - 1.21.2. mbeturinat e përziera dhe mbeturinat e grumbulluara veçmas nga burimet e tjera, kur mbeturinat e tilla janë të ngjashme në natyrë dhe përbërje me mbeturinat shtëpiake;
 - 1.21.3. mbeturinat komunale nuk përfshijnë mbeturinat nga prodhimi, bujqësia, pylltaria, peshkimi, tankerët septike dhe rrjetet e kanalizimeve, si dhe nga trajtimi i ujërave të zeza, duke përfshirë llumrat e ujërave të zeza, mbeturinat e automjeteve ose mbeturinat e ndërtimit.
- 1.22. **Mbeturina komerciale** - nënkupton mbeturinat të cilat vijnë nga objektet që përdoren për qëllimet e tregut ose biznesit, sportit, edukimit, rekreacionit, por nuk përfshihen mbeturinat industriale dhe që nënkuptohet çdo mbeturinë e prodhuar nga një biznes duke përfshirë por jo kufizuar, në letër, karton, kanaçe, paketim me pakicë dhe mbështjellës ushqimi;
- 1.23. **Mbeturina ushqimore** - nënkupton mbeturinat e çdo substance apo produkti, qofte i përpunuar, i përpunuar pjesërisht ose i papërpunuar, e që pritet të konsumohet nga njerëzit, pijet, çamçakëzët dhe çdo substance, përfshirë edhe ujin, të përfshirë qëllimisht në ushqim gjatë prodhimit, përgatitjes ose trajtimit të tij.
- 1.24. **Mbeturinat nga ndërtimi dhe rrënimi** - nënkupton mbeturinat e krijuara nga aktivitetet e ndërtimit dhe prishjes;
- 1.25. **Mbeturina të vëllimshme** - nënkupton mbeturinat me përmasa të mëdha fizike nga pajisjet dhe makineritë, mobiliat, dhe mbeturina tjera të vëllimshme, përmasat e të cilave e pengojnë përdorimin e zakonshëm të grumbullimit, transportimit dhe largimit dhe kërkohet që kjo të bëhet në mënyrë të veçantë;
- 1.26. **Mbledhja** - mbledhje dhe transportim i mbeturinave duke përfshirë klasifikimin paraprak në lloje dhe magazinimin e mbeturinave për qëllime të bartjes deri në objekti për trajtim ose deponim të mbeturinave;

- 1.27. **Mbledhja e ndarë** - nënkupton mbledhjen, kur grumbullimi i mbeturinave bëhet në mënyrë të ndarë në lloje, të klasifikuar sipas natyrës dhe pajisjeve për të lehtësuar trajtimin specifik;
 - 1.28. **Ministria** - Ministria përkatëse për mjedisin;
 - 1.29. **Operatori** - nënkupton personin e pajisur me leje përkatëse mjedisore i cili në përputhje me dispozitat e Ligjit për mbeturina, Ligjit për prokurimin publik dhe legjislacionin përkatës në fuqi është përzgjedhur nga organi kontraktues i Komunës për ofrimin e shërbimeve publike për menaxhimin e mbeturinave, brenda territorit të Komunës së Rahovecit ;
 - 1.30. **Organe komunale** - nënkupton Kuvendin dhe Kryetarin e Komunës së Rahovecit;
 - 1.31. **Person** - person fizik ose juridik i cili është i involvuar në mënyrë të drejtpërdrejt ose tërthorazi, në proceset për menaxhimin e mbeturinave;
 - 1.32. **Prodhuksi i mbeturinës** - çdo person, veprimtaria e të cilit krijon/prodhon mbeturinë ose çdonjëri që merret me para-procesim, përzierje apo operime tjera që rezultojnë në ndryshimin e natyrës apo përbërjen e mbeturinës;
 - 1.33. **PKMM** - Plan komunal për menaxhimin e mbeturinave;
 - 1.34. **Qeveria** - Qeveria e Republikës së Kosovës;
 - 1.35. **Riciklimi** - çdo operim të përpunimit nga i cili materialet mbeturinë janë rikthyer në produkte, materiale. substanca qoftë si origjinale apo për qëllime tjera. Kjo përfshinë rikthimin e materialeve organike por nuk përfshinë përfitimin e energjisë dhe ripërpunimin në materiale që përdoren si karburante apo për operimet e mbulimit të mbeturinave;
 - 1.36. **Statut** - Statuti i Komunës së Rahovecit me Nr.1005 i datës 29.03.2017 ;
 - 1.37. **SMM - Sektori për Menaxhimin e Mbeturinave**, që vepron në kuadër të **Drejtorisë për Shërbime Publike** i cili zbaton politikat në fushën e mbrojtjes përcaktuar nga ministritë përkatëse dhe legjislacioni përkatës në fuqi për krijimin e një sistemi të qëndrueshëm për menaxhimin e mbeturinave komunale;
 - 1.38. **Trajtimi i mbeturinave** - nënkupton të gjitha operacionet e përpunimit ose magazinimit, deponimit, përfshirë përgatitjet para përpunimit ose magazinimit, deponimit të mbeturinave;
 - 1.39. **Zotëruesi i mbeturinës** - prodhuesi i mbeturinës apo personi që e posedon mbeturinën;
2. Termat tjerë të përdorura në këtë rregullore kanë kuptimin e njëjtë me përkufizimet e dhëna në Ligjin për mbeturina. Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale dhe Statutin e Komunës së Rahovecit.

II - SISTEMI PËR MENAXHIMIN E MBETURINAVE

Neni 4

Parimet për menaxhimin e mbeturinave

1. Mbeturinat në Komunën e Rahovecit, mbledhen, grumbullohen, trajtohen dhe menaxhohen në përputhje me dispozitat e Ligjit për mbeturina, me këtë Rregullore, Planin Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave (PKMM) si dhe dispozitat e legjislacionit në fuqi.
2. Menaxhimi i mbeturinave në territorin e Komunës së Rahovecit bëhet duke u bazuar në respektimin e parimeve dhe sipas kuptimeve të përcaktuara në Nenin 5 të Ligjit Nr.04/L -060 për mbeturina, si në vijim:

- 2.1. Parimi i afërsisë dhe vetë trajtimit;
- 2.2. Parimi i vigjilencës dhe parandalimit;
- 2.3. Parimi ku ndotësi paguan;
- 2.4. Parimi për menaxhimin e mbeturinave i sistemuar sipas prioriteteve;
- 2.5. Parimi i përgjegjësisë së prodhuesit dhe zotëruesit;
- 2.6. Parimi i sigurimit financiar;
- 2.7. Parimi për qasje të publikut në informata;
- 2.8. Parimi i mbrojtjes së të drejtave në gjykatë.

Neni 5

Organizimi i menaxhimit të mbeturinave

1. Menaxhimi i mbeturinave në Komunën e Rahovecit, duhet të organizohet në atë mënyrë që:

- 1.1. Të mbulohet i tërë territorit të Komunës me shërbimin e grumbullimit të mbeturinave dhe arritjen e shkallës 100% të grumbullimit dhe transportimit;
- 1.2. Të bëhet rritja e cilësisë, efikasitetit dhe qëndrueshmërisë dhe ngritja e kapaciteteve institucionale të menaxhimit të mbeturinave;
- 1.3. Të bëhet rritja e kapaciteteve institucionale për menaxhimin e mbeturinave;
- 1.4. Të bëhet rishikimi i procesit tarifar për të siguruar mekanizëm të qëndrueshëm të financimit;
- 1.5. Të bëhet përmirësim i performancës operative dhe financiare të ofruesve të shërbimit;
- 1.6. Të bëhet parandalimi dhe eliminimi i deponive ilegale të mbeturinave.
- 1.7. Të parandalohet ndotja nga mbeturinat dhe t'i kufizohet ndikimi kur ajo ndodh në mënyrë që të mënjanohet çdo dëm a rrezik për mjedisin dhe për shëndetin, mirëqenien dhe sigurinë e jetës së njeriut;
- 1.8. Të ruhet fauna dhe flora, mjedisi e peizazhi nga degradimi, dhe sidomos të ruhen burimet natyrore nga ndikimet e mbeturinave;
- 1.9. Të sigurohen shërbime të rregullta dhe të besueshme drejt mbledhjes së mbeturinave dhe trajtimit të tyre të ndarë, në të gjitha fazat e administrimit të tyre dhe të mos përzihen me mbeturinat e rrezikshme;
- 1.10. Të përmirësohet qasja në shërbimet e menaxhimit të mbeturinave nga popullata në zonat urbane dhe rurale në përputhje me politikën qeveritare dhe PKMM;
- 1.11. Të zbatojnë shërbimet bazë të menaxhimit të mbeturinave drejt qëndrueshmërisë dhe mbeturinat t'i nënshtrohen sa më shumë reduktimit, riciklimit dhe ripërdorimit;
- 1.12. Të zhvillohet potenciali ekonomik i ekonomisë qarkore, me përfshirjen e grupeve të cenueshme;
- 1.13. Të parandalojnë dhe reduktojnë prodhimin e mbeturinave me qëllim të parandalimit të ndotjes së mjedisit dhe mbrojtjes së shëndetit të njeriut, nga prodhuesit dhe zotëruesit e mbeturinave;
- 1.14. Të rritet ekspertiza specifike sektoriale në komunë dhe trajtimi i mbeturinave tu përmbahet standardeve profesionale dhe të bëhet në pajtim me dispozitat e ligjit për mbeturina, këtë rregullore dhe legjislacionin përkatës në fuqi.

- 1.15. Të përdoren vetëm teknikat dhe metodat më të mira të mundshme të bazuara në kriteret mjedisore për ndarjen, grumbullimin, transportimin, ruajtjen, përpunimin dhe asgjësimin e mbeturinave;
- 1.16. Të realizohet një cikël sa më i shkurtër për administrimin e mbeturinave me qëllim që të zvogëlohet koha e ekspozimit të tyre në mjedis;
- 1.17. Të dëmshpërblehet dhe të rehabilitohet nga personat fizikë dhe juridikë, ndotja dhe dëmtimi që shkaktohet prej tyre nga keqadministrimi i mbeturinave.

Neni 6

Përgjegjësia e Komunës për Menaxhimin e Mbeturinave:

- 6.1. Krijimi i një sistemi të qëndrueshëm mbi menaxhimin e mbeturinave të ngurta komunale.
- 6.2. Krijimi i një sistemi të qëndrueshëm financiar.
- 6.3. Krijimi i procesit të kontraktimit për shërbimet e grumbullimit të mbeturinave.
- 6.4. Autorizimi i operatorit që të bëjë mbledhjen e mbeturinave dhe jashtë orarit dhe dinamikës së paraparë, sipas nevojës
- 6.5 Të themelohet në kuadër të Drejtorisë për Shërbime Publike të Komunës së Rahovecit, **Sektorin e menaxhimit të mbeturinave** i cili monitoron dhe ofron udhëzime për ofruesit e shërbimeve për grumbullimin, transportimin dhe deponimin e mbeturinave, menaxhon me bazën e të dhënave të gjeneruesve të mbeturinave shtëpiake dhe vepron sipas planit komunal për menaxhimin e mbeturinave.
- 6.6 Të bëjë monitorimin mjedisor të deponisë së mbeturinave.
- 6.7 Të identifikoj pikat ilegale (të zeza) të hedhjes së mbeturinave dhe evitimi i tyre.
- 6.8 Promovimi për minimizimin e mbeturinave (3R, kompostimit shtëpiak etj.)
- 6.9 Promovimi i ngritjes së vetëdijesimit publik- pjesëmarrja aktive e qytetarëve në implementimin e menaxhimit të mbeturinave të ngurta.
- 6.10 Planifikimin buxhetor mbi funksionimin e menaxhimit të mbeturinave.
- 6.11 Faturimi i tarifës mbi mbeturinat, organizimi dhe shpërndarja.
- 6.12 Përpilimi i raporteve, mbi menaxhimin e mbeturinave, dhe shkallën e inkasimit të tarifës mbi mbeturinat.
- 6.13 Formimi i komisionit në kuadër të administratës komunale, për shqyrtimin e ankesave dhe parashtrësve të taksapaguesve për mbeturinat.
- 6.14 Propozon përcaktimin e tarifës dhe mënyrën e arkëtimit të mjeteve financiare për menaxhimin e mbeturinave, për miratim në Kuvendin e Komunës.
- 6.15 Dorëzimi i Raportit në Ministrinë e Mjedisit dhe planifikimit Hapësinor, për MMN çdo 31 mars të vitit pasues.
- 6.16 Komuna ka përgjegjësi që të sigurojë kushte veprimi dhe operimi për operatorët publikë dhe privat.
- 6.17 Trajtimi i mbeturinave nga ndërtimi dhe rrënimi, si dhe i mbeturinave inerte, komerciale, të vëllimshme brenda territorit të komunës
- 6.18 Hartimi i planit komunal për menaxhimin e mbeturinave (PKMM);

- 6.19 Të krijoj bazën e të dhënave me shënime për amvisëritë, bizneset dhe institucionet publike dhe private që pranojnë shërbime komunale të grumbullimit të mbeturinave, të cilat shënime (apo regjistra) përmbajnë të dhënat për përdoruesit e shërbimeve, të dhënat personale, adresën si dhe të dhënat e tjera të nevojshme. Këto të dhëna duhet të përditësohen rregullisht nga ana e Komunës, përkatësisht nga **Spektori mbi menaxhimin e mbeturinave në kuadër të Drejtorisë për Shërbimeve Publike**.
- 6.20 Grumbullimin e mbeturinave të vëllimshëm komuna do ta bëjë së paku dy herë në vit, pa pagesë, sipas planit komunal për menaxhimin e mbeturinave

Neni 7

Llojet e mbeturinave që menaxhohen nga Komuna e Rahovecit

- 7.1 Llojet e mbeturinave të cilat i menaxhon Komuna në bazë të kësaj rregulloreje janë si në vijim:
- 7.1.1 Mbeturina komunale janë mbeturina nga amvisëritë, dhe mbeturina nga aktivitetet tjera të cilat për shkak të përbërjes dhe natyrës së tyre, janë të ngjashme me ato të amvisërisë.
 - 7.1.2 Mbeturina inerte që nuk treten, nuk ndizen ose nuk reagojnë fizikisht apo kimikisht, nuk zbërthehen biologjikisht në kontakt me materiet tjera dhe nuk ndikojnë në mënyrë të ndjeshme në mjedisin dhe shëndetin e njeriut;
 - 7.1.3 Mbeturina të vëllimshme - mbeturina me përmasa të mëdha fizike nga pajisjet e amvisërisë dhe mobilet.
 - 7.1.4 Mbeturina nga ndërtimi dhe rrënimi mbeturina të gjeneruara nga aktivitetet ndërtimore;
 - 7.1.5 Bio-mbetrinë janë mbeturinat biodegraduese nga kopshtet, parqet, ushqimet dhe mbeturinat e kuzhinës nga familjet, restorantet, objektet turistike, shitoret me pakicë dhe mbeturinat të ngjashme nga impiantet për përpunimin e ushqimit;
- 7.2 Mbeturina komerciale janë mbeturinat të cilat vijnë nga objektet që përdoren për qëllimet e tregut ose biznesit, sportit, edukimit, rekreacionit, por nuk përfshihen mbeturinat industriale.
- 7.3 Mbeturina industriale janë mbeturinat të cilat krijohen nga aktivitetet, proceset industriale, prodhimtari artizanale dhe veprimtari tjera prodhuese;
- 7.4 Mbeturina medicinale janë mbeturina patologjike të cilat krijohen nga aktiviteti medicinal, si dhe materialet e tjera që përdoren në shërbimet mjekësore;
- 7.5 Mbeturinat shtazore janë mbeturina që krijohen nga amvisëritë, thertoret, mishtoret dhe aktivitetet e tjera të ngjashme.

Neni 8

Mbetrinat që përjaashtohen nga menagjimi i Komunës së Rahovecit

- 8.1 Nga kjo rregullore përjashtohen mbetrinat në vijim:
- 8.1.1. mbetrinat e rrezikshme dhe
 - 8.1.2. Ilumi/ balta dhe mbetrina të ngjashme
- 8.2 Menaxhimi i tyre rregullohet në bazë të akteve nënligjore të miratuar nga organi kompetent

Neni 9

Reduktimi, Ripërdorimi dhe riciklimi i mbeturinave

9.1 Menaxhimi i mbeturinave në Komunën e Rahovecit duhet të organizohet në atë mënyrë që mbeturinat të:

- 9.1.1 **Reduktohen** - prodhuesit dhe zotëruesit e mbeturinave të parandalojnë dhe reduktojnë prodhimin e mbeturinave, me qëllim të parandalimit të ndotjes së mjedisit dhe mbrojtjen e shëndetit të njeriut;
- 9.1.2 **Ripërdoren** - mbeturinat, kur ka mundësi, të ripërdoren apo përpunohen si lëndë e parë sekondare dhe si lëndë për përfitim të energjisë;
- 9.1.3 **Riciklohen** - mbeturinat, kur është e mundur të riciklohen me qëllim që të përdoren si lëndë e parë sekondare.

Neni 10

Trajtimi i barabartë

Komuna dhe Operatori duhet të trajton në mënyrë të barabartë të gjithë konsumatorët, prodhuesit dhe zotëruesit e mbeturinave dhe nuk mund të diskriminojë asnjë person në cilëndo prej bazave të përcaktuara në Ligjin për mbrojtje nga diskriminimi

III - DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË PËR MENAXHIMIN E MBETURINAVE

Neni 11

Sektori për Menaxhimin e Mbeturinave

1. Sektori përkatës për Menaxhimin e Mbeturinave (SMM), vepron në kuadër të **Drejtorisë për shërbime Publike**.¹
2. Sektori përkatës për Menaxhimin e Mbeturinave (SMM), bashkëpunon me Ministrin dhe me palët e interesuara për hartimin e dokumenteve për Planifikimin dhe **menaxhimin e mbeturinave**.

Neni 12

Detyrat dhe përgjegjësitë e Sektorit për menaxhimin e mbeturinave

1. Sektori përkatës për Menaxhimin e Mbeturinave (SMM), ka detyrat dhe përgjegjësitë si në vijim:
 - 1.1. Planifikon, rregullon, udhëheqë dhe të zbaton aktivitete për menaxhimin e mbeturinave brenda territorit të komunës së Rahovecit;
 - 1.2. Harton, siguron dhe raporton zbatimin e Planit Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave (PKMM), në pajtim me këtë rregullore dhe legjislacionin përkatës në fuqi;
-

- 1.3. Udhëzon dhe mbikëqyrë ofruesit e shërbimeve për menaxhimin e mbeturinave komunale;
- 1.4. Planifikon buxhetin për funksionimin e duhur të menaxhimit të mbeturinave;
- 1.5. Propozon tarifën për menaxhimin e mbeturinave dhe mënyrën e arkëtimit të mjeteve financiare;
- 1.6. SMM, ka për obligim krijimin, mirëmbajtjen dhe menaxhimin e databazës së konsumatoreve .
- 1.7. Siguron faturimin e taksës për mbeturina, dhe për organizimin dhe shpërndarjen e faturave;
- 1.8. Siguron kushtet e veprimit dhe operimit për operatorët publikë dhe privatë;
- 1.9. Organizon menaxhimin e mbeturinave nga sipërfaqet publike;
- 1.10. Mbikëqyrë mbledhjen, transportimin deri në deponi të mbeturinave komunale, komerciale, inerte, të vëllimshme, nga ndërtimet dhe rrënimet, ushqimore, si dhe llojeve tjera të mbeturinave të cilat janë në kompetencë të nivelit lokal;
- 1.11. Njofton publikun për menaxhimin e mbeturinave dhe promovon ngritjen e vetëdijesimit publik - pjesëmarrjen aktive të qytetarëve në menaxhimin e mbeturinave, në bashkëpunim me njësitë përkatëse në komunë;
- 1.12. Promovon minimizimin e mbeturinave (ripërdorim, reduktim, riciklim (3R), kompostimin shtëpiak etj.);
- 1.13. Identifikon pikat/deponitë ilegale të hedhjes së mbeturinave dhe siguron evitimin e tyre;
- 1.14. Në bashkëpunim me njësitë tjera komunale siguron kushte veprimi dhe operimi për operatorin;
- 1.15. Harton raportet për menaxhimin e mbeturinave, përfshi raporte vjetore për menaxhimin e mbeturinave raportet për shkallën e arkëtimit të tarifës për mbeturina, sipas kërkesave që dërgohet në Ministri si dhe raporteve tjera të përcaktuar në Ligjin për mbeturina dhe këtë rregullore;
- 1.16. Bënë monitorimin mjedisor të deponis/ve të mbeturinave (*NË RASTET KUR KA NJË TË TILLË NË TERRITORIN E KOMUNËS SË RAHOVECIT*);
- 1.17. Në emër të komunës përgatit dhe dërgon informacionet dhe rekomandimet e kërkuara nga Ministria, lidhur me menaxhimin e mbeturinave.

2. Sektori për Menaxhimin e Mbeturinave (SMM), sipas nevojës dhe në bashkëpunim me dhe përmes operatorit të kontraktuar për menaxhimin e mbeturinave komunale, përcakton:

- 2.1. Vendndodhjen e pikave të grumbullimit të mbeturinave;
- 2.2. Llojin, numrin, mënyrën e shpërndarjes dhe vendosjes së kontejnerëve për;
- 2.3. Lokacionin për vendosjen e kontejnerëve dhe mënyrën e mirëmbajtjes së tyre;
- 2.4. Kushtet për mënyrën e mbledhjes, ndarjes, përpunimit dhe riciklimit të mbeturinave;
- 2.5. Orarin dhe dinamikën për mbledhjen e mbeturinave, dhe sipas nevojë autorizon operatorin që të bëjë mbledhjen e mbeturinave edhe jashtë orarit dhe dinamikës së paraparë;
- 2.6. Mënyrat për transportim të mbeturinave komunale;
- 2.7. Siguron brenda afatit të caktuar, kontejnerë të veçantë për hedhjen e mbeturinave gjatë ndërtim-rrënim, mbeturinave të vëllimshme dhe të caktojë tarifën e këtij shërbimi në bazë të zbrazjes së kontejnerëve.

3.Sektori për Menaxhimin e Mbeturinave (SMM), përkujdeset që të themelohet komisioni i ankesave në kuadër të administratës komunale, i cili do të shqyrton ankesat e konsumatorëve sa u përket shërbimeve të menaxhimit të mbeturinave, tarifave dhe mënyrës së arkëtimit të tyre

Neni 13

Të drejtat e prodhuesit apo zotëruesit të mbeturinave

1.Çdo prodhues apo zotërues i mbeturinave dhe çdo konsumator ka të drejtë:

- 1.1.Qasje në shërbimet publike për hedhjen dhe grumbullimin e mbeturinave;
- 1.2.Të informohet dhe të kërkojë informata për menaxhimin e mbeturinave
- 1.3.Të marrë pjesë dhe të kontribuojë në politikat për menaxhimin e mbeturinave;
- 1.4.Të bëjë ankesë, ndaj shërbimit të ofruar dhe të marrë përgjigje në ankesën e bërë brenda afatit prej 30 dit nga dita e parqitjes së ankesës nga Komisioni i Ankesave.

Neni 14

Komisioni i Ankesave

1. Komisioni i Ankesave emrohet nga Kryetari i Komunës .
2. Mandati i anëtarve të Komisionit të Ankesës është !!! një (1) vjetcar .
3. Komisioni i Ankesave do të përbëhet prej 3 anëtar ; një anëtar nga Komuna, një anëtar nga operatorët dhe një anëtar nga OJQ .
4. Përbërja e Komisionit të Ankesave duhet të bazohet mbi parimin e barazisë gjinore.

IV - DETYRAT DHE PËRGJEGJËSIT PËR MENAXHIMIN E MBETURINAVE

Neni 15

Sektori për menaxhimin e mbeturinave

1. Sektori për Menaxhimin e Mbeturinave (SMM). vepron në kuadër të Drejtorisë për shërbime Publike .¹
2. Sektori për Menaxhimin e Mbeturinave (SMM), bashkëpunon me ministrin dhe me palët e interesuara. për hartimin e dokumenteve për planifikimin dhe menaxhimin e mbeturinave..
3. Sektori për Menaxhimin e Mbeturinave (SMM). bashkëpunon me policinë, prokurorinë, gjykatat, dhe institucionet tjera në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 16

Detyrat dhe përgjegjësitë e prodhuesit apo zotëruesit të mbeturinave

1.Çdo prodhues apo zotërues i mbeturinave ka detyrat dhe përgjegjësitë si në vijim:

- 1.1. Të regjistrohet në listat e shërbimit të konsumatorëve për mbledhjen dhe bartjen e mbeturinave dhe të përditësojnë të dhënat në rastet e ndryshimit të adresës;
- 1.2. Të bashkëpunojnë me autoritetet publike për të siguruar një mjedis të pastër;

- 1.3. Të bëjë përpjekje për minimizimin e mbeturinave (përmes ripërdorim, reduktim, riciklim (3R), kompostimit shtëpiak dhe formave tjera të mundshme);
- 1.4. T'i respektojë rregullat e përcaktuara me legjislacionin përkatës në fuqi dhe PKMM;
- 1.5. Të paguaj për shërbimin e ofruar në bazë të tarifës së miratuar nga Komuna;
- 1.6. T'i hedhin mbeturinat e tyre në vende dhe sipas sistemit të caktuar nga ana e Komunës për mbledhjen e mbeturinave, ndërsa mbeturinat e rrezikshme t'i ndajnë dhe t'i dorëzojnë në vendet e caktuara për to. në pajtim me legjislacionin në fuqi;
- 1.7. Të bëjnë ndarjen e mbeturinave sipas sistemit të caktuar nga komuna, me qëllim të trajtimit dhe riciklimit të tyre si dhe t'i hedhin ose dorëzojnë mbeturinat e një lloji:
 - 1.7.1. Në shporta dhe kontejnerë të përcaktuar për atë lloj;
 - 1.7.2. Në pika ose qendra grumbulluese të përcaktuara për atë lloj; ose
 - 1.7.3. Te operatori;
- 1.8. Ta njoftojnë Sektori për Menaxhimin e Mbeturinave (SMM) kur prodhojnë mbeturina gjatë meremetimit apo rrënimit të objekteve dhe të largojnë këto mbeturina nga hapësirat ose vendet publike, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2. Prodhuesit apo zotëruesit e mbeturinave të veçanta, mbeturinave të rrezikshme dhe mbeturinave medicinale, janë të detyruar të respektojnë legjislacionin në fuqi për trajtimin e këtyre mbeturinave dhe të përdorin sistemin e ndarjes së kontejnerëve dhe të dorëzojnë ato mbeturina në vendet e caktuara për to.

3. Prodhuesit apo zotëruesit e mbeturinave, për objektet dhe pajisjet për menaxhimin e mbeturinave, për të cilat sipas Ligjit për mbeturina, është e nevojshme të merret cilado nga lejet mjedisore, janë të detyruar të nxjerrin Planin për menaxhimin e mbeturinave, në pajtim me Neni 11 të Ligjit për mbeturina. (Neni 18)

V - AKTIVITETET PËR MENAXHIMIN E MBETURINAVE

Neni 17

Grumbullimi i mbeturinave

1. Grumbullimi i mbeturinave bëhet vetëm në kontejnerë dhe në vendet e caktuara për mbledhjen e mbeturinave të cilat caktohen nga Komuna.

2. Ndryshimi i vendndodhjes së vendeve të mbledhjes së mbeturinave dhe vendit të kontejnerëve, pa miratim të Komunës Sektori për Menaxhimin e Mbeturinave (SMM), përbën shkelje dhe ndëshkohet sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 18

Baza e të dhënave dhe regjistrimi i gjeneruesve të mbeturinave komunale

17.1 Komuna e Rahovecit – Drejtoria për Shërbimeve Publike, Sektori për menaxhimin e mbeturinave do të krijoj bazën e të dhënave për të gjithë gjeneruesit e mbeturinave komunale në territorin e kësaj komune, konform Ligji Nr.06/L-082- Ligji për mbrojtjen e të dhënave personale sipas nenit 5 paragrafi 1.5.

17.2 Baza e të dhënave do të regjistroj të dhënat personale të gjeneruesve, përcaktimin e llojit të mbeturinave nga gjeneruesit, kategorizimin e gjeneruesve, shumë e faturimit të tarifës dhe shumën e

inkasimit të tarifës për grumbullimin e mbeturinave, me qëllim të interesit publik për implementimin e planit për menaxhimin efikas të mbeturinave komunale.

17.3 Përgjegjësi e menaxhimit, përditësimit dhe mirëmbajtjes së bazës së të dhënave i takon Komunës së Rahovecit - Drejtoris për Shërbimeve Publike dhe Sektori i menaxhimit të mbeturinave.

17.4 Regjistrimi i gjeneruesve të mbeturinave komunale, bëhet me paraqitjen e këtyre dokumenteve:

- a) dokumentin identifikues (letërnjoftimi, pasaporta)
- b) dokumentet e regjistrimit për personat juridik (çertifikata e biznesit ose akt themelimi etj)
- c) dëshmi- njehsorin e rrymës elektrike;
- d) dëshmi mbi regjistrimin e objektit në tatimin në pronë;
- e) dëshmi e pagesës së faturës për mbeturina në adresën ku ka banuar më parë (në rastet kur gjeneruesi e ndërron adresën e banimit)
- f) dëshmi të çertifikatës familjare (për kategorizim të faturës së tarifës në individë/familje)
- g) në rastet e shitblerjes së objekteve, shitësi dhe blerësi duhet të kenë të paguar borxhin paraprak për mbeturinat në tërësi dhe të paraqesin kontratën e shitblerjes, për të i bërë ndryshimet në data bazë dhe në faturim.

17.5. Gjeneruesit të cilët posedojnë dy apo më shumë fatura të tarifës për mbeturina, për objekte banimi aktive, duhet të lajmërohen para organit komunal, respektivisht SMM për kategorizimin e ngarkesës së faturës.

17.6 Në rastet e dyfishimit të faturave për të njëjtin gjenerues, anulohet/fshihen faturat nga baza e të dhënave për menaxhimin e mbeturinave nëse ofrojnë dëshmi të mjaftueshme.

Neni 19

Kontejnerët për mbeturina

1.Me qëllim të mbajtjes sa më të mirë të pastërtisë në sipërfaqe publike, vendoset numër i mjaftueshëm i kontejnerëve për mbeturina.

2.Llojin, mënyrën, vendin dhe numrin e kontejnerëve dhe të mjeteve tjera në sipërfaqe publike e cakton Sektori për Menaxhimin e Mbeturinave (SMM), në bashkëpunim me operatorin.

3.Numri i kontejnerëve duhet të përshtatet me numrin e banorëve në objektet e përbashkëta të banimit dhe llojin e mbeturinave që krijojnë.

4.Kontejnerët për mbeturina duhet të vendosen në vende të dukshme dhe të përshtatshme.

5.Kontejnerët, nëse paraqitet nevoja, duhet të kenë mbishkrime të dukshme që udhëzojnë për klasifikimin e mbeturinave.

6.Personat juridik dhe fizik të amvisërive që marrin shërbimet derë me derë, sigurojnë kontejnerët sipas llojit dhe mënyrës që caktohet nga Sektori përkatës për Menaxhimin e Mbeturinave (SMM).

7.Prodhuesit apo zotëruesit e mbeturinave të veçanta, duhet të përdorin sistemin e ndarë të kontejnerëve me qëllim të ndarjes së mbeturinave medicinale dhe mbeturinave të tjera, që i nënshtrohen një trajtimi të veçantë, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

8.Ndërmarrja së cilës i besohen punët e mirëmbajtjes së rregullt të parqeve, sheshe dhe në vende tjera, është e obliguar të vendosë dhe të mirëmbajë numër të mjaftueshëm të kontejnerëve (koshave) për mbeturina.

9. Çerdhet, kopshtet dhe shkollat, publike e private, duhet të përdorin sistemin e disa kontejnerëve për të edukuar fëmijët dhe nxënësit me normat e rregullat bashkëkohore të trajtimit të ndarë të mbeturinave.
10. Për mirëmbajtjen dhe pastrimin e kontejnerëve për mbeturina, në sipërfaqe publike, kujdeset operatori.
11. Personat juridik dhe qytetarët janë përgjegjës për mirëmbajtjen dhe pastrimin e kontejnerëve për mbeturina dhe vendeve përreth tyre.

Neni 20

Orari për mbledhjen dhe hedhjen e mbeturinave

1. Komuna bën publike oraret e hedhjes dhe mbledhjes së mbeturinave.
2. Në procesin e vendimmarrjes për caktimin e orarit të hedhjes dhe mbledhjes së mbeturinave, ftohen të marrin pjesë personat juridik dhe fizik, OJQ-të dhe publiku i interesuar.
3. Secili person ka të drejtë të kërkojë të informohet për ecurinë e procesit të hedhjes dhe largimit të mbeturinave.
4. Sistemimi dhe hedhja e mbeturinave, nga prodhuesit apo zotëruesit e mbeturinave bëhet vetëm në kontejnerë ose në vendet e mbledhjes së mbeturinave dhe sipas orarit që ka caktuar Komuna.
5. Kalimtarët, mbeturinat e çastit si ambalazhe të ndryshme, i hedhin vetëm në kontejnerët e vendosur në hapësira publike ose që ndodhen para dyqaneve, **ndalohej hedhja në rrugë, në trotuare apo në ambiente të tjera publike.**
6. Mbeturinat që dalin nga krasitja e pemëve, e hardhive, nga punimet në oborre, në lulishte e parqe, para se të dërgohen në vendet e mbledhjes së këtyre mbeturinave, priten në pjesë të vogla e palosen për të mos bllokuar kazanët dhe vështirësuar transportin.
7. Hedhja e mbeturinave jashtë këtij rregulli, përbën shkelje dhe ndëshkohet sipas legjislacionit në fuqi.
8. Hedhja e mbeturinave të rrezikshme, mbeturinave të veçanta, mbeturinave industriale, mbeturinave inerte, mbeturinave medicinale, mbeturinave nga ndërtimi dhe rrënimi, si dhe mbeturinave të tjera që nuk konsiderohen si mbeturina komunale sipas Ligjit dhe nga kjo rregullore, duhet të bëhet në pikat e veçanta të caktuara nga Komuna për këtë qëllim, dhe në pajtim me legjislacionin përkatës në fuqi.

Neni 21

Transportimi i mbeturinave

1. Transportimi i mbeturinave për në vendet e depozitimit bëhet nga Operatori.
2. Transportuesit e mbeturinave bëjnë transportimin e mbeturinave në bazë të kushteve të përcaktuara me legjislacionin përkatës në fuqi.
3. Bartja e mbeturinave bëhet gjatë ditës dhe gjatë natës, në orët e mbrëmjes apo herët në mëngjes, sipas orarit dhe dinamikës për mbledhjen e mbeturinave të caktuar nga Sektori përkatës për Menaxhimin e Mbeturinave (SMM), i cili bëhet publikë në ueb faqen e komunës.
4. Transportimi i mbeturinave gjatë orëve të ditës - në orët e pikut të aktiviteteve qytetare, është i ndaluar dhe ndëshkohet sipas legjislacionit në fuqi.
5. Gjatë bartjes së mbeturinave mjetet me të cilat ato barten, patjetër duhet të jenë të mbyllura ose të mbuluara, në mënyrë që të pengohet derdhja apo rishpërndarja e mbeturinave gjatë transportit deri në deponinë e caktuar.

6.Nëse ndotja ndodhë gjatë transportimit të mbeturinave, transportuesi është i detyruar që vendin e ndotur ta kthejë në gjendje të mëparshme.

7.Nëse mbeturina e transportuara, nuk pranohet në deponinë e destinuar, transportuesi duhet ta kthejë mbeturinën në vendin ku është marrë dhe të njoftojë Sektorin për Menaxhimin e Mbeturinave (SMM).

Neni 22

Deponitë e mbeturinave

Deponimi i mbeturinave në Komunën e Rahovecit, në varshmëri të karakteristikave të mbeturinave, bëhet vetëm në deponitë e licencuara dhe të lejuara përkatëse si dhe sipas llojit përkatës të mbeturinave, që mund të jenë :

1. Deponi për mbeturinat e rrezikshme;
2. Deponi për mbeturinat jo të rrezikshme;
3. Deponi të mbeturinave inerte, në pajtim me legjislacionin përkatës në fuqi për menaxhimin e deponive.

Neni 23

Mbeturinat Komunale nga ndërtimet dhe rrënimi i objekteve ndërtimore

21.1 Gjatë procesit të ndërtimit, meremetimit apo rrënimit të objekteve, personat fizik dhe juridik duhet të largojnë nga hapësirat ose vendet publike mbeturinat të cilat i krijojnë.

21.2 Mbeturinat nga ndërtimi dhe rrënimi duhet të hidhen në deponin legale e cila përcaktohet me vendim nga Kuvendi Komunal i Rahovecit.

21.3 Transportimi i këtyre mbeturinave, bëhet nga vetë prodhuesit ose ndërmarrjet për në pikat e mbledhjes së mbeturinave ose në vend deponit e caktuara nga organi komunal.

21.4 Të gjithë personat fizik dhe juridik të cilëve ju lëshohet leje për shembjen ose ndërtimin e objekteve, duhet të veprojë sipas Ligjit për mbeturina Nr.04/L-060, të plotësohet formulari shtojca V për bartjen e mbeturinave të ndërtimit dhe rrënimit, nga prodhuesi, transportuesi dhe pranuesi i mbeturinave.

21.5 Secili prodhues i mbeturinave të ndërtimit dhe rrënimit obligohet të veprojë në përkujdesje mjedisore, duke vepruar sipas Ligjit Nr. 04/L-60 për mbeturina, Ligji Nr.08/L-071 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit Nr.04/L-060 për mbeturina, Udhëzimi Administrativ të MMPH Nr.07/2015 për menaxhimin e mbeturinave të ndërtimit dhe rrënimit të objekteve ndërtimore dhe Rregullores për menaxhimin e mbeturinave në Komunën e Rahovecit.

21.6 Të gjithë operatorët publik dhe privat në transportimin e mbeturinave, trajtimin dhe përpunimin, si dhe operatorët në deponi të mbeturinave të ndërtimit dhe rrënimit duhet të jenë të pajisur me leje përkatëse sipas Ligji Nr.08/L-071 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Mbeturina Nr.04/L-060 dhe akteve nënligjor të Ministrisë.

21.7 Dorëzuesit e mbeturinave të ndërtimit dhe rrënimit në deponin legale për këto mbeturina, duhen të paguajë tarifën e përcaktuar nga Komuna e Rahovecit. Kjo pagesë bëhet në deponin tek zyrtarët menaxhues të deponisë.

VI - OPERATORËT PËR MENAXHIMIN E MBETURINAVE

Neni 24

Operatorët për menaxhimin e mbeturinave

1. Menaxhimi i mbeturinave bëhet përmes kontratave të veçanta me një apo më shumë operator publik ose privat për menaxhimin e mbeturinave, të cilët duhet të jenë të pajisur me leje përkatëse mjedisore për menaxhimin e mbeturinave.
2. Operatorët për menaxhimin e mbeturinave mund të jenë institucionet, kompanitë publike ose private të regjistruara sipas ligjit, të cilët shërbimet për komunën për menaxhimin e mbeturinave e kryejnë në bazë të kontratës.
3. Organi kontraktues i Komunës, duke u bazuar në dispozitat e ligjit përkatës të prokurimit, mund të përcaktojë të gjitha kushtet nevojshme për përzgjedhjen e operatorit për menaxhimin e mbeturinave komunale, dhe mbeturinave: inerte, komerciale, të vëllimshme dhe mbeturinat nga ndërtimet dhe rrënimet, brenda territorit të Komunës së Rahovecit.
4. Komuna mund të përzgjedhë për operator një ndërmarrje në pronësi të Komunës sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 25

Menaxhimi i mbeturinave me partneritet publiko-privat

Menaxhimi i mbeturinave, ndërtimi, shfrytëzimi dhe mirëmbajtja e impianteve dhe objekteve për menaxhimin e mbeturinave mund të jepet në formën e partneritetit publiko-privat sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Neni 26

Kontrata me operatorin

1. Kontrata me operatorin duhet të specifikojë, së paku:

- 1.1. Territorin ku kryhen shërbimet;
- 1.2. Mënyrën e ofrimit të shërbimeve;
- 1.3. Specifikimin e pajisjeve për trajtim;
- 1.4. Çështjet tjera që kërkohen sipas Ligjit, këtë rregullore dhe legjislacionit përkatës në fuqi.

2. Operatori i kontraktuar nga organi kontraktues, për ofrimin e shërbimeve për menaxhimin e mbeturinave, është i obliguar që të veprojë sipas Ligjit, kontratës, kësaj rregulloreje dhe legjislacionit përkatës në fuqi dhe përmbush të gjitha detyrat dhe përgjegjësitë e operatorit të përcaktuar në Ligj dhe legjislacionin përkatës në fuqi.

VII - KATEGORIZIMI I KONSUMATORËVE DHE TARIFAT PËR SHËRBIMET E MENAXHIMIT TË MBETURINAVE

Neni 27

Kategorizimi i konsumatorëve dhe caktimi i tarifave për menaxhimin e mbeturinave

1. Konsumatorët, gjegjësisht prodhuesit apo zotëruesit të mbeturinave, kategorizohen si në vijim:

- 1.1. Konsumatorët e amvisërive;
- 1.2. Konsumatorët komercialë dhe industrialë;
- 1.3. Konsumatorët institucionalë.

2. Kuvendi cakton nënkategoritë e konsumatorëve dhe tarifatat për menaxhimin e mbeturinave.

3. Gjatë caktimit të tarifave duhet marrë parasysh shërbimit për secilën kategori, dhe duke marrë parasysh ndikimin e tarifave në mjedisin jetësor dhe rekomandimin e Sektori për Menaxhimin e Mbeturinave (SMM) dhe operatorëve.

4. Sektori për Menaxhimin e Mbeturinave (SMM) në bashkëpunim me operatorin krijojnë, mirëmbajnë dhe përditësojnë listën e konsumatorëve, duke përfshirë edhe kategorizimin dhe nënkategorizimin e tyre.

Neni 28

Faturimi i mbeturinave

1. Faturimi mbeturinave, mbeturinave të ndërtimit dhe rrënimit bëhet në bazë mujore kurse fatura i dorëzohet konsumatorit, më së largu deri më datën 10 të muajit pasues. Konsumatori obligohet që të paguajë faturën e mbeturinave për çdo muaj të vitit.²

2. Në përcaktimin e tarifës për grumbullimin dhe transportimin e mbeturinave të amvisërisë duhet të merren parasysh këto elemente ndikuese:

12.2.1 Shpenzimet operative të grumbullimit të mbeturinave (transporti, mirëmbajtja e mjeteve transportuese, burimet njerëzore etj)

12.2.2 Tarifa e pranimit nga deponia e mbeturinave.

12.2.3 Elementet tjera të ndikueshme nga aspekti ekonomik dhe ndikuesit tjerë për menaxhimin sa me efikas të mbeturinave

3. Konsumatori obligohet të paguaj faturën e mbeturinave, në katër këste brenda vitit, si më poshtë:

3.1. Kësti i parë janar – mars;

3.2. Kësti i dytë prill – qershor;

3.3. Kësti i tretë korrik- shtator;

3.4. Kësti i katërt tetor – dhjetor.

4. Konsumatorët paguajnë tarifatat për menaxhimin e mbeturinave dhe sipas shumës së përcaktuar nga Kuvendi i Komuës së Rahovecit.

5.Konsumatori mundë të kryej pagesën – tarifën për menaxhimin e mbeturinave pranë organeve financiare – bankare dhe në xhirollogarin bankare të Komunës së Rahovecit.

6.Sektori për Menaxhimin e Mbeturinave (SMM) e rishikon lartësinë e tarifave të paktën çdo tri vjet, duke llogaritur koston e shërbimeve dhe i rekomandon Kuvendit ndryshimet që i shoh të nevojshme.

7.Konsumatorët mund të parapagujnë tarifën për gjashtë muaj ose një vit. Nëse konsumatorët pagujnë në këtë mënyrë tarifën kanë zbritjet si në vijim:

7.1. 5% për qind për konsumatorët që parapagujnë tarifën për gjashtë muaj; dhe

7.2. 10% për qind për konsumatorët që parapagujnë tarifën për një vit.

Neni 29

Përcaktimi i tarifës për mbeturinat e ndërtimit dhe rrënimit

1. Në përcaktimin e tarifës për pranimin e mbeturinave të ndërtimit dhe rrënimit nga objektet ndërtimore, duhet të merren parasysh këto elemente ndikuese:

1.1. Shpenzimet dhe mirëmbajtja e ekskavatorit, mirëmbajtja e automjeteve tjera

1.2. Mbulesa me zhavorr, zbrazja e lagunës dhe largimi i borës

1.3. Shpenzimet mirëmbajtjes së zyrës së deponisë (ndriçimi, uji, ngrohja) dhe ato administrative

1.4. Shpenzimet e pagave mujore të punëtorëve të deponisë.

1.5. Elemente tjera të nevojshme për menaxhimin e duhur të mbeturinave të ndërtimit dhe rrënimit.

2.Kalkulimi dhe përcaktimi i shumës në valutën € (euro) për tarifën e mbeturinave të ndërtimit dhe rrënimit, përcaktohet me vendim të veçantë nga Kuvendi Komunal të Rahovecit.

VIII - INFORMIMI, PROMOVIMI DHE RAPORTI PËR MENAXHIMIN E MBETURINAVE

Neni 30

Seanca/t vjetore për çështjet e menaxhimit të mbeturinave

1.Kuvendi organizon të paktën një (1) seancë vjetore, apo se paku në një seancë e diskuton në rend të ditës çështjet e menaxhimit të mbeturinave.

2.Në seancën/at vjetore ku diskutohet për menaxhimin e mbeturinave, secili drejtor i drejtorisë komunale raporton për çështjet, veprimet dhe masat që janë në përgjegjësinë e tij dhe që kanë të bëjnë dhe që ndërlidhen me menaxhimin e mbeturinave, si dhe paraqesin aktivitetet që janë ndërmarrë për realizimin e Planit Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave (PKMM).

3.Në seancën/at vjetore për menaxhimin e mbeturinave, ku diskutohet për menaxhimin e mbeturinave, marrin pjesë edhe përfaqësues të shoqërisë civile.

4.Seanca/at vjetore për menaxhimin e mbeturinave organizohen në koordinim me Sektorin për Menaxhimin e Mbeturinave (SMM) .

Neni 31

Tarifa mbi mbeturinat komunale të amvisërisë

1 Fatura e tarifës komunale për mbeturinat komunale i lëshohet çdo kryefamiljari, individ dhe personave juridik

2 Tarifa komunale e mbeturinave shtëpiake ndahet në tre kategori, në:

- 2.1 tarifa e mbeturinave shtëpiake për banorët rezidentë/komunal/individë: 1 muaj
- 2.2 tarifa e mbeturinave shtëpiake për banorët rezidentë/komunal/familje: 1 muaj
- 2.3 tarifa e mbeturinave shtëpiake për banorët jorezident/diaspora/familje & individë:

X /familje & individë /muaj, llogaritja e takes bëhet si më poshtë:

Tv= tarifa vjetore

M= numri i muajve të vitit me mbi 15 € shpenzime elektrike (maksimum 6 muaj),

T= tarifa mujore (€),

12=muajt në vitin kalendarik,

t = tarifa mujore me më pak se 15 € shpenzime elektrike (€) =1€

Shembull: M =3, Tv =6.00, t =1€, atëherë $Tv = 3 \times 6.00€ + (12-3) \times 1€ = 18 + 9 = 27.00 €$

a) Nëse çmimi i energjisë elektrike do të ndryshojë, do të ndryshoj edhe shuma maksimale (15€) sipas përqindjes së ndryshimit.

3 Tarifa për mbeturinat komunale për konsumatorët komercial, industrial dhe institucionale kategorizohet dhe përcaktohet në shtojcën A të kësaj rregullore.

4 Banorët rezidentë janë individë apo familje të cilët jetojnë në vazhdimësi më shumë se 9 muaj në vit, në territorin e komunës ndërsa banorët jo rezidentë/diaspora janë individë apo familje që banimi i tyre zgjatë 3 ose më pak muaj në territorin e komunës.

5 Individët dhe kryefamiljarët të cilët dëshirojnë të faturohen në kategorinë e taksës komunale të mbeturinave shtëpiake si jorezident/diaspora duhet të paraqesin dëshmi se ata qëndrojnë jashtë shtetit për 9 ose më shumë muaj. Ky vërtetim bëhet përmes paraqitjes për inspektim nga zyrtari komunal në Qendrën e Shërbimit të Qytetarëve, paraqitjen e pasqyrës së transaksioneve vjetore të energjisë elektrike nga viti i kaluar, ku secila tregon një sasi mujore të konsumit energjisë elektrike të barabartë ose nën XX kwh për muaj.

Neni 32

Ngritja e vetëdijes për rëndësinë dhe dobritë e menaxhimit dhe riciklimit të mbeturinave.

1. Zyra përkatëse për informim në Komunën e Rahovecit, në bashkëveprim me Sektorin për Menaxhimin e Mbeturinave (SMM), shoqërinë civile dhe konsumatorët promovojnë konceptin e **3R (reduktim, ripërdorim, riciklim)** për të synuar që gradualisht në Komunën e Rahovecit të fillojë të ndarja e mbeturinave (nga ekonomi familjare, tek shkollat dhe institucionet, dhe biznese), të ngritë vetëdijen e qytetarëve dhe bizneseve rreth përfitimeve për ndarje të mbeturinave dhe të krijojë infrastrukturë për zhvillim ekonomik lokal, pra të krijojë mundësi qytetarëve që të krijojnë biznese financiarisht të qëndrueshme në sektorin e menaxhimit të mbeturinave.

2. Masat për parandalimin dhe reduktimin e gjenerimit të mbeturinave duhet të përfshijnë instrumente ekonomike dhe politike të drejtuara për t'i ndryshuar shprehitë e konsumatorëve për gjenerim të mbeturinave.

IX - BASHKËPUNIMI PËR MENAXHIMIN E MBETURINAVE

Neni 33

Bashkëpunimi për menaxhimin e mbeturinave

Të gjitha njësitë përbërëse të komunës dhe administrata komunale, në kuadër të detyrave dhe përgjegjësi të tyre, janë të obliguara të bashkëpunojnë dhe koordinojnë punën ndërmjet tyre për identifikimin e çështjeve të zbatimit të masave dhe gjetjes së mënyrave me efektive për menaxhimin e mbeturinave si dhe për zbatimin e Ligjit, kësaj rregulloreje, legjislacionit në fuqi dhe Planit Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave (PKMM-së).

Neni 34

Bashkëpunimi ndër-komunal

Për ushtrimin më efikas dhe më efektiv të menaxhimit të mbeturinave, Komuna e Rahovecit, kur është interesin publik të tyre, mund të bëjnë marrëveshje për menaxhimin e mbeturinave me një apo më shumë komuna të Republikës së Kosovës në pajtim me format, kushtet dhe procedurat e përcaktuara me Ligjin për bashkëpunim ndërkomunal, dispozitat e të cilit ligj vlejnë edhe për të gjitha format e bashkëpunimit ndërkomunal për menaxhimin e mbeturinave.

Neni 35

Bashkëpunimi me konsumatorët dhe organizatat e shoqërisë civile

1. Organet dhe administrata komunale:

- 1.1. Bashkëpunojnë me konsumatorët dhe organizatat e shoqërisë civile për realizimin e politikave të menaxhimit të mbeturinave, në pajtim me këtë rregullore dhe legjislacionin përkatës në fuqi;
- 1.2. Sigurojnë, inkurajojnë dhe mbështesin pjesëmarrjen e konsumatorëve dhe organizatave të shoqërisë civile në çështjet e menaxhimit të mbeturinave dhe në aktivitetet planifikuese dhe

zbatuese si dhe u ofrojnë këshilla dhe udhëzime organizatave që kërkojnë të ndërmarrin aktivitete të tilla;

- 1.3. Mbajnë komunikime të rregullta me konsumatorët dhe organizatat e shoqërisë civile në mënyrë që të sigurohet një situatë e qartë e menaxhimit të mbeturinave në komunë nga një perspektivë tjetër.

X - MBIKËQYRJA INSPEKTIVE DHE KUNDËRVAJTJET

Neni 36

Mbikëqyrja inspektive

1. Komuna ushtron mbikëqyrjen dhe kontrollin e masave dhe veprimeve gjatë menaxhimit të mbeturinave në territorin e vet, përmes inspektorit komunal për mjedis, në kuadër të përgjegjësisë sipas dispozitave të nenit 62 deri në nenin 69 të Ligjit për mbeturina nr. 04/L-060 dhe dispozitave tjera të legjislacionit përkatës në fuqi.

2. Inspektori komunal për mjedis mbikëqyrë inspekton menaxhimin e mbeturinave në objektet, pajisjet dhe hapësirat që gjenden në territorin e komunës, duke ndërmarr masat për mbrojtjen e mjedisit të përcaktuara sipas dispozitave të Ligjit dhe legjislacionit përkatës në fuqi.

3. Inspektori komunal për mjedis, në kuadër të përgjegjësisë është i autorizuar të marrë masa preventive për mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit të njeriut si dhe të shqiptojë gjobë për kundërvajtjet e përcaktuara me Ligj dhe legjislacionin përkatës në fuqi.

4. Punët e inspektorit për mbikëqyrjen inspektive të veprimtarive për menaxhimin e mbeturinave mund t'i kryej edhe zyrtari me kualifikim adekuat të cilin e autorizon komuna në kuadër të përgjegjësisë të veta.

5. Në rastet kur Komuna nuk ka inspektor komunal për mjedis, punët, detyrat dhe përgjegjësitë e tij, i kryen zyrtari komunal sipas paragrafit 3 të këtij neni, i cili kryen të gjitha detyrat dhe përgjegjësitë e inspektorit komunal për mjedis.

Neni 37

Veprimet e ndaluara

35.1 Në bazë të kësaj rregulloreje ndalohen veprimet si më poshtë;

35.1.1 Hedhja e mbeturinave ndërtimore në rrugë, trotuare, sheshe apo mjedise publike;

35.1.2 Hedhja e mbeturinave të llojeve të tjera në kontejnerë ose në pikat mbledhëse të mbeturinave, të cilat nuk ndahen ashtu siç është parapare;

35.1.3 Hedhja e mbeturinave në hapësirat përbashkëta, brenda dhe jashtë objekteve të banimit kolektiv (ballkone, korridore, tarraca të banesave etj);

35.1.4 Përzierja dhe hedhja e mbeturinave jashtë kontejnerëve të destinuar për ndarjen e mbeturinave të ricikluara;

35.1.5 Hedhja e mbeturinave në rrugë nga automjetet në lëvizje;

35.1.6 Hedhja dhe deponimi i mbeturinave në hapësirat publike (në rrugë, parqe dhe në vende të tjera publike);

35.1.7 Ndërrimi i vendndodhjes së kontejnerëve, pikave ose vendeve të betonuara për hedhjen e mbeturinave pa autorizim të autoriteteve komunale;

- 35.1.8 Djegia e mbeturinave në vende publike, kontejnerë, apo në pikat mbledhëse ose ndarëse të mbeturinave;
- 35.1.9 Shfrytëzimi i mbeturinave si ushqim për kafshë apo të ngjashme, nga kontejnerët ose pikat mbledhëse të mbeturinave;
- 35.1.10 Shfrytëzimi i kontejnerëve publik nga bizneset, veprimtaritë ekonomike për llojet e mbeturinave që nuk përfshihen në përkufizimin "mbeturina komunale dhe komerciale";
- 35.1.11 Gërmimi, përzieja, derdhja dhe përhapja e mbeturinave të hedhura në kontejnerë, ose në pikat mbledhëse nga personat e pa autorizuar.
- 35.1.12 Hedhja e mbeturinave jashtë kontejnerëve të mbeturinave;
- 35.1.13 Derdhja apo rrjedhja e mbeturinave prej automjeteve gjatë transportimit për në impiantet për trajtim apo për deponim në deponi të mbeturinave;
- 35.1.14 Personat e autorizuar për transportin e mbeturinave duhet të marrin masa që gjatë transportimit të mbeturinave, automjetet e tyre të kenë mbulesë adekuate me qëllim të pengimit të derdhjes, shpërndarjes apo rrjedhjes së mbeturinave gjatë transportit me destinacion tek impiantet për trajtim apo në deponin të mbeturinave;
- 35.1.15 Mbeturinat nga pajisjet elektrike, elektronike dhe të vëllimshme nuk guxojnë të hedhen në kontejnerë të mbeturinave ose në afërsi të tyre

Neni 38

Inspektimi jashtë territorit të komunës

Inspektori komunal për mjedis, sipas marrëveshjes nga neni 15 paragrafi 2, neni 65 dhe neni 67 të Ligjit të Ligjit për mbeturina nr. 04/L-060, mund të mbikëqyrë dhe inspekton menaxhimin e mbeturinave edhe në objektet, pajisjet dhe hapësirat që gjinden jashtë territorit të komunës dhe njëkohësisht Komuna mund të lidhë marrëveshje që inspektori mjedisor komunal i komunës tjetër të kryejë inspektimin në territorin e Komunës së Rahovecit.

Neni 39

Kundërvajtjet

1.Në territorin e Komunës së Rahovecit, për mosrespektim të dispozitave të Neneve 71, 73 dhe 74 të Ligjit për mbeturina nr. 04/L-060 dhe sipas gjobave të përcaktuara në këto nene, do të dënohen për kundërvajtje dhe gjobiten me gjoba të përcaktuara personat fizik, personat juridik dhe personat përgjegjës në kuadër të personave juridik.

2.Veprimet e ndaluar dhe gjobat sipas paragrafit 1 të këtij neni janë të përcaktuara në Shtojcën 2 të kësaj Rregulloreje.

Neni 40

Procedurat e ankesës

Kundër vendimit të inspektorit mund të parashtrohet Ankesa në **Komisionin e Ankesave për menagjimin e mbeturinave** nga **Neni 14** të kësaj Rregullore dhe në pajtim me Ligjin Nr. 05/L -031 për procedurën e përgjithshme administrative (Gazeta Zyrtare, nr. 20, 21 qershor 2016).

Neni 41

Veprat penale

Kur shkeljet e dispozitave të Ligjit për mbeturina përbëjnë vepër penale të përcaktuara sipas Kodit Penal, Inspektori komunal me njoftimin paraprak Kryetarit të komunës, bënë kallëzimin penal për kryersin e aktivitetit të kundërligjshëm.

Neni 42

Mbeturinat e hedhura nga personi i pa njohur

- 1.Për të gjitha mbeturinat e hedhura në hapësirat publike ose jashtë deponive të mbeturinave do të përgjigjet vetë hedhësi (subjekti fizik ose juridik) i mbeturinave .
- 2.Nëse personi përgjegjës për menaxhimin e mbeturinave në pajtim me autorizimet ligjore, nuk përkujdeset për mbeturinat e hedhura nga personi i pa njohur dhe nuk mund të identifikohet hedhësi, përgjegjësinë për ato mbeturina e bartë vetë Komuna e cila do të ndëmer të gjitha veprimet që të siguroj largimin e tyre.

XI - DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 43

Përgjegjësia individuale

Çdo person fizik dhe juridik mban përgjegjësi në bazë të dispozitave të kësaj rregulloreje dhe të legjislacionit përkatës për çështjet e menaxhimit të mbeturinave, kur me veprimet ose mosveprimet e tij, ka bërë kundërvajtje dhe shkelje të dispozitave të legjislacionit në fuqi.

Neni 44

Procedura përmbaremore dhe gjyqësore

Ndaj konsumatorëve të cilët nuk bëjnë pagesën e tarifës për mbeturina do të iniciohet procedura përmbaremore dhe gjyqësore nga njësitë përkatëse të komunës, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

Neni 45

Buxhetimi

1.Financimi i menaxhimit të mbeturinave sigurohet nga pagesat e konsumatorëve, buxheti komunal, Buxheti i Republikës së Kosovës, donacionet dhe burimet tjera financiare në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2.Për t'i përmbushur të drejtat dhe detyrimet e përcaktuara në këtë rregullore dhe me legjislacionin përkatës që ka të bëjë me menaxhimin e mbeturinave, organet dhe administrata përkatëse komunale, gjatë fazës së hartimit të buxhetit komunal planifikojnë buxhet për aktivitete të ndryshme që kanë të bëjnë me menaxhimin e mbeturinave si dhe sigurojnë burime njerëzore, financiare dhe logjistike të nevojshme.

3.Komuna e planifikon buxhetin komunal, i cili është transparent dhe bazohet në konsultime me palët.

4.Administrata dhe organet komunale zhvillojnë një proces për analizimin e nevojave të buxhetimit për menaxhimin e mbeturinave, bazuar në procesin e vlerësimit dhe raportimit.

5.Kryetari bashkëpunon me Ministrinë dhe me donator të ndryshëm për prioritetet për marrjen e fondeve për menaxhimin e mbeturinave.

Neni 46

Regjistri i deponive ilegale

Spektori për Menaxhimin e Mbeturinave, në afat prej gjashtë (6) muajve, pas hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje, duhet të përgatisë regjistrin e deponive ilegale në territorin e Komunës së Rahovecit, sipas dispozitave të Ligjit nr. 04/L-060 për mbeturina.

Neni 47

Ngritja e kapaciteteve për menaxhimin e mbeturinave

Për të siguruar ofrimin e një shërbimi cilësor dhe efektiv për mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit të njeriut, të gjithë punonjësit e komunës, veçanërisht punonjësit që kanë përgjegjësi direkte në fushën e menaxhimit të mbeturinave dhe mbrojtjes së mjedisit dhe shëndetit të njeriut, janë të obliguar të ndjekin trajnime dhe aktivitete që synojnë të zhvillojnë kapacitetet e tyre në këtë fushë si dhe të venë në shfrytëzim, në punën e tyre të përditshme, njohurinë dhe dijen e përfutur.

Neni 48

Zbatimi i Rregullores

1.Përgjegjësi për zbatimin e kësaj rregulloreje në territorin e Komunës së Rahovecit janë:

- 1.1. Spektori për Menaxhimin e Mbeturinave (SMM) si dhe organet dhe administrata komunale (Drejtoria për shërbime Publike dhe Drejtoria për Punë inspektuese – Inspektori për mbrojtje të Mjedisit me asistenc të Policis.
- 1.2. Operatorët e angazhuar për menaxhimin e mbeturinave;
- 1.3. Të gjithë personat fizik dhe juridik, kalimtarët e rastit dhe turistët dhe që ushtrojnë veprimtari dhe që ndodhen në territorin e Komunës;
- 1.4. Subjektet që ushtrojnë veprimtari ekonomike;

2.Zbatimi i kësaj rregulloreje sigurohet nga Kryetari, me mbështetjen e drejtorit të Drejtorisë së shërbimeve publike dhe/apo udhëheqësit të Sektori për Menaxhimin e Mbeturinave (SMM).Drejtoris për punë Inspektuese - Inspektorit për mbrojtje të mjedisit me asistenc të Policis së Kosovës.

3.Administrata dhe Organet komunale janë të obliguara qe pas hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje, t'i marrin të gjitha masat e nevojshme për zbatimin e kësaj rregulloreje dhe kryerjen e të gjitha detyrave dhe përgjegjësiwe përkatëse.

4.Për të gjitha rastet që nuk janë të rregulluara me këtë rregullore, zbatohen dispozitat e legjislacionit në fuqi që kanë të bëjnë me menaxhimin e mbeturinave.

Neni 49

Kjo Rregullore mundë të ndryshohet dhe plotësohet në procedurë të njëjtë me atë të miratimit nga Kuvendi i Komunës së Rahovecit me propozimet e arsyetuare nga propozuesi.

Neni 50

Pas miratimit nga Kuvendi i Komunës së Rahovecit kjo rregullore hynë ne fuqi **15 ditë** pas dërgimit te autoritetin mbikëqyrës MAPL- pas konfirmimit të ligjëshmëris (në kuptim të nenit 81, të Ligjit Nr-03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-28/2008” dhe nenit 8 të Rregullores me Nr-01/2016, për procedurat e hartimit dhe publikimin e akteve të Komunave).

KUVENDI I KOMUNËS SË RAHOVECIT

01Nr.____/23
Me Datën:00.03.2023

Kryesuses i Kuvendit

Defrim Kafexhiu

SHTOJCA A: Tarifa e taksës për mbeturina;

ÇMIMORE

I. LISTA E KONSUMATOREVE PËR SHËRBIMET E GRUMBULLIMIT TË MBETURINAVE (MUJORE) PËR VITIN 2023

I. Kategoria amvisëri : Shërbimi derë-më derë dhe me kontenier të përbashkët

Tarifat mujore	Tarifa 6.00 euro / njësi familjare 4.50 euro / individë
Kategoritë	Amvisëri rezident / jo rezident (diaspora)

II. KATEGORIA E KONSUMATOREVE KOMERCIAL / INDUSTRIAL : Shërbimi derë-më derë dhe me kontenier të përbashkët

Zona e Parë	Zona e dytë	Zona e tretë
Rahovec	Krushe e Madhe	Mrasor
Brnjakë	Ratkoc	Kaznik
Xërxë	Bellacerkë	Zatriq
	Radostë	Nashpallë
	Opterushë	Reti
	Celinë	Reti e Ulët
	Dejnë	Petkoviq
	Drenoc	Bratotin
	Çifllak	
	Brestoc	
	Kramovik	
	Hoqë e Vogël	
	Senoc	

	Pastaselë	
	Polluzhë	
	Sapniq	
	Dobidol	
	Nagavc	
	Zoqisht	
	Gexhe	
	Vranjakë	
	Pataqan i Poshtëm	
	Pataqan i Epërm	

Vërejtje. Kontenieri 1.1 m³ për mbetje shtazore, xhamave, asgjësim malli për një zbrazje është 91.80 €.

III. Kategoria e konsumatorëve Institucional.


Tarifa mujore 6.70 euro	Tarifa mujore 13.65 euro	Tarifa mujore 22.96 euro	Tarifat mujore 1 kontenier 1.1 m ³ (46.50 euro)
Zyre e partive Politike, Përfaqësitë të shoqatave, Objekte fetare	Teatër Galeri e arteve Biblioteka Çerdhe	Bankat Mikro financat Institucionet Financiar Zyre postare Keds Kost Hidroregjioni Të ngjashme	Objektet Komunale Ambulancat Shkollat Gjykatat Posta Policia Qendra regjistrimit (qkrc) Stacioni autobusëve Salla sportive
Shërbimet e ofruara me kontenjerë të veçantë			
Vëllimi i kontejnerit	1.1 m ³	5.0 m ³	7.0 m ³
Tarifa (euro/zbrazje)	12.80 euro	47.82 euro	66.95 euro

Të gjitha tarifat e përcaktuara janë me Tatimin mbi vlerën e shtuar (TVSH 8%).

I. Tarifa mujore	II. Tarifa mujore	III. Tarifa mujore	IV. Tarifa mujore	V. Tarifa mujore
Zona A: 6.70 euro	Zona A: 8.50 euro	Zona A: 10.50 euro	Zona A: 13.65euro	Zona A: 22.96euro
Zona B: 6.00 euro	Zona B: 7.00 euro	Zona B: 7.50 euro	Zona B: 11.50euro	Zona B: 16.50euro
Zona C: 5.00 euro	Zona C: 5.50 euro	Zona C: 6.70 euro	Zona C: 7.50euro	Zona C: 11.50euro
Avokaturat	Kompanitë	Butikët	Kafiterit	Restorantet
Zyre tjera	sigurimeve Auto	Barnatoret	Ëmbëltoret	Hotelet
Agjencionet	shkollat	Dyqanet e këpucëve	Qebaptoret	Furrat
Biznuteritë	Frizerët	Sanitarit	Byrektoret	Pompa Benzinës – me objekt përcjellës
Argjendarit	Mobil shop	Laboratorët	Gjellëtoret	
Optika	Kompjuter shop	Mini market	Piceritë	
Çajtoret	Auto elektrikist	Dyqanet Tekstil	Marketet	
Kozmetikët	Auto mekanik	Sallonet e perdeve	Motelet	
Këpucëtarët	Auto veglat	Sallone teknike bardh	Pompë benzinës (vetëm pompë)	
Ortarët	Barnatore	Pllacet ndërtimore	Sallonet e tepihëve	
Farkëtarët	bujqesore Auto		Mobillierit	
Kafe pjekësit	pjesë		Kazinotë	
Video lojërat	Librarit		Ordinancat	
Kurset e gjuhëve	Elektro material		Depot e pijeve	
Kiosqet	Vullkanizer		Depot ushqimore	
Fotografisë	Bastoret			
Auto parkingjet	Hekurishtet			
Auto larjet	Zdrukthëtarët			
Rrobaqepëse	Servis teknikes			
Këmbimoret	bardh Parkingjet			
Çmimet sipas zbrazjeve				

vi i ner it	1.1 m ³	5.0 m ³	7.0 m ³	
/zb arzje)	12.80 euro	47.82 euro	66.95 euro	

PROJEKT RREGULLORE PËR MENAXHIMIN E MBETURINAVE



Kompania Regjionale e Mbeturive “Ekoregjioni” SH.A –Rahovec

Raporti financiar

2022

Përmbajtja:

Përmbledhje ekzekutive	3
Hyrje	4
Klientët.....	5
Faturimi /Planifikimi.....	6
Inkasimi / Planifikimi	8
Shpenizmet	10
Problemet dhe sfidat	9

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Raporti i punës për periudhën vitin 2022 paraqet një përmbledhje të gjitha aktivitetet financiare të zhvilluara gjatë këtij viti .

Në raportin e punës për vitin 2022 do të prezantohen në mënyrë të detajuar numri i klientëve të shërbyer, të dhënat financiare që lidhen me afarizmin e kompanisë gjatë kësaj periudhe duke përfshirë edhe hyrat e tërësishme, shpenzimet e krijuara, dhe të gjitha të dhënat e tjera të cilat lidhen me periudhën raportuese.

HYRJE

Bazuar në Ligjin për Mbeturina, Ligjin për Ndërmarrje Publike, Statutin e KRM “Ekoregjioni” sh.a. si dhe regullorën e punës së kompanisë lidhur me hartimin e raporteve të punës dhe rezultatet e arritura gjatë perjudhave të caktuara kohore, në vazhdim po e paraqesim raportin e punës për vitin 2022.

Në vazhdim të raportit do të prezantohen në mënyrë të detajuar të gjitha të dhënat relevante të cilat janë të rëndësishme për të krijuar një pasqyrë të qartë për afarizmin e KRM “Ekoregjioni” - Njësia Rahovec gjatë kësaj periudhe.

KLIENTËT DHE KATEGORITË E TYRE

Në bazë të dhënave të KRM “Ekoregjioni” Sh.A. për periudhën raportuese numri i klineteve që është faturuar në Njësine Operative Rahovec është 8465 klientë.

Nëse i krahasojmë të dhënat me vitin vitit 2021 shohim se në vitin të 2022 kemi një ulje prej 171 klientë

Në mënyrë tabelare është paraqitur më poshtëL.

Njësia Operativ Rahovec

Kategorit e shërbimeve	Viti 2022	Viti 2021	Diferenca
Amvisri	7576	7645	-69
Bizneset	846	949	-103
Institucionet	42	41	1
K.K - Kontratat	1	1	0
Totali:	8465	8636	-171

Tab.1

Shënim : numri i klientëve sipas tabelës në vitin 2022 është më i vogël për 171 klientë, kjo për arsye të evidentimit të listës së klientëve dhe zvoglimin në rastet e klientëve të dyfishtë , të faturuar pa bazë dhe klientëve që banojnë në zonat e banuara me kombësi Sërbe , dhe të cilët klient janë pasivizuar.

Të hyrat

Nëdhjetëe parë 2022 kompania ka arritur që kërkesat tona ndaj klientëve të arrinin vlerën e faturimit prej 531,751.96 €, ndërsa krahasuar me periudhën e njëjtë 2021 kemi një rrijte prej 22,151.98 €,apo shprehur në përqindje 4.35 %

Paraqitja tabelare

	Faturimi 2022	Faturimi 2021	Diferenca 2022-2021	%
Tab.2	531,751.96 €	509,599.98 €	22,151.98 €	4.35

Paraqitja grafike ka këtë formë.




fig.1

Planifikimi i faturimit dhe realizimi në vitin 2022

Realizimi i faturimit për vitin 2022 kundrejt planifikimit paraprak për këtë periudhë është realizuar në 95 % apo në vlerë prej 531,751.96 kundrejt planifikimit prej 558,910.71 €.

Planifikimi i faturimit për vitin 2022	Realizimi i Faturimit për vitin 2022	Raporti Faturim - planifikim	% e realizmi
558,910.71 €	531,751.96 €	(4,986.49) €	95%

Tab.3




Fig.2

INKASIMI

Në këtë periudhë raportuese të vitit 2022 kompania ka arritur që inkasimin e mjeteve nga klientët të arrinte në vlerën prej 549,212.21 €, ndërsa krahasuar me periudhën e njëjtë 2021 kemi një rritje prej 90,750.95 €,apo shprehur në përqindje 20 %

Inkasimi 2022	Inkasimi 2021	Diferenca 2022- 2021	% e ndryshimit
549,212.21 €	458,461.26 €	90,750.95 €	20%

Tab.4



Fig.3

Inkasimi në vitin 2022 është më i lartë në krahasim me vitin 2021 si rezultat i përpjekjeve për inkasimin e borxheve të vjetra dhe rritjes së shkallës së inkasimit të rregullt

Planifikimi i inkasimit dhe realizimi në vitin 2022

Realizimi i faturimit për dhjetë-mujorin e vitit 2022 kundrejt planifikimit paraprak për këtë periudhë është realizuar në 107 % apo në vlerë prej 549,212.00 € kundrejt planifikimit prej 512,039.00 €.

Planifikimi I Inkasimit per vitin 2022	Realizimi I Inkasimit për vitin 2022	Raporti Inkasim - planifikim	% e realizmi
512,038.94 €	549,212.21 €	35,867.39 €	107%

Tab.5




Fig.4

SHPENZIMET E VITIT 2022 DHE KRAHASIMI ME VITIN 2021

Njësia operative Rahovec

Shpenzimet	Shpenzimet për vitin 2022	Shpenzimet për vitin 2021	Diferenca 2022-2021
Shpenzimet e pagave	314,595.80 €	295,117.09 €	19,478.71 €
Shpenzimet e karburanteve	64,680.17 €	36,151.09 €	28,529.08 €
Shpenzimet e deponisë	55,172.90 €	57,560.30 €	(2,387.40) €
Shpenzimet e regjistrimit të automjve	5,189.69 €	6,452.41 €	(1,262.72) €
Shpenzimet e mirembajtjes	11,836.94 €	7,679.97 €	4,156.97 €
Shpenzimet e veshmabthjes	2,021.76 €	2,823.86 €	(802.10) €
Shpenzimet e uji dhe rrymes	3,502.48 €	2,745.98 €	756.50 €
Shpenzimet tjera operative	17,546.14 €	19,776.23 €	(2,230.09) €
Totali i shpenzimeve	474,545.88 €	428,306.93 €	46,238.95 €

Tab.6

Nga tab.3 shohim që në krahasuar me vitin 2021 kemi rritje të shpenzimeve për total 46,238.95 €, apo 10.79 %.

Aryseja e kësaj rritje janë rritja e përgjithshme e çmimeve në të gjitha produktet dhe veçanërisht I naftës .

Shënim : Në shpenzimet e njësisë operative Rahovec nuk janë të përfshirë shpenzimet e pagave për :Mekanik , gomister, agjustator, futurist dhe depoistin , kjo për arsyë që pagat e tyre paguhen nga njësia Prizren , ndërsa shërbimin e marrin të gjitha njësitë përfshirë edhe Rahovecin në kërë rast. Numri I punëtorëve të angazhuar për këto shërbime është : 16 punëtor.




Fig.5

Shënim : Përveç shpenzimeve vjetore kompania “Ekoregjioni” , në këtë rast njësia operative Rahovec pagan për obligimet që ka ndaj Adminsitratës Tatimore të Kosovës , kjo si rezultat i akumulimit të borxheve të qytetarëve ndaj nesh , rrjedhimisht edhe ne ndaj ATK-se për TVSH -në e ngarkuar .

Çdo muaj kompania paga 35,000.00 për këto obligime , ndërsa pjesa e njësisë është 3,150.00 € në muaj apo 37.800.00 € në vit.

Problemet dhe sfidat gjatë kësaj periudhe

Viti 2022 dhe konkretisht periudha për cilën po raportohet është karakterizuar me një rritje të pa parashikuar të çmimeve, veçanërisht të naftës. Këto rritje të çmimeve e kanë vështirësuar operimin normal të kompanisë dhe përmbushjen me kohë të obligimeve.

Sfidë për këtë vit dhe vitet tjera do të jetë mbulueshmëria e shpenzimeve të njësië, kjo për arsyen që tarifa e shërbimit të grumbullimit të mbeturinave prej 4.16 € mujore është shumë e ulët për mbulimin e të gjitha shpenzimeve dhe rritjen e kapaciteteve teknike eventuale.

Është domosdoshmëri që rritja e tarifave të paktën të bëhet në përputhje me rritjen e çmimeve të përgjithshme, në veçanti të naftës dhe deponimit të mbeturinave.



Në mbështetje të nenit 12 paragrafi 1 dhe 2 shkronja (d), nenit 14, nenit 17 paragrafi 1 shkronja (c) dhe nenit 40 të Ligjit Nr-03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), dispozitave të Ligjit Nr. 04/L-174 për Planifikimin Hapësinor ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 30/2013"), Planit Zhvillimor Komunal (PZHK) 01 Nr. 2566 i datës 30.05.2013, nenit 10 paragrafi 1 dhe 2 pika 2.4, nenit 39, nenit 40, nenit 57 paragrafi 1 pika 1.3 dhe nenit 94 të Statutit të Komunës së Rahovecit me Nr. Prot. 1005 të datës 29.03.2017, Kuvendi i Komunës së Rahovecit në mbledhjen e mbajtur me datë: 30.03.2023, merr këtë:

V E N D I M

Për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit për zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme për nevojat e komunitetit të fshatit Kramovik

1. Me këtë vendim caktohet lokacioni për ndërtimin e objektit për zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme për nevojat e komunitetit të fshatit Kramovik.
2. Lokacioni i cekur në pikën 1 të këtij vendimi do të jetë në pjesën e parcelës kadastrale sipas certifikatës së pronësisë Nr. P-71510039-00330-0 me sipërfaqe të përgjithshme prej 7768m² (shtatë mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e tetë metra katror), zona kadastrale Kramovik, e evidentuar në posedim të PRONA SHOQËRORE-PALUAJTSHMËRIA; K.K. Rahovec.
3. Nga sipërfaqja e përgjithshme e parcelës së cekur në nenin 2 të këtij vendimi, ndahen 400m² (katërqind metra katror) për ndërtimin e objektit për zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme për nevojat e komunitetit të fshatit Kramovik.
4. Pjesa e parcelës në sipërfaqe prej 400m² (katërqind metra katror) në të cilën parashihet të ndërtohet objekti për zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme për nevojat e komunitetit të fshatit Kramovik sipas pikës 2 dhe 3 të këtij vendimi, sipas Planit Zhvillimor Komunal (PZHK) 01 Nr. 2566 i datës 30.05.2013 gjendet brenda zonës ndërtimore.
5. Objekti për zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme për nevojat e komunitetit të fshatit do të financohet nga donatorët.
6. Prona e paluajtshme dhe objekti që do të ndërtohet nuk e ndërron titullarin juridik, pronar i saj mbetet Kuvendi Komunal i Rahovecit dhe si e tillë nuk mund të tjetërsohet, nuk mund të jetë objekt i ndonjë barre tatimore apo çfarëdo ngarkese tjetër mbi këtë pronë nga donatorët e ndërtimit të objektit.
7. Obligohet Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë në Komunën e Rahovecit që të bëjë parcelizimin dhe skicimin në teren dhe regjistrimin e gjendjes në librat kadastral.

8. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë.
9. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi shfuqizohet vendimi me Nr. Prot. 01 Nr. 31/23 i datës 28.02.2023.
10. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 8, lidhur me nenin 9 të Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose Web – faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi u dërgohet:

- *Kryetarit të Komunës,*
- *Shërbimit të Kuvendit,*
- *Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, dhe*
- *Arkivi.*

KUVENDI I KOMUNËS NË RAHOVEC

01-Nr.____/23
Me datë:30.03.2023

Defrim Kafexhiu

Kryesues i Kuvendit



Republika e Kosovës
Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës / Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture /
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

NJËSIA KADASTRALE / KATASTARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-71510039-00330-0

Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number:	08-942/03-0056198/22
Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission:	28.12.2022 - 14:44
Komuna / Opština / Municipality:	RAHOVEC / ORAHOVAC / RAHOVEC
Zona kadastrale / Katastarska Zona / Cadastrol Zone:	Kraimovik / Kraimovik / Kraimoviku
Zyra Kadastrale Komune / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastrol Office:	RAHOVEC / ORAHOVAC / RAHOVEC

A. TË DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTARSKOI JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA

Numri i njësive kadastrale Broj katastarske jedinice Cad. Unit. No.	Lloji i njësive Vrsta jedinice Unit Type	Lloji i pronës Vrsta imovine Property Type	Zona U/R GIS	Superfajlla Površina Area (m ²)	Përshkrim Opis Description	Emri i njësive Ime Created by	Emri i njësive Ime Created by
P-71510039-00330-0	PARCELË / PARCELA / PARCEL	Pronë shogëfitorë / Društvena / Imovina / Socially owned Land		7768			

A.1 ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTARSKJE JEDINICE / CADASTRAL UNIT ADDRESS

Vendi i kualtur Mesto zvano Called place	Kodi Posttal Poštanski kod Postal Code	Emri i rrugës Naziv ulice Street name	Krijar më datën Uradeno na dan Created On	Aktiviteti Aktivitet Activity
AZENI MALLA				



A.2 LLOJI I SHFRYTËZIMIT / VRSTA KORISCENJA / TYPE OF USE

Numri Broj Number	Lloji i shfrytëzimit të parcelës Vrsta koriscenja parcele Parcel Type Of Use	Shfrytëzimi aktual i parcelës Trenutno koriscenje parcele Parcel Current Use	Kualiteti i klasës Kvalitet klase Quality Class	Sipërfaqja (m²) Površina (m²) Area
1	Bujqësori/Pojoplivnudo/Agriculture	Kullorë/Pashnjac/pasture	Kullorë E Klasës 4/Pashnjak 4 Klasë/4th Class Pasture	7768

B. PRONARI/POSEDUESI - VLASNIK/DRŽALAC - OWNER/POSSESSOR

Të drejtat Prava Rights	Emri Ime Name	Nr. personal Licen broj ID. No.	Vendbanimi Prebivalište Resident	Kodi postar Poštanski kod Postal code	Hollësitë e adresës Pojednostoi adrese Address details	Pjesa e pronës Dio imovine Share quota	Pershkrimi Opis Description	Azhuruar Ažurirano Updated
Poseëdm individual / Individualna Drazvina / Single possessor	PRONA SHOQËRORE- PALUETJSHMËRIA;K.K.R AHOVEC	KCID1509253	RAHOVEC / ORAHOVAC / RAHOVEC /			1/1		





REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA
MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS
MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE
MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE


AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY

KOPJA E PLANIT / KOPIJA PLANA / COPY PLAN

Zyra Kadastrale Komunale/ Opštinska Katastarska Kancelarija /Municipal Cadastral Office : RAHOVEC

Zona Kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Kramovik

Njësia/Jedinica/Unit	Tipi/Vrsta/Type	Sipërfaqja/Povšina/Area m ²
P-71510039-00330-0	Parcelë / Parcela / Parcel	7768



Shkalla/Razmera/Scale: 1:1980

Punoi/Obradio/Created:

Data/ Data/Date: 12.01.2023

Koha/ Vreme/ Time: 03:11:07

Nënshkrimi/Potpis/Signature:

Approvoi/Usvojeno/Approved: Drejtori/Direktor/Director

Nënshkrimi/Potpis/Signature:





Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic Of Kosovo
Kuvendi Komunal Rahovec / Skupština Opštine Orahovac / Municipal Assembly Rahovec



Drejtoria e Urbanizmit, planifikim dhe mbrojtje e mjedisit

Uprava za urbanizam, planiranje i zashtitu okoline
Department for Urbanism, planning and environmental protection

Numër: referencë	
Data:	06.02.2023
Për:	Drejtorinë për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë
Nga:	Drejtoria për Urbanizm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit – Komuna e Rahovecit
Përmes	Drejtorit të drejtorisë Albnor Mullabazi
Lënda / subjekti	Vërtetim Urbanistik
Baza:	Plani Zhvillimor Komunal nr.2566 të datës 30.05.2013 dhe ligjit për procedurën e përgjithshme Administrative

Bazuar në kërkesën e Drejtorisë për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë të datës 02.02.2023, për mes emailit për verifikimin e destinimit sipas PZHK-së që është në fuqi për parcelën nr. 330-0 në sipërfaqe prej 7768 m²

1. Ngastra kadastrale Nr. P-71510039-00330-0, vendi i quajtur Azem Mala, me sipërfaqe 7768 m², pronë shoqërore-paluejtshmëria, K.K.Rahovec, z.k. Kramovik.

Drejtoria e Urbanizmit, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit pas shqyrtimit të lëndës dhe shkresat e lëndës suaj ka konstatuar se:

Ngastra kadastrale me Nr. P-71510039-00330-0 në bazë të Planit Zhvillimor Komunal (PZHK-së) nr.2566 të datës 30.05.2013 kjo parcelë është brenda Zonës Ndërtimore.
Shiko Planit Zhvillimor Komunal (PZHK) 01nr. 2566 të datës 30.05.2013.

Pëlqimi ti dërgohet :

1. *Palës*
2. *Arkivit të Drejtorisë.*



Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Kuvendi Komunal Rahovec/Skupština Opštine Orahovac/Municipal Assembly Rahovec

Drejtoria për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë
Odeljenje za Katastar, Geodeziju i Imovinu
Department of Cadastre



Skica e terrenit

Z.K. Kramovik



P1:200

Pjesa e parcelës nr. 330-0
në sipërfaqe prej: 400m²

330-0

Nr	Y	X
1	7460724.24	4705460.38
2	7460716.53	4705483.64
3	7460721.83	4705485.02
4	7460742.21	4705480.91
5	7460743.24	4705472.38

Rahovec me 27.03.2023



Miftar Krasniqi gjeom.





Në mbështetje të nenit 12 paragrafi 1 dhe 2 shkronja (d), nenit 14, nenit 17 paragrafi 1 shkronja (c) dhe nenit 40 të Ligjit Nr-03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), dispozitave të Ligjit Nr. 04/L-174 për Planifikimin Hapësinor ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 30/2013"), Planit Zhvillimor Komunal (PZHK) 01 Nr. 2566 i datës 30.05.2013, nenit 10 paragrafi 1 dhe 2 pika 2.4, nenit 39, nenit 40, nenit 57 paragrafi 1 pika 1.3 dhe nenit 94 të Statutit të Komunës së Rahovecit me Nr. Prot. 1005 të datës 29.03.2017, Kuvendi i Komunës së Rahovecit në mbledhjen e mbajtur me datë: 30.03.2023, merr këtë:

V E N D I M

Për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit për zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme për nevojat e komunitetit të fshatit Polluzhë

1. Me këtë vendim caktohet lokacioni për ndërtimin e objektit për zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme për nevojat e komunitetit të fshatit Polluzhë.
2. Lokacioni i cekur në pikën 1 të këtij vendimi do të jetë në pjesën e parcelës kadastrale sipas certifikatës së pronësisë Nr. P-72510063-00722-0 me sipërfaqe të përgjithshme prej 1689m² (një mijë e gjashtëqind e tetëdhjetë e nëntë metra katror), zona kadastrale Polluzhë, e evidentuar në posedim të P.SH.E KOSOV.K.K.RAHOVEC.SHKOLLA FILLORE.
3. Nga sipërfaqja e përgjithshme e parcelës së cekur në nenin 2 të këtij vendimi, ndahen 200m² (dyqind metra katror) për ndërtimin e objektit për zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme për nevojat e komunitetit të fshatit Polluzhë.
4. Pjesa e parcelës në sipërfaqe prej 200m² (dyqind metra katror) në të cilën parashihet të ndërtohet objekti për zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme për nevojat e komunitetit të fshatit Polluzhë sipas pikës 2 dhe 3 të këtij vendimi, sipas Planit Zhvillimor Komunal (PZHK) 01 Nr. 2566 i datës 30.05.2013 gjendet brenda zonës ndërtimore.
5. Objekti për zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme për nevojat e komunitetit të fshatit do të financohet nga donatorët.
6. Prona e paluajtshme dhe objekti që do të ndërtohet nuk e ndërron titullarin juridik, pronar i saj mbetet Kuvendi Komunal i Rahovecit dhe si e tillë nuk mund të tjetërsohet, nuk mund të jetë objekt i ndonjë barre tatimore apo çfarëdo ngarkese tjetër mbi këtë pronë nga donatorët e ndërtimit të objektit.
7. Obligohet Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë në Komunën e Rahovecit që të bëjë parcelizimin dhe skicimin në teren dhe regjistrimin e gjendjes në librat kadastral.

8. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë.
9. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi shfuqizohet vendimi me Nr. Prot. 01 Nr. 32/23 i datës 28.02.2023.
10. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 8, lidhur me nenin 9 të Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose Web – faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi u dërgohet:

- *Kryetarit të Komunës,*
- *Shërbimit të Kuvendit,*
- *Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, dhe*
- *Arkivi.*

KUVENDI I KOMUNËS NË RAHOVEC

01-Nr. ____/23
Me datë: 30.03.2023

Defrim Kafexhiu

Kryesues i Kuvendit



Republika e Kosovës
Republica Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Mjedisit, Planifikimit, Hapësirës dhe Infrastrukturës / Ministarstvo Živote Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture /
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

NJËSIA KADASTRALE / KATASTARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-71510063-00722-0

Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number:	08-942/03-0004930/23
Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission:	30.01.2023 - 09:17
Komuna / Opština / Municipality:	RAHOVEC / ORAHOVAC / RAHOVEC
Zona kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone:	Poluzhë / Poluža / Poluzhë
Zyra Kadastrale Komune / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastal Office:	RAHOVEC / ORAHOVAC / RAHOVEC

A. TË DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA

Numri i njësise kadastrale Broj katastarske jedinice Cad. Unit. No.	Lloji i njësise Vrsta jedinice Unit Type	Lloji i pronës Vrsta imovine Property Type	Zona U/R GIS U/R	Sipërfaqja Površina Area (m²)	Pershkrim Opis Description	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
P-71510063-00722-0	PARCELË / PARCELA / PARCEL	Pronë shoqërore / Društvena Imovina / Socially owned Land		1689			

A.1 ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTARSKE JEDINICE / CADASTRAL UNIT ADDRESS

Vendi i kualtur Mesto zvano Called place	Kodi Postal Poštanski Kod Postal Code	Emri i rrugës Naziv ulice Street name	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
SELO-SELO				

A.2 LLOJI I SHFRYTËZIMIT / VRSTA KORISCENJA / TYPE OF USE

Numbri Broj Number	Lloji i shfrytëzimit të parcelës Vrsta koriscenja parcelle Parcel Type Of Use	Shfrytëzimi aktual i parcelës Trenutno koriscenje parcelle Parcel Current Use	Kualiteti i klasës Kvalitet klase Quality Class	Sipërfaqja (m²) Površina (m²) Area
1	Tokë Ndërtimore/Gradjevinško zemljište/Construction land	Oborr/Dvoršte/Back Yard		1569
2	Tokë Ndërtimore/Gradjevinško zemljište/Construction land	Shëpi-Ndërtues/Kuca-Zgrada/House-Building		120

B. PRONAR/POSEDUESI - VLASNIK/DRŽALAC - OWNER/POSSESSOR

Të drejtat Prava Rights	Emri Ime Name	Nr. personal Licenç broj ID. No.	Vendbanimi Prebivalište Resident	Kodi postial Postanski kod Postal code	Hollësitë e adresës Pojednosti adrese Address details	Pjesa e pronës Dio imovine Share quota	Peshkrimi Opis Description	Azhuruar Azurirano Updated
Poseidim individual / Individuaina Drzavina / Single possessor	P.S.H.E KOSOV.K.K.RAHOVEC.SH KOLLA FILLORE	KCID1513644	Polluzha / Polluzha / Polluzha /		POLLUZHA 34	1/1		



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO

QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA

MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS
MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE
MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE


AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY

KOPJA E PLANIT / KOPIJA PLANA / COPY PLAN

Zyra Kadastrale Komunale/ Opštinska Katastarska Kancelarija /Municipal Cadastral Office : RAHOVEC

Zona Kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Polluzhë

Njësia/Jedinica/Unit	Tipi/Vrsta/Type	Sipërfaqja/Povšina/Area m ²
P-71510063-00722-0	Parcelë / Parcela / Parcel	1689



Shkalla/Razmera/Scale: 1:424

Punoi/Obradio/Created:

Data/ Data/Date: 30.01.2023

Koha/ Vreme/ Time: 09:27:59

Nënshkrimi/Potpis/Signature:

APRIL 11 2023
REPUBLIC OF KOSOVO
MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS
KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA
KOSOVA CADASTRAL AGENCY
APRÓVOI/USVOJIO/APROVED
DREJTORI/DIREKTOR/DIRECTOR
NËNSHKRIMI/POTPIS/SIGNATURE



Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Kuvendi Komunal Rahovec/Skupština Opštine Orahovac/Municipal Assembly Rahovec


Drejtoria për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë
Odeljenje za Katastar, Geodeziju i Imovinu
Department of Cadastre



Skica e terrenit

Z.K. Polluzhë

P/1:150



Nr	Y	X
1	7464172.23	4701736.80
2	7464167.18	4701752.72
3	7464173.27	4701756.05
4	7464179.89	4701756.59
5	7464183.14	4701745.22
6	7464181.65	4701743.30

Rahovec me 28.03.2023



Miftar Krasniqi gjeom.



Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic Of Kosovo
Kuvendi Komunal Rahovec / Skupština Opštine Orahovac / Municipal Assembly Rahovec



Drejtoria e Urbanizmit, planifikim dhe mbrojtje e mjedisit

Uprava za urbanizam, planiranje i zashtitu okoline
Department for Urbanism, planning and environmental protection

Numër: reference/protokoli	
Data:	06.02.2023
Për:	Drejtoria për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë
Nga:	Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit – Komuna e Rahovecit
Përmes	Drejtorit të drejtorisë Albnor Mullabazi
Lënda / subjekti	Vërtetim Urbanistik
Baza:	Plani Zhvillimor Komunal nr.2566 të datës 30.05.2013 dhe ligjit për procedurën e përgjithshme Administrative

Bazuar në kërkesën e Drejtorisë për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë të datës 06.02.2023, për mes emailit për verifikimin e destinimit sipas PZHK-së që është në fuqi për parcelën nr. 722-0 në sipërfaqe prej 1689 m²

1. Ngastra kadastrale Nr. P-71510063-00722-0, vendi i quajtur Selo Selo, me sipërfaqe 1689 m², pronë shoqërore-paluejtshmëria, K.K.Rahovec, z.k. Kramovik.

Drejtoria e Urbanizmit, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit pas shqyrtimit të lëndës dhe shkresat e lëndës suaj ka konstatuar se:

Ngastra kadastrale me Nr. P-71510063-00722-0 në bazë të Planit Zhvillimor Komunal (PZHK-së) nr.2566 të datës 30.05.2013 kjo parcelë është brenda Zonës Ndërtimore.
Shiko Planit Zhvillimor Komunal (PZHK) 01nr. 2566 të datës 30.05.2013.

Pëlqimi ti dërgohet :

1. *Palës*
2. *Arkivit të Drejtorisë.*





Në mbështetje të nenit 12 paragrafi 2 shkronja (d), nenit 14, nenit 17 dhe nenit 40 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 25 të Ligjit Nr. 06/L-092 Për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 10/2019"), nenit 29 të Rregullores (QRK), Nr. 09/2020, për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, nenit 2, nenit 10, paragrafi 1 dhe 2, pika 2.4, nenit 39, nenit 40 dhe nenit 94, të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr. 1005, i datës 29.3.2017, Kuvendi i Komunës së Rahovecit, në mbledhjen e mbajtur me datë 00.03.2023, merr këtë:

V E N D I M

Për këmbimin e pronës komunale me pronën private

1. **Miratohet** propozimi i Kryetarit të Komunës, Nr. 00/000/00, i datës 00.00.2021 dhe jepet PËLQIMI për këmbimin e pronës publike komunale me pronën e institucionit qendror për interes publik, e cila gjendet në vendin e quajtur Ravne shume, zona kadastrale Rahovec, parcela me numër P-71510057-02302-0, sipas Certifikatës së pronësisë - pronë e Komuna e Rahovecit, me sipërfaqe prej 2261m² (dy mijë e dyqind e gjashtëdhjetë e një metra katror) e cila ndahet nga pjesa e përgjithshme prej 199774m² (njëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e shtatëqind e shtatëdhjetë e katër metra katror), **I JEPET** në posedim Org. Punuese Sharri (Pylltaria), ndërsa parcela sipas Certifikatës së pronësisë P-71510057-02172-1, në posedim të Org. Punuese Sharri (Pylltaria), me sipërfaqe të përgjithshme prej 2261m² (dy mijë e dyqind e gjashtëdhjetë e një metra katror), **I JEPET** Komunës së Rahovecit, në emër të këmbimit për ndërtimin e një mjedisi (parku) rekreativ, i cili do të shërbejë për rekreacion dhe inovacion për qytetarët e komunës së Rahovecit dhe më gjerë.
2. Qëllimi i këmbimit të pronës së paluajtshme komunale me pronën private, të cekur në pikën 1 të këtij vendimi, është për interes publik, përkatësisht për ndërtimin e një mjedisi (parku) rekreativ, i cili do të shërbejë për rekreacion dhe inovacion për qytetarët e komunës së Rahovecit dhe më gjerë.
3. **OBLIGOHET** Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, që t'i zhvillojë procedurat ligjore në përputhje me dispozitat e nenit 25, të Ligjit Nr. 06/L-092, për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës dhe dispozitave të Rregullores (QRK) Nr. 09/2020, për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës.

4. Vlerësimi i pronës komunale dhe i pronës së institucionit qendror, të cekur në pikën 1 të këtij vendimi, bëhet në bazë të ligjit përkatës për pronën e paluajtshme.
5. Pas përfundimit të procedurave për këmbim, rezultatet e këmbimit duhet publikuar me përmbajtjen e të dhënave të pronave të këmbëyer, si dhe emrin e pronarit të institucionit qendror me të cilin është bërë këmbimi.
6. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81, të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 8, lidhur me nenin 9, të Rregullores (QRK) Nr. 10/2019, për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021, dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose ueb – faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi u dërgohet:

- *Anëtarëve të Kuvendit,*
- *Shërbimit të Kuvendit,*
- *MAPL-së, dhe*
- *Arkivit.*

KUVENDI I KOMUNËS NË RAHOVEC

01-Nr. ___/23
Me datë: 00.03.2023

Defrim Kafexhiu

Kryesues i Kuvendit



Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC

Njesia Nr./Br./No 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 266 Nr. i faq./Br.sht./No.pg 121
Data/Datum/Date 8 / 3 / 2023
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58, shkronja (h), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040 ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr. 28/2008), nenit 25, paragrafi 4, 5 dhe 6, i Ligjit Nr. 06/L-092, për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr. 10/2019), nenit 29 të Rregullores (QRK) Nr. 09/2020, për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, nenit 74, paragrafi 1 dhe 2, pika 2.9 dhe nenit 94, të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr. 1005, të datës 29.3.2017, Kryetari i Komunës, u:

PROPOZON

1. Komitetit për Politikë dhe Financa dhe Kuvendit të Komunës së Rahovecit, dhënien e PËLQIMIT për këmbimin e pronës publike komunale, me pronën e institucionit qendror për interes publik, e cila gjendet në vendin e quajtur Ravne shume, zona kadastrale Rahovec, parcela me numër P-71510057-02302-0, sipas Certifikatës së pronësisë - pronë e Komuna e Rahovecit, me sipërfaqe prej 2261m² (dy mijë e dyqind e gjashtëdhjetë e një metra katror), e cila ndahet nga pjesa e përgjithshme prej 199774m² (njëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e shtatëqind e shtatëdhjetë e katër metra katror). **I JEPET** në posedim Org. Punuese Sharri (Pylltaria), ndërsa parcela sipas Certifikatës së pronësisë P-71510057-02172-1, në posedim të Org. Punuese Sharri (Pylltaria), me sipërfaqe të përgjithshme prej 2261m² (dy mijë e dyqind e gjashtëdhjetë e një metra katror), **I JEPET** Komunës së Rahovecit, në emër të këmbimit për ndërtimin e një mjedisi (parku) rekreativ, i cili do të shërbejë për rekreacion dhe inovacion për qytetarët e komunës së Rahovecit dhe më gjerë.
2. Qëllimi i këmbimit të pronës së paluajtshme komunale me pronën e institucionit qendror, të cekur në pikën 1 të këtij propozimi, është për interes publik, dhe në të njëjtin vend nuk ekzistojnë parcela të tjera komunale të përshtatshme për këtë qëllim.
3. OBLIGOHET Drejtoria për Gjeodezi, Kadaster dhe Pronë, që t'i zhvillojë procedurat ligjore të kësaj lloji të këmbimit të pronës së paluajtshme të Komunës dhe dispozitave të Rregullores (QRK) Nr. 09/2020, për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës.
4. Vlerësimi i pronës komunale dhe i pronës private të cekur në pikën 1 të këtij propozimi, bëhet në bazë të ligjit përkatës për pronën e paluajtshme.
5. Pas përfundimit të procedurave për këmbim, rezultatet e këmbimit duhet publikuar me përmbajtjen e të dhënave e të provave të këmbyer, si dhe emrin e pronarit të institucionit qendror me të cilin është bërë këmbimi.

Vendimi u dërgohet:

1. Kryesuesit të Kuvendit të Komunës,
2. Sekretarisë së Kuvendit dhe
3. Arkivit.

Smajl Latifi
Kryetari i Komunës
RAHOVEC / ORAHOVAC
REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E RAHOVECI / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC
KRYETARI I KOMUNES / PRESIDNIK OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo



Kuvendi i Komunës Rahovec
Opština Skupština Rahova / Municipality of Rahovec
RAHOVEC ORAHOVAC

Njësia Nr./Br./No 01/Kuvendi i Komunës

Nr./Br./No 294 Nr i Ceq/Brat/No.pq 01

Data/Datum/Date 30.03.2022

Në mbështetje të nenit 12 pika 1 dhe pika 2 shkronja d), nenit 14 pika 1, nenit 17 shkronja (c) dhe nenit 40 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 2, nenit 4, nenit 10 paragrafi 2 pika 2.4, nenit 40 paragrafi 2 pika 2.11, nenit 57 paragrafi 1 pika 1.3 dhe nenit 94 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i dt. 29.03.2017, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me dt. 30.03.2022 miraton këtë:

V E N D I M

Shpalljen me interes të përgjithshëm publik parcelën P-71510057-02172-1 në Zonën Kadastrale Rahovec

1. Miratohet propozimi i Kryetarit të Komunës Nr. 02/1662/22, i dt. 08.03.2022 dhe shpallet interes i përgjithshëm publik parcela kadastrale P-71510057-02172-1 në Zonën Kadastrale Rahovec, në sipërfaqe të përgjithshme prej 2261m² (dymijë e dyqind e gjashtëdhjetë e një metra katror), me kulturë Kopsht i Klasës I, në vendin e quajtur Groblje-Krstiq, e evidentuar sipas certifikatës së pronësisë në posedim të ORG.PUNUESE SHARRI (PYLLTARIA).
2. Qëllimi i shpalljes së interesit të përgjithshëm publik të pjesës së parcelës të cekur në pikën 1 të këtij vendimi do të jetë "Ndërtimi i një mjedisi (parku) rekreativ-inovativ", i cili do të shërbejë për rekreacion dhe inovacion për qytetarët e komunës së Rahovecit dhe më gjërë.
3. Autorizohet Kryetari i Komunës që komform dispozitave ligjore në fuqi të ndërmerr të gjitha veprimet e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.
4. Bartës për rregullimin e dokumentacionit teknik dhe regjistrimin e pronës në Librin Kadastral do të jetë Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë në Komunën e Rahovecit.
5. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë.
6. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës MAPL dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose Web – faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi u dërgohet:

- MAPL-së, dhe
- Arkivit

KUVENDI I KOMUNËSNË RAHOVEC

01 Nr.294/22
Datë:30.03.2022





Republika e Kosovës
Republica Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës / Ministarstvo Živine Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture /
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

NJËSIA KADASTRALE / KATASTARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-71510057-02302-0

Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number:
Data dhe koha e kështimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission:
Komuna / Opština / Municipality:
Zona kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone:
Zyra Kadastrale Komunale / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office: RAHOVEC / ORAHOVAC / RAHOVEC

Certificate draft
08.03.2023 - 10:32

RAHOVEC / ORAHOVAC / RAHOVEC

Rahovec / Orahovac / Rahovec

RAHOVEC / ORAHOVAC / RAHOVEC

A. TË DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA

Numri i njësise kadastrale Broj katastarske jedinice Cad. Unit. No.	Lloji i njësise Vrsta jedinice Unit Type	Lloji i pronës Vrsta imovine Property Type	Zona U/R G/S U/R	Sipërfaqja Površina Area (m²)	Pëshkrim Opis Description	Krijuar më datën Urađeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
P-71510057-02302-0	PARCELË / PARCELA / PARCEL	Pronë shoqërore / Društvena Imovina / Socially owned Land	Rural	199774			

A.1 ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTARSKJE JEDINICE / CADASTRAL UNIT ADDRESS

Vendi i kualitur Mesto zvano Called place	Kodi Postal Poštanski Kod Postal Code	Emri i rrugës Naziv ulice Street name	Krijuar më datën Urađeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
RAVNE SHUME-				

A.2 LLOJI I SHFRYTËZIMIT / VRSTA KORISCENJA / TYPE OF USE

Numri Broj Number	Lloji i shfrytëzimit të parcesës Vrsta koriscenja parcele Parcel Type Of Use	Shfrytëzimi aktual i parcesës Trenutno koriscenje parcele Parcel Current Use	Kualiteti i klases Kvalitet klase Quality Class	Sipërfaqja (m ²) Površina (m ²) Area
1	Bujqësore/Poljoprivredno/Agriculture	Kulllosat/Pashnjac/pasture	Kulllosë E Klases 5/Pasnjak 5 Klase/5th Class Pasture	199774

B. PRONARI/POSEDUESI - VLASNIK/DRŽALAC - OWNER/POSSESSOR

Të drejtat Prava Rights	Emri Ime Name	Nr. personal Licenl broj ID. No.	Vendbanimi Prebivaliste Resident	Kodi postal Poštanski kod Postal code	Hollësitë e adresës Pojednosti adrese Address details	Pjesa e pronës Dio imovine Share quota	Peshkrimi Opis Description	Azhuruar Ažurirano Updated
Posedim individual / Individualna Drazvina / Single possessor	Komuna e Rahovecit	600535233	RAHOVEC / ORAHOVAC / RAHOVEC /		DËSHMORËT E PASHTRIKUT	1/1		



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës / Ministarstvo Životte Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture /
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

